

Botime të reja: ISLAMI DHE IDEOLOGJIA



Këto ditë, pikërisht me 20 nëntor 2012, doli në dritë libri me titull:
ISLAMI DHE IDEOLOGJIA

Autor:
Arbër BERISHA

Recensentë:
Mexhid YVEJSI
Tomor KASTRATI

Lektori dhe realizimi kompjuterik:
Besmir YVEJSI

Kopertina:
Argjend XHELILI

Tirazhi: **500 copë,**
Faqe: 190

Shtypi:

Zero Print

Prishtinë, 2012

Çfarë përmban libri “Islami dhe Ideologjia?”

Libri “Islami dhe Ideologjia” fillon me fjalën e autorit, Arbër Berisha dhe fjalët e recesentëve dhe vazhdon me 46 tema të ndryshme të cilat janë:

Përmbajtja	
Fjala e autorit	
Fjala e recesentëve	
1. Islami dhe ideologjia	
2. Ide të gabuara për fenë e qëlluar	
3. Ardhmëria i takon Islamit	
4. Ideologjia e organizatave jo-Islame dhe dështimi i tyre para njerëzve dhe Islamit	
5. Disa Pejgamberë të zgjedhur dhe muslimanë fleksibil gjatë kohërave	
6. Islami dhe shekullarizmi	
I. Dallimi dhe diferencimi	
II. Ku lindin pasojat?	
III. Islami - e Vërteta dhe shekullarizmi - e pavërteta e arritur	
7. Miti, komunizmi dhe historia	
8. Çfarë duan shqiptarët?	
9. Islami dhe civilizimi perëndimor	
I. Pasiviteti lindor dhe gjallëria perëndimore	
II. Koncepti Islamo-perëndimor	
10. Islami dhe shekulli XXI	
Islami dhe civilizimi perëndimor	
11. Çfarë duan shqiptarët	
12. Idea e islamit tek ilirët	
13. Blerim Latifi (këshilltar i kryeministrit Thaçi) dhe teoria e Islamit të shkretëtirës	
14. Realitete historike	
15. Faraonët me krevata.....	
16. Studimi i fenomeneve në histori	
17. Teoria e perandorive	

18. Piramida shqiptare	
19. Halifati Islamo-kontemporan si dhe idetë e zhardhokut të patates.....	
20. Islami dhe ideja e diplomacisë së sotme	
21. Islami dhe racizmi	
22. Islami dhe nacionalizmi	
23. Islami dhe ekonomia	
24. Islami dhe kriminologjia	
25. Islami dhe demokracia	
26. Islami dhe teknologjia	
27. Islami dhe idetë ateiste	
28. Taborret masone	
29. Islami dhe njeriu	
30. Islami dhe tregtari i Venedikut	
31. Ideologjia e tmerrit	
32. As'habu-l-Kehf nga e kaluara në të sotmen....	
33. Islami dhe integrimet	
34. Musai a.s. dhe Hidri a.s. - reflektim nga e kaluara deri sot	
35. Prishtina, Perëndimi dhe Orienti	
36. Qyteti ideal islam	
37. Islamofobia - një absurditet	
38. Islami dhe drejtësia	
39. Islami një religjion i keqkuptuar	
40. Muslimanët në Perëndim	
41. Muhamedi a.s në notat e historisë evropiane .	
42. Islami dhe mjekësia	
43. Islami dhe i ashtuquajturi “ekstremitet“	
44. Islami në rrethin e Tropojës	
45. Islami dhe prostitucioni – amoraliteti	
46. Islami dhe malet	
Përfundimi	
Literatura e konsultuar	
Shënime për autorin	189

Dy-tri fjalë rreth përurimit të librit

Libri “ISLAMI DHE IDEOLOGJIA“ nga Arbër Berisha u botue në Prishtinë, Kosovë, por u përurue në qytetin Bajram Curri, Shqipni.

Ditën e shtunë, më 24 Nëntor 2012, në lokalin „Valbona“ kati i dytë, në qendër të qytetit Bajram Curri, përballë përmendorës së tij, u bë përurimi i librit „Islami dhe Ideologjia“, ku ishin të pranishëm miqë të autorit, dashamirë të librit, burra e gra, djemë e çika dhe përurimi u zhvillue me këto pika:

Në fillim, moderatorja simpatike Ditjona Kortoçi, përshëndeti të pranishmit, foli shkurtimisht rreth librit dhe rreth autorit të librit, imamin, Arbër Berisha. Pastaj e prezentoj recensentin e librit, shkrimtarin, publicistin, Mexhid Yveysi, nga Gjakova, i cili ndër të tjera tha:

“Të gjitha shkrimet në këtë libër kanë përmbajtje fetare, historike, kombëtare, janë paraqitur me dëshmi, me argumente, me maturi, me urtësi...!

Autorin, imamin, Arbër Berisha, e përgëzoj për librin e ri, në veçanti, i cili doli në dritë në pragun e 100 vjetorit të Pavarësisë, me këtë libër ai ndriçoi disa faqe të errëta të historisë... „

Pastaj, rreth librit foli Ma. Tomor Kastrati nga Prishtina, kurse i treti në radhë foli hoxha i nderuar nga Prishtina, Bejtullah Gashi.

Diskutimet rreth librit i vazhduen z.Petrit Zenelaj, z.Isa Berisha, historian, dr.Mire Hysenaj Hoxha, haxhi Rexhep Hasani etj.

Më në fund, autori i librit, imami, Arbër Berisha, falënderoj të pranishmit, didkutuesit, në veçanti vëllezërit që kishin ardhur nga Kosova, me kumtesa për librin, z.Mexhid Yveysi, z.Tomor Kastrati dhe imamin, Bejtullah Gashi....

Mexhid YVEJSI, Gjakovë

1. Islami dhe ideologjia
2. Ardhmëria i takon Islamit
3. Miti, komunizmi dhe historia
4. Çfarë duan shqiptarët?
5. Islami dhe civilizimi perëndimor
6. Islami dhe shekulli XXI
7. Islami dhe racizmi
8. Islami dhe nacionalizmi
9. Islami dhe ekonomia
10. Islami dhe kriminologjia
11. Islami dhe demokracia
12. Islami dhe teknologjia
13. Islami dhe idetë ateiste
14. Islami dhe njeriu
15. Islami dhe tregtari i Venedikut
16. Islamofobia - një absurditet
17. Islami dhe drejtësia
18. Islami një religjion i keqkuptuar
19. Islami dhe mjekësia
20. Islami në rrethin e Tropojës

Përveç këtyre, ka edhe 26 tema të tjera shumë interesante dhe të dobishme.

Të gjitha shkrimet në këtë libër kanë përmbajtje fetare, historike, kombëtare, janë paraqitur me dëshmi, me argumente, me maturi, me urtësi...!

Autorin, imamin, Arbër Berisha, e përgëzoj për librin e ri, në veçanti, i cili doli në dritë në pragun e 100 vjetorit të Pavarësisë, me këtë libër ai ndriçoi disa faqe të errëta të historisë...

Mexhid YVEJSI,
Gjakovë, 24 Nëntor 2012

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	
Fjala e autorit	
Fjala e recesentëve	
1. Islami dhe ideologjia	
2. Ide të gabuara për fenë e qëlluar	
3. Ardhmëria i takon Islamit	
4. Ideologjia e organizatave jo-Islame dhe dështimi i tyre para njerëzve dhe Islamit	
5. Disa Pejgamberë të zgjedhur dhe muslimanë fleksibil gjatë kohërave	

6. Islami dhe shekullarizmi
 - I. Dallimi dhe diferencimi
 - II. Ku lindin pasojat?
 - III. Islami - e Vërteta dhe shekullarizmi - e pavërteta e arritur
7. Miti, komunizmi dhe historia
8. Çfarë duan shqiptarët?
9. Islami dhe civilizimi perëndimor
 - I. Pasiviteti lindor dhe gjallëria perëndimore ...
 - II. Koncepti Islamo-perëndimor
10. Islami dhe shekulli XXI
Islami dhe civilizimi perëndimor
11. Çfarë duan shqiptarët
12. Idea e islamit tek ilirët
13. Blerim Latifi (këshilltar i kryeministrit Thaçi) dhe teoria e Islamit të shkretëtirës
14. Realitete historike
15. Faraonët me krevata.....
16. Studimi i fenomeneve në histori
17. Teoria e perandorive
18. Piramida shqiptare
19. Halifati Islamo-kontemporan si dhe idetë e zhardhokut të patates.....
20. Islami dhe ideja e diplomacisë së sotme
21. Islami dhe racizmi
22. Islami dhe nacionalizmi
23. Islami dhe ekonomia
24. Islami dhe kriminologjia
25. Islami dhe demokracia
26. Islami dhe teknologjia
27. Islami dhe idetë ateiste
28. Taborret masone
29. Islami dhe njeriu
30. Islami dhe tregtari i Venedikut
31. Ideologjia e tmerrit
32. As'habu-l-Kehf nga e kaluara në të sotmen....
33. Islami dhe integrimet
34. Musai a.s. dhe Hidri a.s. - reflektim nga e kaluara deri sot
35. Prishtina, Perëndimi dhe Orienti
36. Qyteti ideal islam

37. Islamofobia - një absurditet	
38. Islami dhe drejtësia	
39. Islami një religjion i keqkuptuar	
40. Muslimanët në Perëndim	
41. Muhamedi a.s në notat e historisë evropiane .	
42. Islami dhe mjekësia	
43. Islami dhe i ashtuquajti “ekstremitet“	
44. Islami në rrethin e Tropojës	
45. Islami dhe prostitucioni – amoraliteti	
46. Islami dhe malet	
Përfundimi	
Literatura e konsultuar	
Shënime për autorin	

Arbër BERISHA

ISLAMI

DHE

IDEOLOGJIA

Prishtinë, 2012

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	6
Fjala e autorit	8
Fjala e recesentëve	11
1. Islami dhe ideologjia	12
2. Ide të gabuara për fenë e qëlluar	16
3. Ardhmëria i takon Islamit	20
4. Ideologjia e organizatave jo-Islame dhe dështimi i tyre para njerëzve dhe Islamit	24
5. Disa Pejgamberë të zgjedhur dhe muslimanë fleksibil gjatë kohërave	27
6. Islami dhe shekullarizmi	34
I. Dallimi dhe diferencimi	34
II. Ku lindin pasojat?	36
III. Islami - e Vërteta dhe shekullarizmi - e pavërteta e arritur	37
7. Miti, komunizmi dhe historia	38
8. Çfarë duan shqiptarët?	42
9. Islami dhe civilizimi perëndimor	45
I. Pasiviteti lindor dhe gjallëria perëndimore	45
II. Koncepti Islamo-perëndimor	46
10. Islami dhe shekulli XXI	47
Islami dhe civilizimi perëndimor	
11. Çfarë duan shqiptarët	12. Idea e islamit tek ilirët
13. Blerim Latifi (këshilltar i kryeministrit Thaqi) dhe teoria e Islamit të shkretëtirës	14. Realitete historike
15. Faraonët me krevata.....	16. Studimi i fenomeneve në histori
17. Teoria e perandorive	18. Piramida shqiptare
19. Halifati Islamo-kontemporan si dhe idetë e zhardhokut të patates.....	
20. Islami dhe ideja e diplomacisë së sotme	
21. Islami dhe racizmi	
22. Islami dhe nacionalizmi	
23. Islami dhe ekonomia	
24. Islami dhe kriminologjia	
25. Islami dhe demokracia	
26. Islami dhe teknologjia	
27. Islami dhe idetë ateiste	
28. Taborret masone	
29. Islami dhe njeriu	
30. Islami dhe tregtari i Venedikut	
31. Ideologjia e tmerrit	
32. As'habu-l-Kehf nga e kaluara në të sotmen.....	

- 33. Islami dhe integrimet
- 34. Musai a.s. dhe Hidri a.s. - reflektim nga e kaluara deri sot
.....
- 35. Prishtina, Perëndimi dhe Orienti
- 36. Qyteti ideal islam
- 37. Islamofobia - një absurditet
- 38. Islami dhe drejtësia
- 39. Islami një religjion i keqkuptuar
- 40. Muslimanët në Perëndim
- 41. Muhamedi a.s në notat e historisë evropiane .
- 42. Islami dhe mjekësia
- 43. Islami dhe i ashtuquajti “ekstremitet“
- 44. Islami në rrethin e Tropojës
- 45. Islami dhe prostitucioni – amoraliteti
- 46. Islami dhe malet
- Përfundimi
- Literatura e konsultuar
- Shënime për autorin

Fjala e autorit

Falënderimi i takon vetëm Allahut xh.sh. i cili na bëri robër të bindur, dhe krijesa të dalluara me mendje të shëndoshë. Atë e lavdërojmë dhe falënderojmë dhe vetëm nga Ai ndihmë dhe falje kërkojmë. Paqja dhe bekimi i Allahu xh.sh. qoftë mbi të Dërguarin e gjithë njerëzimit, hz. Muhamed a.s. të birin e Abdullahut, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët me përkushtim dhe dedikim të thellë e trasuan dhe e vazhduan ndjekjen e *Sunetit* të tij, dhe Allahu xh.sh. na bëftë prej tyre dhe neve si *Umet* Islam i këtij fillim shekulli XXI.

I nderuar lexues, kur morra nismën të shkruaj këtë libër ishte një udhëtim që më shtyri të mendoj dhe ta hedhë në letër këtë ide. Udhëtimi im filloi nga Prishtina, pra Kosova, duke kaluar nga veriu në Durrës, Shqipëri. Pas ndaljen së autobusit dhe një pushimi gjysmë ore, u nisëm në drejtim të anijes “Adria”, pasi u mbush anija me cisterna dhe plot makina biznesi me naftë dhe benzinë, por dhe pasagjerë që ktheheshin disa në Itali e disa në Francë, e disa në Zvicër me autobusë.

Nga Ballkani, udhëtimi im ishte drejtë Evropës, kaluam nëpër Itali, duke u ndalur në Bolonjë dhe Milano, e shumë vende të italianëve, dikur Perandoria Romake. Seç më vinin disa mendime në kokë kur në anijen “Adria” bëmë gati 8 orë deri zbarkuam në Bari të Italisë, m’u duk vetja tërësisht ndryshe, sepse po hyja në një tokë të re të cilën nuk e kisha prekur më parë. Në autobusë ishim takuar si me porosi me përfaqësues nga gjitha trevat shqiptare, ku ka shqiptarë; nga Kosova, Shqipëria, Mali i zi, Maqedonia etj.

Pse ky libër mund të thoni ju? Ideja ime ishte që në çdo takim që do të kem të mundohem të transmetoj valë nga Kur’ani dhe Suneti sepse kështu po na mëson Resulullahi a.s.: “ ***Ju kam lënë dy gjëra, nëse do të kapeni në to, kurrë nuk do të humbisni.*** “ (Mutefekun Alejhi).

Ideja ime dhe e çdo besimtari që ka *iman* në zemrën e tij të përhapë ide progresive, Islame, paqësore, sepse vetë Islami dhe mësimet e saj kanë këtë ngjyrim dhe duan këtë praktikë, jo urrejtje dhe vëllavrasje, jo terror, jo përçarje, siç thotë Allahu xh.sh. në Kur’an: “ **Fitneja dhe provokimi/nxitja për të keqen është më e rëndë sesa vrasja.**”

Zbarkimi im final ishte në kërthizë të Evropës, ku gërshetoheshin tri kultura të mëdha në tre kantone. Vendi të cilin po flasim është Zvicra, e ndarë në kantonin italian, francez dhe gjerman. Një vend i përzier, kozmopolitan, ku mund të gjeni të gjitha ngjyrat dhe racat njerëzore që ka krijuar Allahu i Lartëmadhërishëm. Një vend kozmopolit, ka edhe ide të ndryshme, qofshin ato të gabuara apo të qëlluara.

Në këtë libër do të mundohem që çdo rreshti t’i jap një kuptim, në mënyrë që lexuesi ta hamonizojë idenë e tij me librin dhe të përçojë mesazhe strukturuese dhe sinjifikative në kujtesën e tij. Libri do të përmbajë tema të ndryshme në lidhje me Islamin dhe ideologjinë, sidomos në Ballkan dhe Evropë. Njeriu është një botë e madhe, nëse din ta kontrollojë vetveten dhe idetë e tij, do të arrijë që të jetë mëkëmbës i Allahut xh.sh. në tokë siç thotë Allahu xh.sh. në Kur’an:“(Përkujto Muhamed) **Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës.”**¹

Feja Islame pa fraksione, pa sekte e ndarje, është fe e pastër nga Kur’ani dhe Suneti, është një ideologji dhe shkollë shpëtimtare që duhet funksionalizuar.

¹ Kur'an-i: Surja: Bekare, ajeti: 30.

Funksionalizimi Islam në shoqërinë e sotme sidomos në këtë të këtij shekulli, ku ide nga media e shkruar apo vizuele, po propogandojnë antiislam çdo ditë e më shumë. Si përfundim duke mos e zgjatur më shumë dhe për t'ia lënë fjalën librit, shkollës më të mirë për njeriun e vërtetë i cili në brendësi të tij është i pastër dhe nuk e dëshiron luftën dhe terrorin, sepse kështu Allahu xh.sh. i mëson robërit e tij të mos prishin rregullin në Tokë, sepse Ai ka vënë rregull dhe qetësi.

Arbër BERISHA
Zvicër, Basel - Liestal
23.05.2011

Fjala e recesentëve

1. Islami dhe ideologjia

Fjala “Islam” ka një kuptim shumë të gjërë por ajo ka rrënjën e saj: “**Slm**” apo “**Selam**” që d.m.th.-në: “Paqe, nënshtrim dhe bindje ndaj Allahu xh.sh., Një dhe të Vetmit Zot që meriton të adhurohet”. Fjala Ideologji, vjen nga fjalët: “**Idë**” – mendim dhe “**Logia**” – shkencë, që d.m.th.-në: “shkenca e ideve apo e disa mendimeve ose koncepteve”.

Ideja e adhurimit të një Zoti dhe adhurimit të Allahu xh.sh. ka ekzistuar gjithmonë, pra njerëzit në çdo kohë dhe hapësirë kanë adhuruar Zotin. Ideja e Islamit është edukimi i njeriut duke e bërë njeriun të jetë i virtutshëm, i sjellshëm dhe të mos çënojë lirinë e tjetrit. Propaganda mediatike e censuruar nga armiq të dhe kundërshtarët e Islamit, fesë paqësore në planetin Tokë, e paraqesin Islamin si ide të terrorit dhe të mos-integritetit të njeriut në strukturat zhvilluese kohore. Komunistët e quatin Islamin, Muhamedanizëm, kinse ka ardhur nga Hz. Muhamedi a.s.. në shek. VII. Ata harrojnë faktin që Islami jeton me njeriun dhe është që nga koha e Hz. Ademit a.s., njeriut të parë në Tokë dhe babait të njerëzimit!!!

Njeriu i krijuar nga dheu, pasi ta përfundon misionin e tij, qoftë mision në të mirën apo të keqen e tij, trupi i tij vendoset sërish në tokë nga elementi që Allahu xh.sh. e ka krijuar. Darwinistët e shek. XIX sollën idenë kinse njeriu paska prejardhjen nga majmuni. Ide të tilla dështuan me kalimin e kohës duke vërejtur falsifikimet që i bëheshin trupave. Ideja e më të fortit kundër të dobët sjelli ide fatale për njerëzimin.

Shkolla/universitete si Oksfordi dhe Harvardi i treguan qartë teoritë e dështuara, të cilat teori janë përdorur shpeshherë për të manipuluar njerëzimin. Islami është fe e paqës, harmonisë paqësore, proklamon dhe synon paqen në planetin Tokë. Islami njeh barazinë nga vetë predikimet dhe në *Haxhin* e Lamtumirës, Pejgamberi a.s. u drejtohet masës: “**Nuk ka dallim arabi nga jo-arabi, i bardhi nga i ziu, i varfëri nga i pasuri, të gjithë janë të barabartë para Allahut xh.sh..**”. Pra janë njerëz dhe ne jemi njerëz. Harmonizmi dhe bamirësia që Islami na mëson ta duam njëri-tjetrin fisnikëron zemrat e njerëzve. Islami në botë si fe e misionit është duke u përhapur me të madhe.

Vetëm Evropa çdo ditë e më shumë ka pasues të denjë të Islamit, gjë e cila po dëshmohet edhe nga mediat edhe shpesh ato po mundohen t’i fshehin shifrat. Marrim shembull: në udhëtimin tim për në Zvicër, autobusi që unë isha, në të kishte disa shqiptarë muslimanë që kishin për të shkuar në disa shtete të Evropës, si: Italia, Gjermania, disa qytete të Zvicrës, Francës etj. Të gjithë kishin familjet islame dhe tregonin për Islamin e bollshëm dhe përhapjen e tij që po bëhet çdo ditë e më shumë. Vetëm qyteti i Bazelit kishte afro 22 xhami ku përpara mund t’i numëroje ato me gishta.

Mirëpo një fakt tjetër që një vëlla nga Lipjani, tashmë banor i Zvicrës me të gjitha të drejtat, bashkë me familjen e tij, më tregoi se kishin bërë një organizim/grup elitash diku afro 1800 vetë, ku një ndër kryesorët ishte musliman zvicerian. Që nga ky organizim që është në rritje, kur të arrijë një numër edhe pak më të madh, të kandidojnë për vende

në parlament, që edhe muslimanë të Zvicrës t'i kenë *minaret* dhe *ezani* të dëgjohet, dhe të kenë shumë të drejta dhe liri të tjera.

Idetë Islame tashmë kanë hyrë në çdo shtëpi përmes rrjetit, internetit, ku shumë njerëz duke dëgjuar dhe shfletuar në internet gjëra të ndryshme rreth Islamit, kanë ndërruar idetë dhe pikëpamjet e fituara gabimisht për fenë Islame dhe muslimanët si komunitet. Pikërisht në ditët që po shkruaja diçka rreth Islamit dhe aktualitetit për t'ia dërguar revistës “Dituria Islame” nuk shkoi shumë kohë dhe shtypi anë e kënd botës bashkë me mediat dhe internetin, shkruante për misterin dhe temën tabu, rreth personit imagjinar “Osama Bin Laden” si kinse një njeri i terrorit dhe përfaqësues i muslimanëve dhe i Islamit. Por kur shikoja videot e tij më habiste fakti pse pushkën dhe rrobat i kishte amerikane, ky fakt më çudiste shumë. Në moment m'u kujtua C.I.A. amerikane çfarë stërvitje dhe rekrutime bënte për *talebanët* në Afganistan që ata të luftojnë kundër rusëve.

Si duket daja Sem nuk është aq budalla nga seç neve na duket. Në mënyrë indirekte përdorë *talebanët* duke i armatosur dhe duke i futur me ushtarët rusë në luftë pikërisht në Afganistan. Pas shpartallimit rus, koha ecën dhe pikërisht këta që prodhuan këtë grup ushtarak *talebanësh*, i akuzojnë si njerëz që prishin rregullin dhe kinse 11 shtatori erdhi nga këta malësorë, që për mendimin tim nuk kanë lidhje për teknologjinë, e jo të rrënojnë sistemin amerikan dhe të rrënojnë kullat binjake më të njohura për kohën e zhvillimit njerëzor të këtij fund shekulli. Islami është i sulmuar nga të gjitha anët mirëpo ne nuk duhet harruar ajetin kur'anor: **“Ata përpiqen me gojët e tyre ta shuajnë dritën e Allahu, e Allahu nuk dëshiron tjetër, pos ta përsosë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë”**.²

Islami ka për të arritur jo për inat të jobesimtarëve, por sepse kështu Allahu xh.sh., Zoti i gjithësisë, Një dhe i Vetmi dëshiron. Problemet në Lindje, pra në botën arabe si rasti i Egjiptit, Libisë, Jemenit dhe shumë shtete tjera, që në krye posedojnë diktaturën dhe diktatorin si udhëheqës ideor, shpirtëror dhe material. Gjasat e korrupsionit të liderit janë të mëdha kur ai del nga fusha e gamës së të vepruarit me Kur'an dhe Sunet. Populli është një turmë që manipulohet nga gjërat sipërfaqësore, por kreu korruptohet nga koka.

Ne e kemi parasysh rastin e Resulullahit a.s. kur idhujtarët i ofruan pozitë, grua, afera të ndryshme që ai të dezertonte nga ideja të cilën Allahu xh.sh. ia kishte zbritur. I Dërguari a.s. i kundërshtonte dhe veproji sipas urdhërit të Allahut Fuqiptotë andaj çdo prijës musliman duhet të veprojë kështu, të ecë në konturet islame dhe jo në ato materiale apo epshërore. Kemi rastin kur forcat amerikane hynë në Irak me postulatën se do të vendosin demokracinë atje, por prapavija e tyre ishte nafta dhe pusët e bollshme me ari të zi siç quhet ndryshe.

**Zvicër - Liestal,
25.05.2011**

² Kur'an-i: Surja: Tevbe, ajeti 32.

2. Ide të gabuara për fenë e qëlluar

Sot manipuluesit e parave, kredive, kamatave si dhe shumicës së bankave botërore janë masonët apo çifutët, apo siç i quan Kur'an i Famëlartë, *Beni Israilë*. Sigurisht mediat filmike si ajo Holly and Wood mirëmbahet dhe drejtohet nga hebrenjtë masonë. Kuptimi i “*Hollywood*”-it apo “*Malit të Shenjtë*”, e ka marrë epitetin dhe frymëzimin nga mali ku i zbriti hz. Musait a.s. Tevrati. Mirëpo hebrenjtë ishin ata që e kundërshtuan vetë hz. Musain a.s. dhe hz. Harunin a.s. duke adhuruar viçin në vend të Zotit të gjithësisë.

Ku mendoni se dua të dal? Këta drejtues të mediave filmike *hollivudiane* janë bijtë e këtyre *israilëve* që kundërshtuan ligjin e Allahut xh.sh.. Pikërisht këta drejtojnë botën e filmit, duke manipuluar njerëzimin me nudizëm, pederastizëm, neverizëm si dhe duke njollosur Islamin dhe muslimanët me idetë e tyre anti-islame dhe degjeneruese për racën njerëzore. Mund të thoni ju përse? Sepse ata për para shkatërrojnë moralin njerëzor dhe vetë duan ta udhëheqin botën me pasuritë e tyre të fituara në mënyrë të palejuar dhe haram. Si prishet njerëzimi?

Në Gjermani një vëlla musliman po tregon për një grua e cila kishte dërguar fëmijë në jetimore dhe në vend të tyre dashuronte qenin e saj. Mirëpo një ditë të bukur qeni i racës “*pitbull*” tërbohet dhe e han një fëmijë të pafajshëm në qytet. Gjyqi gjerman e hedhë kafshën e pronares në gjyq për ta dënuar për vrasje dhe ta parandalojë dëmin e mëtutjeshëm, sepse dihet se çka është sëmundja e tërbimit tek kafshët. Por më interesantja dhe tragjika ishte kur gruaja qanë me lot dhe thotë: “*Më mirë mbytmëni mua se beben time, pra qenin*”!!!

Morali i jomuslimanëve që janë fundosur në jetën e kësaj bote ka rënë shumë poshtë, kështu ndodhë kur i largohemi të vërtetës, dhe Allahu xh.sh. thotë për ta: “**ata janë më keq/poshtë se shtaza/kafsha**”. Në një film që po shikoja nga shtëpia filmike “*Hollywood*” i cili si projekt mason e urrenë me çdo potencial Islamin. Shikova një grup amerikanësh të cilët nxeheshin rreth zjarrit përjashta, papritur si në formë loje një mjekërrosh kinse islamist, i cili në fenotip ishte i tëri hebre, u shfaq me dinamitë rreth belit dhe i armatosur tha: “*Death to the America!!!*”. Nuk funksionoi kamikazllëku i tij dhe shakaja, atëherë të pranishmit e ndoqën për ta rrahur. Ideja, manipulimi i masës dhe paraqitja e muslimanëve para masës si terroristë dhe kamikazë.

Ideja tjetër më e rrezikshme është kinse muslimanët e urrejnë Amerikën apo ndonjë popull tjetër të caktuar, por logjika masone dëshiron që edhe përmes shakave të futë kripën dhe inatet mes popujve. Kurse vetë të rrijnë në pas-skenë, duke qeshur me jetërat e të pafajshmëve dhe muslimanët që vdesin çdo ditë në botën arabe dhe në përgjithësi.

Mirëpo ne nuk do të zhgënjehemi, Allahu xh.sh. në Kur'an i përgëzon durimtarët dhe tregon për ndëshkimin e ashpër dhe hidhërimin e madh që morrën nga Allahu xh.sh., *beni israilët* të cilët thonë: “**Dora e Allahut është e shtrënguar**”. Shpifën dhe shpifin për

Allahun xh.sh., shpifin për hz. Isain a.s., nënën e tij të ndershme hz. Mejremen a.s., hz. Muhamedin a.s. etj.

Por Allahu xh.sh. është *Es-Sabur* - I Durueshmi, dhe i lejon deri në një moment të caktuar, derisa ti kaplojë ndonjë dënim katastrofik dhe shumë i dhembshëm. Kurse *Umeti* i pastër dhe i vërtetë islam, pa ngatërime, fragmentarizime ecën për të mirën e njerëzimit. Muslimani e konsideron njeriun si krijesën më të ngritur, si mëkëmbës të Allahut xh.sh. në Tokë. Krijesë e cila ka misione dhe vizione të larta për të mirën e njerëzimit, dhe jo kundër njerëzimit. Allahu xh.sh. thotë për *Umetin* Islam: **“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirësi, dhe të ndaloni nga veprat e këqija, dhe ti besoni Allahut”**.³

Umeti i të Dërguarit a.s. është i më i dobishëm për mbarë njerëzit, sepse ka detyrë dhe obligim të mbajë drejtësinë si në çështjet materiale dhe fizike, ashtu dhe në përmirësimin dhe stabilizimin e jetës shpirtërore. Hz. Muhamed a.s. u dërgua si mëshirë për mbarë njerëzimin. Ai sqaroi dhe urdhëroi dashurinë, bashkimin, vëllazërinë e krijesës me krijesën, duke qenë njeriu për njeriun vërtetë njeri dhe jo ujk, siç e proklamonte materializmi dialektik, i thatë, i pandjenja dhe i pashpirt. Mekka, vendi ku muslimanët nga mbarë bota bëjnë *Haxhin*, që është një vendtakim vëllazëror pa dallim race, ngjyre apo etnie dhe kombësie. Të gjithë bashkohen dhe miqësohen, ta adhurojnë Krijuesin e gjithësisë. Veshja e *ihramit* dhe bardhësia e petkut si dhe lutjet dhe namazet janë një tregues i paqes dhe shpirtbardhësisë së muslimanit.

Realiteti i Islamit është paqja, solidariteti, dashuria, dhe jo terrori, dhe vëllavrasja. I Dërguari a.s. ka thënë: **“Të vrasësh një njeri padrejtësisht është si të vrasësh të gjithë njerëzimin”**. Viktor Hygo thoshte: **“Të këqinjët kanë një lumturi të zezë”**. Të tillë lumturi do të kenë edhe çifutët që luftojnë me mish dhe me shpirt ta njollosin Islamin përmes formave moderniste dhe postmoderniste. Lusim Allahun xh.sh. që të na bëjë prej të mirëve dhe fundin të na bëjë të mirë dhe të na ringjallë me të mirët dhe edhe pse këtë e urrejnë jobesimtarët.

**Zvicër, Liestal
26.05.2011**

³ Kur'ani – Surja: Ali Imran, ajeti:110.

3. Ardhmëria i takon Islamit

Sot bota ka nevojë për paqe, dashuri, solidaritet, miqësi, rregull dhe harmoni. Islami si një fe e përkryer dhe e përsosur nga Zoti i gjithësisë, i ofron të gjitha opcionet e mësipërme, jo veç tyre, por edhe shumë ekuilibra të tjerë stabil në të mirë të njeriut. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: “**Vetëm i Allahut është i tërë sundimi i qiejve dhe i tokës, dhe vetëm tek Ai është e ardhmja**”.⁴

Sot lëvizja e lirë e muslimanëve nëpër botë, mundëson takime dhe refleksime në çdo cep të botës, shpërndarjen e ideve progresive islame. Dikur atypari para 1 mijë viteve tregtarët arabë bënë tregti në të gjitha korridoret dhe anekset e botës. Krahas tregtisë ata bënë edhe komunikim masiv dhe thirrje islame. Në mënyrë diplomatike ata tregonin Islamin dhe shumë njerëz e gjenin vetveten aty dhe e pranonin Islamin.

Sot Islami në tërë Evropën si dhe Amerikë njihet anëtarë të rinj që hyjnë në rradhët e besimit Islam dhe pranojnë këtë fe dhe besim me dashuri. Vetëm në Gjermani, çdo vit me mijëra persona e pranojnë Islamin, ashtu edhe në Angli, Francë, Sh.B.A. etj. Duhet ditur se Islami është fe e shkencës, e dijes dhe ardhmërisë njerëzore. Gjëja e parë të cilën e krijoi Allahu xh.sh. ishte lapsi dhe i tha: “**Shkruaj!**”. Ajeti i parë në mënyrë urdhërore drejtuar hz. Muhamed a.s. ishte: “**Ikre! – Lexo!**”, por kjo urdhëresë aludon në mënyrë të prerë tek të gjithë muslimanët.

Dhënia pas librit dhe bibliotekave islame dhe shkencore, ngjallë dhe vetëdijëson njeriun, duke ia bërë të ditur qëllimin dhe motivin e ardhjes së tij në këtë botë. Universitetet e para i hapën muslimanët, kur Evropa ishte ende në baltë, ndërsa Amerika ende nuk ishte zbuluar dhe formuar kulturalisht. Universiteti i parë në rruzullin tokësor i cili lëshonte diploma universitare u themelua në Fes të Marokut më 859 dhe si i tillë theu rekordin botëror dhe hyri në librin e Genisit si universiteti më i lashtë në botë. Përveç kësaj, Universiteti i Al-Az'harit në Kajro të Egjiptit, i themeluar në vitin 975, ishte universiteti i parë që ofroi diploma postdiplomike në fusha të ndryshme. Kështu origjina e fakultetit katërvjeçar rrjedh pikërisht nga sistemi islamik mesjetar.

Muslimanët në të kaluarën iu kushtonin rëndësi shumë të madhe leximit dhe librit. Kjo rëndësi i bëri ata të jenë viganë apo udhëheqës të planetit Tokë. Pasojë e ideve të injorantëve në Islam dhe sektarizimeve është dija e paktë dhe leximi me ndikime të një anshme si dhe largimi nga bazat burimore, Kur'anit dhe Sunetit. Që muslimanët të kenë të ardhme më të sigurtë, duhet të lexojnë shumë dhe teorinë Islame ta hedhin në praktikë, kështu ata do të arrijnë të bëhen dirigjuesit kryesorë në tokën e Allahut xh.sh..

Por gjithësesi Islami po troket dhe po ofron në çdo familje duke hyrë gradualisht dhe me një mirësi të lartë, po prekë zemrën e çdo njeriu duke e kthyer atë në identitetin e tij të pastër dhe duke pranuar Islamin, fenë e afro dy miliardë muslimanëve. Ardhmëria i takon Islamit sepse kështu njerëzit do të kenë mundësinë të gjejnë qetësinë shpirtërore dhe

⁴ Kur'an-i: Surja: Nur, ajeti: 42.

rregullimin moral jetësor. Njerëzit pa moral si populli i hz. Lutit a.s., hz. Hudit a.s. dhe hz. Salihut a.s., Allahu xh.sh. i dënoi me një dënim të ashpër sepse thyen çdo mirësjellje dhe kod moral jetësor duke rënë në nivelin e shtazës e edhe më keq sesa shtaza. Ishin muslimanët e Andaluzisë/Spanjës dhe Sicilisë muslimane që vendosën gurthemelin e shkencës, i hapën tunelin e Renesancës dhe i dhanë ide dhe e formuan shkencën.

Këto të vërteta po shpalosen çdo ditë, këtë po e pranojnë dhe *Ehli-Kitabët*. Në një emision anglez nga B.B.C dhe një tjetër gjerman nga R.T.L. shfaqej një emision, në të parin ishte “*Islami dhe Shkenca*” kurse në të dytin ishte “*Dituria e fshehtë e Islamit*”. Nga dy kanalet e mësipërme prestigjioze evropiane, tregohej e vërteta që është mbajtur fshehur nga idetë e gabuara të njerëzimit për Islamin dhe muslimanët. Sot me lejen e Allahu xh.sh., Islami ka hyrë në çdo vend dhe e vërteta rreth Islami po shpaloset çdo ditë e më shumë.

Në rajonin verior të Shqipërisë ku unë jetoj, komunizmi i egër i rrënoi dikund 27 xhami. Dëshiroi Allahu xh.sh. i erdhi fundi asaj diktature çnjerëzore, ndërsa xhamitë numëroheshin me gishta, ashtu edhe muslimanët si pasojë e komunizmit. Sot ka xhamia me një numër të kënaqshëm dhe thuajse çdo vit ndërtohet nga një e re. P.sh. këtë vit u ndërtua një në fshatin Margegaj, komuna Margegaj, Tropojë-Shqipëri. Duke parë një video të Tiranë, një vëlla i joni, nga krishterizmi kishte pranuar Islamin, ai dhe bashkëshortja e tij dhe komplet familja, dhe kur shkonte në xhami një *saff* mbushej vetëm me fëmijë të tij në namaz.

Në vizitën time të shkurtër në Gjermani m’u mundësua të vërej rritje të madhe të Islamit dhe muslimanëve, nuk kaloja 100 metra dhe shihja gra me *hixhab*, burra me mjekrra dhe njerëz që jepnin *selam* mes vehte. Pejgamberi a.s. ka thënë: “***Jepni selam mes vehte, do të duheni***”. I njëjti fenomen është edhe në Francë por edhe në Itali, ku me sytë e mi pashë një grup muslimanësh dhe muslimanesh me *hixhab* që zbarkuan në Bari të Italisë. Për të mos harruar xhamitë në Romë e në shumë qytete të Italisë, qoftë nga italianët muslimanë, qoftë nga shqiptarët, turqit, arabët, marokenët, tunizianët, që disa peshkonin në degët e shtratit të detit Adriatik ku matanë tij shtrihet Ballkani me miliona muslimanë dhe mijëra xhami të cilat me lëvizjen e lirë të muslimanëve do të kërkojnë vatra të tjera dhe ndërtimit të xhamive të reja në Evropë dhe botë me lejen e Allahut xh.sh..

Zvicër, Liestal
26.05.2011

4. Ideologjia e organizatave jo-Islame dhe dështimi i tyre para njerëzve dhe Islamit

Normalisht që sektet e ndryshme mundohen që të krijojnë përçarje në rradhët e muslimanëve. Kemi thënë se gjithmonë kur largohemi nga Kur'ani dhe Suneti si dhe nga dijetarët eminentë të njohur me terminologjinë "*Ixhma*", pra shumica e dijetarëve, atëherë dalim nga rruga e drejtë dhe humbasim. I Dërguari Muhamed a.s. transmetohet që: "***bëri një vijë të drejtë dhe disa vija të shkurtëra anash dhe tha: kjo rruga e drejtë të dërgon drejtë Xhenetit, kurse këto të shkurtërat e kanë shkurt dhe shpiejnë në greminë të Xhehenemit***".

Kohëve të fundit janë shfaqur me qindra organizata si: krishtere, hebreje, Ahmedij, Bahai etj. Unë kam pasur rastin që të kem debat me shumë përfaqësues të organizatave të këtij lloji të cilat shohin ëndërra me sy çelë. Një ndër organizatat çifute të njohur si Dëshmitarët e Jehovahit, të cilët kanë Biblën e vet ku dallon nga ajo katolike dhe protestante, ku sipas besimit të tyre Krishti (hz. Isai a.s.) është kryqëzuar në pemë e jo në kryq.

Miliona revista të tyre, si: "*Kulla e Rojës*" dhe "*Zgjohuni!*" shpërndahen, por më kot po dështojnë çdo ditë e më shumë, vetëvrasja tek ky grupacion nganjëherë shfaqet si ide e lumturisë për të gjetur parajsën, gjë e cila sipas Islami është gabim trashanik sepse Allahu xh.sh. njeriut ia ka dhënë jetën dhe Ai ka të drejtë t'ia marrë kur të dëshiron. Vetëvrasja në fenë Islame është rreptësisht e ndaluar, dhe ata të cilët e bëjnë këtë akt përfundimin e kanë në Zjarr.

Protestantët, këta i takojnë pjesës së reformuar në dallim nga katolikët, i shmangen adhurimit të simboleve dhe nëse i pyet ata thonë: "*Ne nuk predikojmë fe, por predikojmë atë që thotë Jezusi (hz. Isai a.s.)!!!*". Reformacioni ndodhi më 1517 me Martin Luterin dhe që nga atëherë filluan të krijohen disa fraksione në Krishterizëm. Në meshën e tyre, muzika dhe gota e vockël e verës me substanca alkoolike është gjë e zakonshme dhe serviret me dëshirë për pjesëmarrësit. Dihet vëllezër se alkooli është dehje por edhe muzika është dehje, kur të ikën mendja dhe turbullohet, nuk din se çka vepron. Zoti na dha mendjen dhe na dalloi nga gjitha krijesat me të.

Edhe këta të fundit janë zbehur dhe po humbasin çdo ditë dhe veprimet e tyre nuk kanë më ndikim tek masa edhe pse mundohen përmes muzikës dhe lojërave shfrenuese, arritshmëria është zero. Një grup që kohët e fundit kisha rastin të isha pjesëmarrës në Prishtinë me një numër të konsiderueshëm muslimanësh, grupi i cili quhet "*Kristadelphians*". Ata çdo vit frekuentojnë nëpër Evropë dhe Ballkan me seminarët dhe idetë e tyre. Dështimi i tyre vërehet me të madhe. Të gjithë pjesëmarrësit ishin muslimanë vetëm përkthyesja e tyre ishte e asaj ideje, sepse e paguanin me para të majme.

Një ndër ta Xhon Thorb (John Thorbe) kishte shkruar dhe botuar një libër: "*The Bible and Islam*" ku përmes disa shqyrtimeve të tij filozofike dhe parafrazuese që shpesh të bënin për të menduar sa dredhacak me metodologji të theksuar anti-islame ishte. Ata

vijnë çdo vit por siç vijnë, shkojnë ashtu me “*bisht ndër shalë*“, sepse muslimanët përmes debatit konstruktiv me ta, iu tregojnë se nuk e kanë vendin këtu dhe askund, dhe më mirë të pranojnë Islamin dhe ti kthehen së Vërtetës.

Disa nga ata për t'i ofruar të rinjtë afër vetit organizojnë ahengje dhe kampingje, ku i përzijnë meshkujt dhe femrat duke mos i ndarë ata në grupe, dhe nga ky gjest i hapin rrugë shfrenimit dhe imoralitetit. Dihet se morali tek muslimanët është pika më nervologjike dhe sensible me të cilën nuk guxon askush të luaj. Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Jam ardhur të përsosi vlerat e larta të moralit*“. Kurse Allahu xh.sh. në Kur'an duke aluduar në të Dërguarin Muhamed a.s. thotë: “**Vërtetë ti je në një shkallë të lartë të moralit**“.⁵

Në ditët e këtij shekulli të zhvillimeve të mëdha teknologjike, njerëzimi po manipulohet lehtë nga idetë e gabuara, ku shumë shoqata dhe organizata, në emër të Islamit bëjnë gjëra të ndaluara, të cilat nuk përkojnë fare me Islamin. Andaj, muslimani i vërtetë që kapet për litarin e fesë me dhëmballë, e jo me dhëmbë, arrin t'i kuptojë këto projekte anti-islame dhe anti-njerëzore, për interesa grupore apo individuale, thjesht materiale apo dhe shpirtërore, ideore të keqkuptuara dhe të mos-analizuara mirë.

Zvicër, Basel

01.06.2011

⁵ Kur'an-i: Surja: Kalem, ajeti:4.

5. Disa Pejgamberë të zgjedhur dhe muslimanë fleksibil gjatë kohërave

Në këtë pikë do të mundohemi t'i rrijmë temës bosht. Ideja është të paraqesim në pak fragmente disa veti/mrekulli të disa pejgamberëve dhënë nga Allahu xh.sh. si dhe disa muslimanë *halife* që kanë ditur të udhëheqin masat dhe ti bashkojnë muslimanët. Pejgamberllëku ka përfunduar me hz. Muhamed a.s., këtë duhet ta kemi të qartë, çdokush që pretendon një gjë të tillë, ka dalur nga binarët e fesë dhe shpallet i pafe.

Ideja e këtij problemi duhet të ndahet nga çka ne do të sqarojmë. Adhurimi i takon vetëm Allahut xh.sh. dhe kurrë njerëzve, sepse Allahu xh.sh. nuk ka nevojë për ortak apo shoqëri. Vëllezër të shkojmë në memorien e kohës mijëra vite më parë, kanë qenë dy pejgamberë që Allahu xh.sh. i përmend në Kur'an. Hz. Da'vudi a.s., për të cilin Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Shembullin më të mirë e keni Davudin a.s, i cili një ditë hante dhe një ditë agjëronte, si dhe hante nga puna e duarve të tij dhe kështu ka vepruar gjatë gjithë jetës së tij"*.

Hz. Da'vudi a.s. ishte babai i hz. Sulejmanit a.s., dhe që të dytë ishin pejgamberë, Allahu xh.sh. ua kishte mundësuar shumë cilësi, një ndër to edhe përpunimin e hekurit. Hz. Sulejmani a.s. trashëgoi babanë e tij në sundim, Allahu xh.sh. i kishte dhënë forcë shumë të madhe, saqë ushtria e tij përbëhej nga: *exhinët*, njerëzit dhe shpendët. Saqë edhe milingonat i kishin frikën këtij robi të Allahut xh.sh. dhe pejgamberit të zgjedhur. Allahu xh.sh. thotë: **"... Deri atëherë kur arritën mbi luginën e milingonave, një milingonë tha: O ju milingona, hyni në vendet tuaja që të mos u copëtojë Sulejmani dhe ushtria e tij duke mos iu vërejtur"**.⁶

Me dëgjimin e kësaj, hz. Sulejmani a.s. buzëqeshi dhe falënderoi Allahun xh.sh. për të gjitha mirësitë që i kishte dhënë. Allahu xh.sh. babain e tij hz. Davudin a.s. e kishte dalluar ia kishte zbritur Zeburin. Angazhimi dhe zhvillimi i infrastructures, urbanistikës si dhe arkitekturës nga hz. Sulejmani a.s. me krijesat që Allahu xh.sh. ia kishte nënshtruar, ndodhi që mbretëresha e Sebës (Jemen), Belkiza, që ishte pagane dhe adhuronte diellin, kur hyri në pallatin e hz. Sulejmanit a.s. ajo u trondit me mirësitë që Allahu xh.sh. ia kishte dhënë këtij pejgamberi, dhe pranoi besimin e vërtetë, besoi Allahun xh.sh., Zotin e gjithësisë.

Mësimi që marrim nga ky tregim kur'anor është se Allahu xh.sh. i kishte dhënë pushtet robit të Tij, aq pushtet saqë mund të komunikonte edhe me gjallesat dhe krijesat tjera përveç njerëzve. Çdo pejgamber ka pasur nga një mrekulli të veçantë të cilën Allahu xh.sh. ua ka mundësuar për të bindur njerëzit me fakte se janë pejgamberë dhe jo magjistarë. Rast i tillë është tek hz. Musai a.s. dhe ky një pejgamber, të cilin e ruajti Allahu xh.sh. nga kthetërat e Faraonit. Hz. Musai a.s. u rrit në shtëpi të Faraonit si fëmijë i adoptuar nga gruaja e Faraonit që ishte besimtare dhe quhet Asija.

⁶ Kur'an-i: Surja: En-Neml, Ajeti:18.

Adhuruese e Allahut xh.sh., dhe jo e diellit apo zotërave të tjerë paganë. Një ditë thuhet se hz. Musai a.s. të cilit Allahu xh.sh. i zbriti Tevrat, librin e shenjtë në kodrën e Sinait, si fëmijë iu kishte afruar Faraonit dhe në shenjë loje e kishte tërhequr për mjekrre, dhe Faraoni kishte reaguar:” *a mos është ky vogëlushi që e kam parë në ëndërr i cili kur të rritet do të ma shkatërroj pushtetin?* Allahu xh.sh. kur dëshiron e ruan robin e Tij pikërisht në atë vit që kishte lindur hz. Musai a.s., Faraoni kishte dhënë urdhër që të gjitha foshnjat e këtij viti të mbyten, nëna e hz. Musait a.s. e kishte futur në një arkë birin e saj dhe e kishte hedhur në lumin Nil dhe valët e kishin dërguar përpara syve të gruas së Faraonit që nuk kishte fëmijë dhe u mrekullua nga pamjet e fëmijës dhe e adoptoi.

H. Musai a.s. u rrit në oborrin e Faraonit dhe kuptonte çdo ditë gabimet dhe padrejtësitë e Faraonit që i bënte popullit të tij. Një ditë hz. Musai a.s. duke ecur shikoi dy vetë, njëri bënte padrejtësi tjetrit dhe ai hyri t’i ndante, por ai që ishte gabim reagoi shumë, dhe hz. Musai a.s. në vetëmbrojtje e goditi me lehtësi, por fuqia që i kishte dhënë Allahu xh.sh. atij, ishte prej mrekullive. Njeriu vdiq nga goditja e hz. Musait a.s. dhe *kaderi* i Allahut xh.sh.. H. Musai a.s. me këtë rast u pendua dhe vendosi që të largohet edhe nga Faraoni dhe nga ajo shoqëri e të padrejtëve. Bëri *hixhret* ashtu siç ka bërë hz. Muhamed a.s. në vitin 622 nga Mekka në Medine. H. Musai a.s. u nis në shkretëtirë dhe braktisi qytetin dhe padrejtësitë që bëheshin aty. Në kodrën e Sinait i zbriti Tevrat dhe iu dhanë mrekullitë, shkopin të cilin e mbante dhe bëhej si gjarpër i madh me lejen e Allahut xh.sh. dhe dorën kur e fuste nën sqetull i bëhej e bardhë dhe e pa të meta, këto dy mrekulli nga ana e Allahut xh.sh. dhuruan këtij pejgamberi.

H. Musai a.s. kur ishte në takim/ballafaqim me magjistarët, ata i thonin se hz. Musai a.s. me vëllanë, hz. Harunin a.s. kanë ideologjinë që si dy magjistarë ta mashtrojnë popullin me besimin e tyre. H. Musai a.s. iu tha t’i hedhin ata të parët magjitë e tyre, ata i hodhën magjitë, disa shkopinjë të vegjël që lëviznin si gjarpërinjë. H. Musai a.s. hodhi shkopin e tij dhe u bë një gjarpër i madh që gëlltiti të gjitha magjitë e tyre. Disa nga magjistarët menjëherë u përkulën duke rënë në *sexhde* dhe thanë: “*I besuam Zotit të hz. Musait a.s. dhe hz. Harunit a.s., që të dy vëllezër/pejgamberë të Allahut xh.sh.*”. Faraoni i tërbuar pas gjithë atyre fakteve, ende nuk u ndërgjegjësua dhe sërish filloi me arrogancën e tij. Faraoni iu tha magjistarëve të vet se do t’u priste duart dhe këmbët tërthorazi për shkak se iu bindën Zotit të gjithësisë. Përgjigja e tyre ishte ashtu siç na tregon Kur’ani Famëlartë: **”Ata thanë: Pasha atë që na krijoi, nuk të japim përparësi ty ndaj argumenteve që na erdhën, e ti bëje atë që mendon ta bësh, dhe mund të zbatosh vetëm atë që i takon jetës së kësaj bote”**.⁷

Faraoni vdiq në detin që hz. Musai a.s. e hapi me lejen e Allahut xh.sh. dhe kaloi me popullin e tij. Në momentin e vdekjes kur i erdhi shpirti në gropë të fytit, tha: besova në Zotin e hz. Musait a.s., por atëherë ishte vonë. Në lidhje me këtë po e përmendim hadithin e Pejgamberit a.s. që thotë: **”Në dy raste nuk pranohet pendimi: 1) Kur shpirti është në gropë të fytit dhe 2) Kur dielli lind nga perëndimi”**.

⁷ Kur’an-i: Surja: Ta Ha, ajeti:72.

Sa i përket hz. Isait a.s., peygamber të cili Allahu xh.sh. i zbriti Inxhilin, dhe krishterët më vonë nga Pali, që ishte korruptues numër një i shkrimeve biblike, të cilat u ndryshuan. Hz. Isai a.s. ishte një peygamber, modest, të cilin Allahu xh.sh. e krijoi pa baba, si shembulli i njeriut të parë në tokë, hz. Ademiti a.s., i cili u krijua nga balta, pa nënë dhe pa baba. Duke mos i rënë gjatë, hz. Isai a.s. i urdhëronte *beni israilët* që të adhurojnë Allahun xh.sh. dhe jo atë, ai u tregonte se ishte një i dërguar si të gjithë të dërguarit e mëhershëm.

Hz. Isai a.s. nuk u kryqëzua dhe as nuk u vra, atyre iu përngjasua. Atë e morri Allahu xh.sh. dhe e ngriti të qiell dhe e shpëtoi nga mizoria romake dhe tradhëtia izraelite. Në kryq u kryqëzua Juda, i cili kishte tradhëtuar mësimet e Inxhilit dhe idetë e hz. Isait a.s. dhënë nga Allahu xh.sh. me shpallje. Hz. Isai a.s. ngjallte të vdekurin dhe shëronte të sëmurët me lejen e Allahut xh.sh.. Ndërsa hz. Muhamed a.s. është vulë e të gjithë këtyre peygamberëve ku pas tij nuk do të ketë më tjetër. Peygamber ky, të cilin i zbriti Kur'ani si Dalluesi të Vërtetës nga e kota si dhe Sqarues për njeriun duke e nxjerrë nga errësira në dritë.

Hz. Muhamed a.s. është i Dërguari i fundit dhe ne jemi pasues të Traditës së tij. Vetitë e tij, diplomacia, morali, idetë si dhe zgjedhja e tij si Emin/Besnik dhe njeri i dërguar për mbarë njerëzimin flasin shumë: Në një ndër 100 njerëzit më me ndikim në botë në listë renditet i pari. Ai me lejen e Allahut xh.sh. edhe pse analfabet, nxorri nga pellgu i errët i injorancës popullin arab dhe duke shpënë këtë ndriçim dhe udhëzim në tërë botën, ku edhe sot me shumë se një miliardë e gjysmë muslimanë ndjekin këtë rrugë të sigurt dhe të drejtë.

Ai ndau hënën me lejen e Allahut xh.sh., dhe nga gishtat e tij, pinë ujë me qindra ushtarë muslimanë. Ai tregoi për të kaluarën, vendosi ekuilibrat dhe drejtësinë e Allahut xh.sh. në Tokë në të gjallë të tij. Paralajmëroi dhe tregoi për të ardhmen, nga ajo që Allahu xh.sh. i ka shpallur. Pra, këta peygamberë dhe shumë të tjerë që janë përmendur dhe që nuk janë përmendur në Kur'an, janë misionarë dhe thirrës, që të adhurohet Allahu xh.sh. si Një dhe i Vetëm. Njerëz fleksibil kanë qenë edhe *sahabët*, *tabiinët* dhe *tabii'tabiinët*, këto gjenerata të arta si dhe dijetarët e që i pasuan ata deri në ditët e sotme.

Tani do të flasim rreth disa personaliteteve në historinë islame, po shumë kalimthi. Umer ibn Abdulazizi i cili kur çliroi Jeruzalemin iu dhanë çelësat e kishave, sepse priftërinjtë më shumë u besonin muslimanëve sesa vetë krishterëve të tyre. Ai udhëheqi me tolerancë ndaj feve të tjera si *halife* dhe punoi me ligjin e Allahut xh.sh.. Tarik ibn Zijadi dhe Musa ibn Nusejri të cilët çliruan Spanjën, duke e lulëzuar Islamin atje për afro 800 vite.

Salahudin Ejubi, i cili në shek. XI mbledhi fiset *saraqene*, aziatike duke riçliruar Jeruzalemin pasi ishte pushtuar nga ushtritë e kryqatave, pas fitores ai nuk masakroi askënd dhe as maltretoi por i la të lirë ku disa shkuan dhe disa qëndruan. Ky njeri me besim të lartë arriti t'i bashkojë muslimanët në momente shumë kritike.

Sulltan Mehmet Fatihu i II-të cili e çliroi Stambollin nga dinastët bizantinë dhe ktheu Aja Sofinë në xhami dhe atje Islami lulëzoi më 1453 kur ndodhi ky çlirim. Njerëz të tillë kishin besim të fortë dhe iu bindeshin urdhërave të Allahut xh.sh. andaj ditën të udhëheqin dhe të çlirojnë me mençuri dhe maturi.

Shkup, Maqedoni

05.06.2011

6. Islami dhe shekullarizmi

Njeriu i parë hz. Ademi a.s u krijua nga llojet e elementeve të ndryshme të tokës dhe si krijesë e Allahut xh.sh. ishte e padijshme dhe e panjohur me botën që e kishte përpara ashtu siç është një foshnje apo fëmijë i vogël që është impulsiv dhe dinamik të njohë të panjohurën, ashtu Allahu xh.sh. i dërgoi melaiket tek hz. Ademi a.s., babai i njerëzimit, që ato t'ia mësojnë atij emrat e sendeve.

Islami është dituri për njeriun shpalljet hyjnore janë të drejta nga Krijuesi i gjithësisë, Allahu xh.sh. i cili ua dërgoi rradhazi profetëve si p.sh.: hz. Musait a.s., (Tevratin), hz. Davudit a.s. (Zeburin), hz. Isait a.s. (Inxhilin) dhe hz. Muhamedit a.s. (Kur'anin). Gjithë këta libra hyjnorë janë fjala e Allahut xh.sh. e cila iu përshtat kohës dhe rrethanave ekzistuese të shoqërive jetësore të çdo brezi dhe gjenerate. Në secilin libër hyjnor kemi udhëzuesin e jetës për larmitë e ndryshme të fushave që ndjekë krijesa njerëzore, si fjala vjen: shkencën, ligjet, rregullat, moralet, udhëzimet, dhe çdo gjë që i nevojitet njeriut në jetë.

I. Dallimi dhe diferencimi

Librat hyjnor të përmendura më lartë ishin për shoqëritë e mëhershme duke u ndarë në stade dhe cikle jetësore periudhash, me përjashtim të librit hyjnor të fundit, pra Kur'anit i cili është valid edhe për kohën tonë sepse i takon periudhës së fundit të përmbylljes së kapitullit njerëzor ashtu siç ishte hz. Muhamed a.s si përmbyllës i pejgamberëve dhe vulë e tyre. Kur'ani në dallim prej librave të mëhershëm nuk u ndryshua, u ruajt nga Krijuesi sepse si i tillë ishte dhe është destinuar të përmbledhë gjithë vëllezërit e tij dhe vetë si i fundit të na udhëheq gjer në fundin e kësaj bote.

Leximi logjik i gjithë librave të mëhershëm dallon dhe vëren kundërthënie të mëdha, si në Tevratin e ndryshuar apo Torën ashtu dhe në Inxhilin e ndryshuar apo Biblën ku edhe emrin e merr nga Byblosi i Fenikasve në rajonin e Libanit të sotëm ku panteon apo kryezot i zotërave ishte perëndia Baal, Kur'ani e përmend në kohën e hz. Iljasit a.s.. Sa i takon Tevratit apo Torës i cili manifeston dhunën dhe terrorin e ekstremistëve hebrejë ku e shprehin qartaz se *“ata që nuk janë në lidhje gjaku hebrejë duhet të vriten si derra e edhe më keq”*. Rrënjët sekulariste edhe pse nocioni është modern ku dhe vetë fjala modernizëm u përdor nga priftërinjtë për t'i dalluar shkrimet e tyre të vjetra nga ato të rejtat. Shekullarizmi apo ndryshe siç njihet në fjalorin e sociologjisë *“lëvizja kundër feve apo fesë”* është paraqitur në kohëra dhe më të hershme se ajo e shek. të XX.

Nga të gjitha religjionet e mëdha të botës, vetëm krishterizmi selinë e vet nga Jerusalemi e vendosi në Romë, duke simbolizuar kështu Perëndimizimin e krishtërit dhe përfshirjen shkallë-shkallë dhe suksesive të elementeve të Perëndimit, të cilët në histori kanë prodhuar dhe përshpejtuar elemente të shekullarizmit.

II. Ku lindin pasojat?

Perëndimizimi dhe ngjallja e ideve pagane artistike apo illuminative përmes artit vizuel me shtatoret dhe idetë monstruoze të shoqërive solli pasoja ndikuese të mëdha. Popujt filluan të mos i adhurojnë idetë burimore dhe të sakta por ato të ndikuara nga filozofia laike, mitike, sekulariste e përzier në traumat e shoqërive injorante e të padijshme duke vrapsuar pas këtyre ideve siç vraponin barbarët dhe sllavët pas pasurive dhe plaçkës duke djegur dhe rrënuar kulturat me vlera tejet të çmueshme.

Shprehja: “*Jepini Cezarit atë që i takon dhe jepini Hyjit atë që i takon*”⁸ është një slogon apo parullë që sekularistët e përdorin si kinse ndarje e fesë nga shteti. Kjo shprehje është kokë e këmbë politeizëm filozofik i indoktrinuar dhe i injektuar tek masat e gjëra duke e krijuar vendin e vet si temë absolute dhe e padiskutueshme. Ne jemi dëshmitarë se njeriun i madhi Allah xh.sh. e mësoi të shkruaj dhe mësoj, dhe e krijoi në formën më të bukur, ta mënjanojë këtë dhe ta ndashë një të vërtetë që përmban gjitha të vërtetat në dy, pra atë “Laike dhe Fetare” ku bile bile ka filluar e para të mbizotëroj shumë tek shtetet dhe masat e gjëra globale.

Vetvetiu krijohet një idol e ai është adhurimi i simboleve sekulariste-laiciste apo siç e quan Bibla “*Cezareske publike*” dhe lihet pasdore ajo e shenjta dhe mbi të gjitha ajo që e udhëheq sistemin e gjithë kësaj krijimtari që ka një Krijues dhe Rregullator. Atdheu apo flamuri ide e rrënjësuar tek masa theksohet tepër duke u adhuruar dhe duke harruar konceptin hyjnor dhe tek disa fe kyçe, idetë e saja i dirigjon si të dojë pushteti laik .

III. Islami - e Vërteta dhe shekullarizmi - e pavërteta e arritur

E vetmja fe e cila nuk ka ndryshime dhe i vetmi libër i cili u ka rezistuar kohërave është Kur'ani. Allahu xh.sh. thotë: “**Ne me Madhërinë Tonë e zbritëm Kur'anin dhe Ne jemi mbrojtës të tij**”.⁹ Shekullarizmi u shfaq në periudha të ndryshme ndërsa kulmin e arriti në kohërat moderne dhe bashkëkohore duke luftuar politikisht dhe në mënyrë diplomatike ta ndajë pushtetin nga feja, gjë të cilën e arriti ta bëjë.

Origjina e tij fillon nga hyjnitë pagane dhe mendimet e lashta të popujve *Beni Izraelit* që luftuan të vërtetën, i rrahën, i keqtrajtuan, i vranë dhe masakruan profetët, ishin të pabindur ndaj urdhërave të Zotit shpallur pejgamberëve, ishin mosbesues, mohuan dhe morrën hidhërimin e të madhit Allah xh.sh. pasiqë e tepruan me mohimin, abuzimin, mospërmbajtjen dhe teprimin e tyre kundër rregullave hyjnore gjatë ecejakjeve kohore që nga gjeneza e njerëzimit të pabindur plotësisht.

Tropojë - Shqipëri 2011

⁸ Bibla: Ungjilli sipas Mateut, kapitulli 22, citati 21.

⁹ Kur'an-i: Surja: Hixhr, ajeti: 9.

7. Miti, komunizmi dhe historia

Kur debatoja me profesorët dhe me disa studentë të katedrës së Historisë, gjithmonë ata mendonin se nuk do të kenë pengesa në disa tema që trajtonin, mirëpo ata nuk e dinin se kultura, leximi dhe studimi që mund të bëjë një njeri i thjeshtë mund të ngre teori aq të forta sa të hedhë poshtë tërësisht idetë bindëse verbale që mund të jenë formuar nga miti ose komunizmi të paraqitura në në këndin historik.

Historia e mentaliteteve si fjala vjen studimi i figurës së: Skënderbeut, Hitlerit, Stalinit, Mahatma Gandit, Enver Hoxhës etj., na paraqet para nesh disa figura që janë hiperbolizuar nga masa tejmasë duke u mitizuar aq shumë sa të arrijnë gradën e lartë të kultit, duke u bërë hyjnorë, nganjëherë duke thyer edhe këtë doktrinë duke dalë mbi hyjnzim apo shkurt e shqip duke i shpallur luftë Hyjnisë dhe Profanes, tek komunizmi kjo dukuri katastrofike për kulturën dhe qytetërimet.

Njeriu i parë në rruzullin tokësor u ballafaqua me shumë gjëra si fjala vjen me: krimin, vrasjen, shiun, borën, erërat, tërmetet, dukuritë evolutive natyrore, hyjnore, fizike dhe metafizike. Por njeriu nga ideologjitë e dështuara u kthye në një temë tabu duke anatemuar të vërtetën reale shpeshherë duke e falsifikuar atë me të madhe. Koha dhe njerëzimi ndahet në këta sektorë:

1. Kur njeriu u informua për shumë gjëra dhe njihte një Zot.
2. Kur njeriu e humbi rrugën e vërtetësisë duke ndërtuar zota gjigandtesk nga vetë dora e tij.
3. Kur njeriu filloi të mendojë dhe konceptojë veten se ai vet është zoti.
4. Kur njeriu filloi t'i adhurojë kafshët, bimët, shpezët etj.
5. Kur njeriu filloi të analizojë dhe mendojë duke krijuar idetë materialiste duke ndjerë dhe nuhatur vetëm anët e prekshme.
6. Kur njeriu filloi të shikojë industrinë, anën ekonomike më vonë edhe teknologjike, dixhitale, kompjuterike etj..

Sipas mendimit të Melkos, që e përmend Huntingtoni, ekzistojnë së paku dymbëdhjetë qytetërimi kryesore, shtatë prej të cilave nuk jetojnë më: (i Mesopotamisë, i Egjipti, i Kretës, ai Klasik, Bizantin, Mezo-amerikan dhe i Andeve) dhe pesë që vijojnë të jetojnë (Kinez, Japonez, Indian, Islam dhe Perëndimor). Këtyre pesë qytetërimeve do të ishte e dobishme t'u shtoheshin në botën bashkëkohore: qytetërimi Ortodoks, Latino-amerikan dhe ndoshta qytetërimi Afrikan. Ndër qytetërimet kryesore të sotme, sipas Huntingtonit janë :

1. Sinik,
2. Japonez,
3. Hindu,
4. Islam,
5. Ortodoks,

6. Perëndimor,
7. Latino-amerikan,
8. Afrikan (i mundshëm).

Duke u ballafaquar me këto sfida, disa civilizime mbetën të prapambetura duke u trashëguar nga një shoqëri *mesquine* diletantësh, duke i përtërirë ato në shoqërinë e integruar njerzore. Ide të tilla ishin si fjala vjen: Obskurantizmi (doktrina kishtarë që i kundërvihet me çdo gjë shkencës dhe avancimit njerëzor) apo teoria e evolucionit duke sjellur mostra dhe ekzemplarë të falsifikuar, duke e krahasuar njeriun me majmunin, duke nxjerrë në skenë idenë e racave superiore dhe inferiore.

Komunizmi e ka gjenezën më heret se komuna e Parisit, sepse shumë e mendojnë këtë, edhe pse ky u theksua nga: Marks, Lenini, Bolshevikët etj.. Problemi duhet parë thellë pa konspiracione, kur përmendëm civilizimet dhe qytetërimet e hershme duhet theksuar se disa qytetërimet në vakuum e sipër janë zhdukur mirëpo disa i kanë rezistuar kohës dhe faktorit ambient apo natyrë siç i thonë natyralistët, ata që i shpëtuan apokalipsit mbajtën ego të fortë se janë më superiorë se ata tranzitët që kishin jetë nomade apo endacake por në mesin e tyre nuk mund të themi se nuk kishte të mirë që i shërbyen njerëzimit me shkrime, ide dhe të mira të përgjithshme.

Idetë e popujve apo grupacioneve të egra, të frymëzuara me idenë e plaçkës si fjala vjen: popujt sllavë, dhe ata grabitës siç ishin: hebrejtë, që vraponin pas luginave dhe vendeve me pasuri e minerale të çmueshme, u materializuan dhe filluan ta shikojnë botën me syrin e monetës apo anës fizike çka është e prekshme nga dora, ku më vonë mesjeta e quan prodhim *manifaktivist*, e më vonë modernizmi, industrializmi, kapitalizmi etj..

Miti i sistemit një partiak u zhvillua shumë në vendet që mendonin botën e egërsisë dhe dhunës cenzuruese nga qendra, si p.sh.: Faraoni, Perandori, Mbreti, Monarku Absolut, dihet ku u shfaqë kjo ide me të madhe në vendet sllave, aziatike, duke ardhur edhe në disa vende të Evropës fatkeqësisht. Gjeneza e historisë së njerëzimit kaloi trajektore të ndryshme por njeriu i arsyeshëm arriti ta kuptojë se ku ishte marrëzia dhe rënia e tij, duke qenë koshient me veten filloi të mendojë më shumë duke i thënë stop mitit dhe komunizmit i cili i solli miliona viktima njerëzimit.

Prishtinë 2011

8. Çfarë duan Shqiptarët ?

Origjina jonë shpesh herë paraqitet në suaza interesante. Nganjëherë mendohet thellë se gjeneza jonë fillon nga pellazgët tek ilirët, mandej arbërit e deri tek shqiptarët. Herodoti e tregon qartë paganizmin e shthurur të pellazgëve që e rrethuan Dodonën dhe në lapidarët e tyre famëmëdhaja bënë dhurata për perënditë e Olimp. Lindja dhe perëndimi shpeshherë paraqiten si një dritë-hije apo një strumbullar i gjenezës së të menduarit njerëzor. Lufta e pandarë e ndjeku dhe po e ndjekë njerëzimin në ballafaqimin e dy rrymave të kundërta, asaj monoteiste me atë politeiste. Shpeshherë monoteizmi triumfon, por ka epoka që gjendet në minorancë, sepse ka raste që politeizmi bëhet modë, varësisht nga rrethanat e kaosit logjik të të menduarit arsyetueshëm nga njerëzit.

Pellazgët ashtu si etrusët në vakuum e sipër zbritën nga lindja dhe e përfshinë perëndimin. Ideja e tyre politeiste filloi të ndërtojë zota dhe shtatore duke ua ndërruar emrat si fjala vjen, tek romakët Jupiteri, e tek grekët Zeusi. Shqiptarët si përfaqësues të denjë të popullit arbëro-ilirë, kishin një periudhë tranzite grupacionesh fisnore-klanore, dukuri e tillë e theksuar edhe në ditët e sotme që shoqëritë moderne janë të integruara në botën e teknikës.

Politika e perandorisë bizantine i quajti shqipëtarët *romej* në shenjë mospërfillje dhe inferioriteti ndaj tyre, politikë e cila do të zgjasë me idetë e saja të rigjeneruara deri në kohën moderne e bashkëkohore. Këtë e dëshmon qartë ringjallja e Naçertanijas dhe Megalidesë më 1844, e para serbe dhe e dyta greke, kurse të dyja projektohen në të njëjtin vit dhe janë një brumë me origjinë bizantine, por me një synim, ngrënien e presë ballkanike në mënyrë specifike, atë shqiptare, duke penguar autonominë dhe pavarësinë shqiptare.

Perandoria Osmane e keq-interpretuar nga pseudo-shkencëtarët komunistë dhe pan-sllavistë në historiografi është falsifikuar dhe i është mveshur një imazh tepër i keq për shqiptarët. Nuk mund të lë pa përmendur: Mimar (Arkitekt) Sinanin, Halil Patronën, Sami Frashërin e shumë figura të tjera të njohura, disa prej tyre të përmendura në veprën e Samiut: “ *Kamus el-A'lam* ”. Çka kërkojnë shqipëtarët? Bashkimin Evropian, i cili po ua rrjep lëkurën e po u thotë integrohuni, se ne nuk qenkemi të integruar dhe të kulturuar e paqësorë më shumë sesa serbët. Se çfarë bënë serbët, ka shumë të flasësh por dy gjëra do të përmend:

1. Masakrën dhe gjenocidin ndaj myslimanëve të Srebrenicës në Bosnjë, dhe
2. Masakrën dhe gjenocidin ndaj myslimanëve të Reçakut në Kosovë.

Pra, kjo është Evropa, e cila në vitin 1913 e ndau Shqipërinë, duke i dhënë sllavëve të ardhur tokat shqiptare dhe duke i ndarë vilajetet që Perandoria Osmane ua kishte lënë shqipëtarëve si prona, që t'i udhëheqnin dhe menaxhonin për të mirën e

tyre. Sipërfaqja gjeografike e shqipëtarëve dokumentohet qartë përmes këtyre dy të dhënave statistikore:

1. Gjatë Perandorisë Osmane, Shqipëria etnike me 1912 i kishte 52.000 km² dhe 1.550.000 banorë, nga këta ishin 1.330.000 ose 83% shqiptarë.
2. Shqipëria e pavarur pas 1912 i kishte 28.000 km² dhe 740.000 banorë, nga këta 96% shqipëtarë.

Pra këtu vërehet se kush na ndau dhe kush na mbajti unik me njëri-tjetrin. E ardhmja nuk është Bashkimi Evropian ku në emër të tij, droga, prostitucioni, alkooli, vetëvrasja, korrupsioni, dhuna e shumë e shumë dukuri të fëlliqura që manifestohen si shkak i humbjes së logjikës dhe kulturës etike njerëzore morale e fetare.

Prishtinë 2010

9. Islami dhe civilizimi perëndimor

Lindja dhe perëndimi e ka gjenezën shumë të hershme sa vetë ekzistenca e njeriut që filloi të kapë gjërat e padijshme në rrethin apo ambientin që e rrethonte. E pushtuar me ngjyra dhe kultura atraktive lindja ashtu dhe perëndimi kishin hyrje dhe dalje që nga parahistoria duke vazhduar në antikitet me ngritje në mesjetë në linjë të vazhdueshme me epokën moderne dhe bashkëkohore në kohë dhe hapësirë. Fjala “Islam” ka derivuar nga rrënja e fjalës “Slm” që në gjuhën arabe, veç të tjerash, do të thotë “Paqe, Pastërti, Nënshtrim, Bindje”.

Ndërkaq, në kuptimin fetar “Islam” do të thotë: *“Nënshtrim ndaj Zotit dhe bindje ndaj ligjeve të Tij”*. Lidhja ndërmjet kuptimit gjuhësor dhe fetar të kësaj fjale është e qartë dhe e fuqishme, e cila ka zënë vend në lindje dhe perëndim gjatë çdo kohe që ka frymuar njeriu.

I. Pasiviteti lindor dhe gjallëria perëndimore

Edhe pse kulturat dhe qytetërimet e hershme fillojnë dhe vijnë nga lindja si nga qytet-shtete e para “Mesopotamia, Egjipti, Babilonia, Fenikia etj., ne jemi dëshmitarë të një tranzicioni dhe vakuumi të madh kulturash që barten nga lindja në perëndim. Grekët fjala vjen marrin alfabetin nga fenikasit, etrurët të shpërngulur nga zia e bukës nga Azia, sipas Karl Grimbergut, e ndërtojnë Italinë, pellazgët e krijojnë mitin edhe këta të ardhur nga lindja. Kultura e Kretës dhe Troja e famshme e Homerit e kanë zanafillën dhe pikën orientuese në lindje edhe pse perëndimorët bënë revolucion modern me këto ide duke i artikuluar dhe praktikuar në të mirë të tyre.

II. Koncepti Islamo-perëndimor

Historiani anglez Xhemberi shkruan: *“Vërtetë lapsi nuk është në gjendje t'i shkruaj tërë kontributin e muslimanëve për kulturën, civilizimin dhe lumturinë e jetës së njerëzve”*. Ata ishin që kultivuan evropianët dhe promovuan progresin e tyre. Kurse prof. Zhan Bertrand, i Universitetit Kembrixh shkruan: *“Kur Evropa po mbytej në pikëllim, mjerim, varfëri materiale dhe shpirtërore, muslimanët e Spanjës ndërtuan një civilizim të madh, me një sistem të jashtëzakonshëm ekonomik. Spanja muslimane ka luajtur rol të rëndësishëm në shfaqjen dhe zhvillimin e industrisë, shkencës, filozofisë dhe poezisë. Në shek. XIII Islami kishte bërë ndikim tek mendimtarët më të shquar të Evropës, siç janë: Dante Aligeri dhe Toma Akuini. Prandaj, Spanjën duhet emërtuar si fanar të civilizimit evropian”*.

Islami dhe civilizimi perëndimor janë lidhur ngusht së bashku që nga gjeneza e ekzistimit të popujve *semitik* dhe *indoeuropian* duke imituar kulturat e palëve ndërmjetëse dhe duke nxjerrur në pah doke, zakone, kostume, shprehi, ngjyra tradicionale të reja jetësore në shoqërinë ndërkontinentale.

10. Islami dhe shek. XXI

Në këtë temë, Islami dhe shekulli XXI, shekull në të cilin po përjetojmë në gjenerata e re duket shumë interesante për kohën. Pse duket interesant sepse i përshtatet çdo sistemi dhe kohe. Sot njerëzimi dhe bota lindore dhe perëndimore ka nevojë shumë për Islamin. Me mijëra gjermanë, anglezë, italianë, francezë kthehen në Islam çdo vit, kjo duket se njerëzit janë të zhgënjyer nga bestytnitë dhe idolet boshe të cilat shpesh herë duken absurde për një evropian me logjikë të pastër. Përkundër shpifjeve dhe sulmeve të anti-islamëve ndaj këtij religjioni të pastër, Zoti i Plotfuqishëm u drejtohet me këto fjalë në Kur'anin Famëlart pabesimtarëve: **"Ata dëshirojnë me gojët e tyre ta shuajnë dritën e Allahut, e Allahu nuk dëshiron tjetër, përveç ta përsosë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë!"**.¹⁰

Më ka rënë rasti të shoh një fenomen ekstremisht interesant, një ushtar i Kforit po kthehej tek familja e tij në Amerikë, i cili kishte urrejteje ndaj Islamit dhe muslimanëve dhe luftonte në Irak, me t'u kthyer në shtëpi nuk arriti dot t'u besonte syve të tij, gruaja e tij ishte mbuluar dhe vajzat poashtu kurse djali falte pesë kohët e namazit. I pikuan lotët nga sytë dhe pas kësaj e kuptoi realitetin, se Islami nuk është ashtu siç ai e kishte menduar pasi shfletoi dhe kuptoi mirë librin e Allahut të Plotfuqishëm, vetë fjalën e tij Kur'anin Famëlart dhe të qartë. Feja Islame në Europë është bërë një nga çështjet më të debatueshme në qarqet mediatike dhe akademike përse i takon rolit dhe pozicionit që kanë muslimanët në shoqëritë perëndimore, apo i identitetit të tyre.

Ideja e një shkrimi të tillë më lindi nga një artikull që lexova në gazetën "Telegraph" sipas së cilës Islami është feja më e praktikuar në ishullin britanik. Gazeta i referohet një studimi të bërë nga një organizatë e quajtur "*E ardhmja e Kishës*" e cila parashikon që në vitin 2040 numri i muslimanëve që marrin pjesë në faljen e ditës së premte do të jetë dyfish më i madh sesa numri i të krishterëve që marrin pjesë në shërbimet e ditës së diel. Sipas raporteve të paraqitura nga qeveria britanike dhe burimeve akademike, statistikën e vitit 2004 tregojnë që rreth 930.000 muslimanë shkojnë në xhami të pakten një herë në javë, krahasuar me 916.000 ndjekës të kishës së Anglisë. Sipas studimeve të bëra nga organizata tepër prestigjioze, Islami është tashmë feja me rritjen më të shpejtë në Europë. Më tepër se 53 milionë muslimanë jetojnë në Europë, 14 milionë prej të cilëve në BE. Franca ka numrin më të madh me 5.5 milionë, ndjekur nga Gjermania me 3.2 milionë dhe pastaj Mbretëria e Bashkuar me 1.8 milionë, Italia me 1 milionë, etj.

¹⁰ Kur'an-i: Surja Tevbe, ajeti: 32.

Hyrja e Shqipërisë në BE është një plus i madh për lëvizjen e lirë të muslimanëve në tokat perëndimore ku ata do të mundën ta përhapin Islamin jo vetëm brenda territorit të tyre gjeografik por edhe në diasporë tek bashkëvendësit e tyre si dhe tek të huajt duke njohur gjuhët evropiane, kjo është një tregues për të mirën e popujve jo-muslimanë që të pranojnë Islamin dhe të hyjnë në rradhën e muslimanëve që i ndihmojnë të tjerët.

Tani me kujtohet thënia e mendimtarit dhe poetit më të njohur të klasikës gjermane Gëte. Në janar të vitit 1814 ai mori pjesë në një falje kongresionale të së premtes bashkë me muslimanët e ushtrisë ruse të Car Aleksandrit në gjimnazin protestant të Vajmarit. Në letrën për Treban me 5 janar 1814 ai shkruan: *"Kur bëj fjalë për shpallje më duhet të vërej se në kohën tonë po ndodhin gjëra për të cilat asnjë pejgamber nuk do ta kishin lejuar të fliste. Kush do të lejohej përpara disa vitesh që të bënte të ditur se në auditorin e gjimnazit tonë protestant do të mbahej shërbese hyjnore muhamedane dhe se suret e Kur'anit do të murmuriteshin në të, por ja që kjo po ndodhë, dhe ne morëm pjesë në shërbesë, pamë mullain e tyre dhe u uruam mirëseardhjen e tyre në teatër. M'u bë një nderim i veçantë duke m'u dhuruar një hark dhe shigjetë, të cilat në kujtim të përjetshëm do t'i vendosi mbi oxhakun tim sapo Zoti t'u ketë dhuruar këtyre mysafirëve të dashur një kthim të mbarë"*.

Bernard Shaw, një gjigand i letërsisë botërore për Islamin shprehet kështu: *"Gjithnjë e kam çmuar lartë besimin e Muhammedit, thjesht për shkak të vitalitetit të tij të jashtëzakonshëm. Mendimi im është se, Islami është besimi i vetëm i aftë që të drejtojë me sukses ndryshimet e shumta të jetës. Unë parashikoj që Evropa, më në fund do të pranojë fenë Islame"*. Gjë e cila po ndodhë me të madhe në shekullin që po e jetojmë dhe ne gjenerata e re dhe mesatare e umetit të hz. Muhamed a.s..

Prishtinë,
09. mars 2010

11. Ideja e Islamit tek ilirët

Shpesh historia, manipulohet, instrumentalizohet, korruptohet. Korruptuesit më të mëdhenjë janë ata që kanë në dorë frenat e shtetit, në mënyrë që ta bëjnë historinë interes, klientelë që t'i servirin çfarë t'ua do qejfi. Ilirët shtriheshin nga Istri në Ambraki, ishin popull i stërlashtë që la pas shumë gjurmë të kulturës materiale, shpirtërore, fizike, ideologjike, civilizuese, historike, etj. Problemi më i madh është se mbishkrim ilir ende nuk kemi gjetur, vetëm disa fjalë aty-këtu që mendohet të jenë ilire, të gjetura në mbishkrimet romake, pra në ato të pushtuesit, që kanë marrur ndonjë puntorë ilir pranë t'ju shërbejë dhe ai ka lënë ndonjë fjalë aty-këtu të gdhendur në pllakat e gurit dhe mermerit.

Të hyjmë në temë direkt, ku do të paraqes disa dëshmi. Çdo njeri paraqet teori të paqëndrueshme, si ajo e Darvinit që ishte gafë apo dështim i perjudhës industrialiste.

Ilirët janë popull që mendohet të kenë ardhur nga pellazgët, disa historianë pajtohen, kurse kemi disa që nuk pajtohen. Pellazgët vijnë nga Lindja, këtë e paraqet kultura materiale, shpirtërore dhe kulturore. Në Lindje lindën të gjitha fetë e pastërta që adhuronin një Krijues Allahun apo Elohun dhe kishin pejgamberë të ndryshëm, zbritën librat dhe fletushkat që orientonin njerëzit kah e Vërteta, besimi monotesit në një Zot Allahun Suprem.

Librat si: Tevrati, Zeburi, Inxhili dhe Kur'ani si libër i fundit udhëzues për mbarë njerëzimin. Duhet ditur se çdo popull ka pasur pejgamber, mësues, të dërguar, mëkëmbës të Allahut xh.sh.. Allahu xh.sh. thotë:

“ Çdo popull kishte të dërguarin e vet...”¹¹

"Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: Adhuroni vetëm Allahun e largojuni idhujve!"¹²

Në shumicën e çeramikës të gjetur në perëndim ose është kulturë lindore ose imitim i saj. Disa historianë fatalisht duke mos e kuptuar nocionin “Islam” e pikasin atë vetëm në shek. VII, se Islami dhe muslimanët vijnë nga kjo periudhë. Literatura komuniste e quante Islamin - muhamedanizëm, kurse muslimanët - muhamedanë. Ngatërrimi lind këtu tek moskuptimi lingusitik i fjalës Islam që përkon me çdo kohë dhe ideologji të çdo libri monotesit dhe ide të çdo pejgamberi që ka parashtruar në çdo kohë apo hapësirë.

Islami ka ekzistuar me njeriun e parë, sepse është ide e mësimit të njeriut të besojë një Krijues, Zot të vetëm që adhurohet. Një Zot kishte hz. Ademi/Adami a.s, një Zot kishte hz. Nuhu/Noa a.s., një Zot kishte hz. Ibrahim/Abrahami a.s., një Zot kishte hz. Musai/Moisiu a.s., një Zot kishte hz. Isai/Jezusi a.s., një Zot kishte edhe hz. Muhamedi a.s. si vulë e gjithë pejgamberëve.

Gruaja dardano-ilire e gjetur në Kllokot, si dhe shumë murale të tjera gurore të gdhendura, paraqesin në kokë shaminë dhe rreth ballit mbështjellësin, si dhe tunikën e trupit. Ajo daton rreth shek. III p.e.s.. Në të gjithë librat e shenjtë të mëhershëm, popujt dhe civilizimet turpi ka qënë pjesë e shoqërisë, poashtu edhe asaj ilire. Atëherë kur turpi apo morali ka rënë - shoqëritë janë degraduar. Element tjetër tek ilirët është edhe tunika mëngë-gjatë, e njohur ajo Dalmatine, e cila e mbulonte komplet trupin si dhe fustanella mëngë-gjatë dhe e gjërë.

Në çdo shoqëri sikurse sot, kanë jetuar paganët apo politeistët, por krahas këtyre ka jetuar shoqëria e pastër me besim në një Krijues - Zot. Ilirët ishin të njohur për peshkim dhe njiheshin si kultivues të bujqësisë dhe blegtorisë. Nekroplet apo tumat, dëshmojnë shumë gjurmë se ilirët kanë besuar në botën e përtejme dhe ringjalljen. Ata kanë qënë popull modest dhe jo kryelartë si perandorët romakë që “kalin” deshtën ta bënin senator në senatin romak, i njohuri diktatori Kaligula, apo si perandori Neron që djegu qytetin dhe kulturën e Romës.

¹¹ Kur'an-i: Surja: Junus, ajeti: 47.

¹² Kur'an-i: Surja Nahl, ajeti : 36.

Niveli i ulët nga të mirat e tepërta pranonte çdo lloj besimi, sikurse Konstandini, herë ishte pagan e herë krishter. Mirëpo Shën Lauri dhe Shën Flori vdiqën në tempuj bazilikë, e jo në kishë me kryq, ishin besimtarë që besuan një Zot dhe hz. Isain a.s. si pejgamber të Tij, ashtu siç besuan 'As'habu-l-Kehf' apo 'Shokët e Shpellës' që u larguan me besim të pastër dhe monoteist nga paria romake dhe shoqëria e dështuar e kohës dhe u strehuan në shpellë, e Allahu xh.sh. i morri në mbrojtjen e Tij.

Illirët ishin më ndryshe, luftuan për nderin dhe pasurinë e tyre çka edhe përkon me fenë dhe besimin e pastër, e jo si romakët që hanin në kurriz të tjerëve kurse zhvillimin, kulturën dhe çdo gjë e morrën nga Etruskët të cilët, sipas Karl Grimbergut, erdhën nga Lindja, dhe të cilët një zi e bukës i kishte sjellur në gadishullin Apenin, pra në Italinë e sotme. Falë kulturës etruske lindore u ngrit edhe perandoria romake dhe e tërë Italia. Illirët mbetën gjithmonë një popull që mbrojtën vendin e tyre nga pushtuesit, besimi i lartë i tyre monoteist bëri që ata të gjëjnë sërisht natyrshmërinë e tyre edhe pse me dhunë u shtypën nga bizantinët ortodoksë, ata ende ruajtën besimin. Në Perandorinë Osmane, por sipas disa të dhënave edhe në shek. VII nga tregtarët arabë, illirët e forcuan bindjen e tyre dhe besimin, por me të madhe e pranuan Islamin në shek. XVII, ku shumica e gjetën veten aty sepse ishte natyrshmëria e tyre.

Pse nuk u bënë muslimanë bullgarët, rumunët, etj. edhe pse Perandoria aty sundoi me 500 apo 600 vjet, a nuk kishte mundësi ajo ta zhdukte farën e të krishterëve? Jo, por populli shqiptar gjëgjësisht ilir gjeti Islamin apo fenë monotesite në linjën gjenetike, natyrale dhe njerzore, udhëzimi nuk i jepet gjithkujt por është dhuratë prej Allahut xh.sh. që ia jep atij populli apo individit që Krijuesi dëshiron, andaj Allahu xh.sh. na deshti sepse ishim të drejtë dhe mbrojtëm kufijtë tanë edhe pse të tjerët na i morën padrejtësisht, si: romakët -Mesapinë, grekët – Janinë dhe Çamërinë, malazezët –Ulqinin, Krajën dhe Tuzin, e deri vonë sllavët ortodoksë që me dhunë morrën Nishin, vranë shumë besimtarë ilir e shumicën i sllavizuan me dhunë, sepse Kosova me besimtarë muslimanë sikurse edhe dardanët besuan në një Zot dhe ishin popull liridashës dhe jetuan me dashuri e fisnikëri me plot pasuri si tokat e Trepçës në Mitrovicë, që ende sot sllavët duan t'i mbajnë me dhunë.

Prishtinë,

14.09.2011

12. Blerim Latifi dhe teoria e Islamit të shkretëtirës

Sot ka njerëz që vuajnë ende nga kriza e sistemeve diktatoriale, staliniste, maoceduniste, leniniste, enveriste etj. Një pseudo-filozof qeveritar e besa këshilltar, po na tregon se Islami qenka dy llojesh: politik dhe tradicional. Këtij i pëlqejka ai tradicional që kanë pasur stërgjyshërit tanë para kohës enveriste, që në fakt ai Islam ka qënë në kulmin e lulzimit moralokur'anor. Gratë me ferexhe, burrat me mjekërra dhe xhamitë e mbushura në çdo fshat, qytet dhe mahallë. Fotografitë e kohës flasin për një Islam të bollshëm dhe të vërtetë mbi baza fundamentale islame.

Filozofia është reflektim për jetën kurse Islami mësim dhe rregullim i jetës. Blerim Latifi me idetë e tij monstruoze, arkaike, të mbetura dhe transportuara që nga koha e diktaturës burbone apo që nga kalorësit templarë akuzon dhe etiketon Islamin me terrorizëm. Injoranca e tij nuk njeh kufi saqë duket aq qesharak sa merr rolin edhe të një teologu thuase ka studiuar Kur'anin dhe Islamin, duke mos pasur lidhje dhe njohuri rreth fesë islame.

Islamizmi politik thotë ai është anti-amerikanizëm por më mirë me i thënë atij anti-masonizëm. Ne muslimanët nuk urrejmë asnjë komb e asnjë popull sepse të gjithë jemi bijtë e hz. Ademit a.s.. Blerim! nese lexon shkrimin tim dua të tregoj në disa pika Islamin e shkretëtirës dhe Kur'anin që ti e përbuzë me ironi si diçka arkaike - 1400 vjeçare.

Ja pikat më poshtë dhe uroj që zemra yte të blerohet me Islam e jo me marksizëm, opiumizëm, ateizëm...

1. Kur'ani është libër fetar.
2. Kur'ani është libër shkencor.
3. Kur'ani është ligj i Krijuesit për krijesat.
4. Islami i shkretëtirës ngriti Universitetin e parë më 840 në Spanjën e sotme.
5. Islami i shkretëtirës ngriti Universitetin tjetër al-Az'harin me 975 në Kajro të Egjiptit kur Evropa ishte në baltë dhe anti-amerikanizmi yt nuk ishte zbuluar ende.
6. 800 vjet muslimanet e ngritën në Spanjën e sotme shkencën me Kur'anin 1400 vjeçar, matematikën, mjekësinë, astronominë, historinë, filozofinë dhe të gjitha shkencat.
7. Al-Idrisi musliman në Siçilinë italiane në 1154 kurse Piri Reisi në 1513, ky i fundit shqiptar musliman ndërtuan hartat e para me iu treguar juve se ku keni shtëpinë, si musliman se e pashë në emision që iu kishte humbur udha në oborr.
8. Blerim! 500 vjet muslimanet osmanlinjë ndërtuan botën me harmoni fetare dhe arkitektonike duke pasqyruar kultura arti në rrugë, si: hamame, ura, çesme, xhami, medrese, me qytetërim e lulëzim e jo shkretëtirë.
9. Blerim! Nobelisi letrar anez Sir Bernard Show tha se në të ardhmen Islami në Angli do jetë feja kryesore e cila do përfshijë perëndimin tënd.
11. Blerim! Romancieri gjerman Gëte tha: "Njeri i shkëlqyer, dritë e Zotit, u përpoq që atë dritë ta përhapte në botë, por bota u ngrit kundër tij. Detyrohet të bëjë kompromis, gjersa të vinte çasti që të ndikonte tek ata. Në histori, kërkova shembullin e një njeriu të shkëlqyer, e atë e gjeta te Pejgamberi Muhamed a.s.".
10. Blerim! Islami është dritë, lule, udhëzim, ilaç, shërim, edukim, jo drogë, tërbim, jo prostitucion dhe korrupsion, Islami është udhëzim, mjekim, drejtim, rregullim. Me një ajet paralajmërim e për ty mësim Allahu xh.sh., Zoti yt, i imi dhe i të gjithëve thotë: **"...sa mohues i forte është ai (njeriu)! Prej çka e krijoi Allahu atë? Atë e krijoi prej një pikë uji dhe e përcaktoi"**.¹³

¹³ Kur'an-i: Surja: Abese, ajeti: 17-19.

11. Blerim! Për fenë islame bëj pak shfletim dhe merr mësim e jo vetëm me akuzim dhe paragjykim.

**Prishtinë,
Korrik 2011**

13. Realitete Historike

Sot një mëngjes i ri me mbrëmjen perëndoi, dhe historia shënoi një ditë plot me dinamikë momentesh e ngjarjesh reflektuese në shoqërinë njerëzore. Personalitetet u vunë në faqen e parë të shtypit ditor, ishin në qendër të vëmendjes kurse populli i thjeshtë lexonte ballinat e punëve ditore të politikë-bërësve që bëjnë historinë dhe mbesin në arkivat e kohës. Thomas Carlyle historian skocez thotë se: *“Historia është histori personalitetesh, gjë e cila manifestohet në realitetin ditor”*.

Kohët e fundit Japonia u trondit ashtu si në vitin 1945 nga bomba atomike, Tsunami dhe tërmeti përfshiu komplet Japoninë, u dridh kryeministri i vendit në pallatin e tij, Naoto Khan ndërsa policët e truprojet mbuluan trupin e tij që ta shpëtonin nga kaosi.

Realiteti historik dallon nga mitet, ajo ka foton me kolorit të theksuar. Për të nuk flasin vetëm kujtimet e njerëzve që kanë përjetuar kohën por edhe dokumentet zyrtare të dorës së parë, sepse kujtimet munden të kenë edhe ndikime politike apo ideologjike apo ngarkesa të njëanshme dhe jo shumë dimensionale.

Shekulli që jetojmë dhe sapo kemi hyrë në të, njeh situatë shumë dinamike me procese metamorfoze momentale dhe shumë të shpejta. Lindja po ballafaqohet me ndryshime popullore si: Tunizi, Libia, Egjipti, Siria, Jemeni etj. Kurse Evropa po ballafaqohet me probleme të mëdha ekonomike dhe krizë politike p.sh.:

- Partitë politike në Belgjikë, Luksemburg dhe Hollandë, që janë edhe vendet në zemër të projektit original evropian, janë të bllokuara dhe të ngërthyera në beteja të pafund me njëra-tjetrën, në kriza qeveritare dhe zënka provinciale;

- Në Evropën Lindore – Hungaria dhe Sllovakia, po përballen me partitë nacionaliste të cilat po ndezin zjarrin e urrejtjes dhe inatit në vendet përkatëse;

- Në Greqi, qeveria aktuale është duke luftuar për të mbijetuar pas trashëgimisë shkatërrimtare që trashëgoi nga qeveria paraardhëse. Për dhjetëvjeçarë me rradhë vendi është drejtuar nga tre familje të vetme që kanë shkëmbyer pushtetin me njëra-tjetrën. Klani i kryeministrit aktual Jorgos Papandreu është një prej këtyre familjeve. Dhe grekët në mënyrë pasive, apo aktive janë adoptuar me këtë sistem.

- Në Shqipëri politika është e palakmueshme, këtë situatë po e krijon vetë Edi Rama lideri i opozitës, i cili synon karrigën me çdo kusht, qoftë puna edhe me revolucion, por si duket nuk po i funksionojnë eksperimentet. Ambasadori amerikan në Tiranë, John Withers deklaroi se në Shqipëri nuk ka krizë politike por krizë të qeverisjes!

- Situata nuk është aspak më e ndryshme në Itali: një nga themeluesit numër një të Bashkimit Evropian ka qenë në një situatë jo të mirë politike prej vitesh. Italianët janë fiksuar pas ekraneve të kanaleve private të manjatit të medias Silvio Berlusconi që është edhe kryeministri i tyre.

Bota sot ka probleme, ajo ka nevojë për paqe. Planeti është i rrezikuar nga garat që po bëjnë kolonistët amerikanë për toka nafte, si dhe nga Irani që prodhon bomba bërthamore dhe sisteme anti-raketore, nga frika se mos kolonizatorët do të ozurpojnë tokën e tyre. Njeriu i bardhë me të ziun i kërcenohet një rreziku, lufta e racave dhe lufta globale si dhe dëmtimi i ekosistemit nga djegiet e shumta. Shpërthimet e reaktorëve bërthamor, dëmtimi i Ozonosferës dhe ndryshimi i botës duke përdorur shumë artificialen në vend të kemi ushqimin natyral planeti është në rrezik.

Ky është një realitet historik i shek. XXI. Duhet ndryshim për të mirën e humanizmit, njerëzimit dhe paqes botërore, ndryshe do të kemi shumë viktima dhe pasoja globale të tepërta të cilat do na shpiejnë në një kaos të ardhshëm botëror.

Prishtinë,

15.03.2011

14. Faraonët me krevata

Një ditë e bukur kaloi dhe populli i mjerë ende e vuan mjerimin dhe papunësinë, mirëqenie sociale nuk ka, punë nuk ka, padrejtësi ka, dhe zullum boll besa. Hakun punëtorit të shkretë nuk ia japin, shpirtin ia nxorrën faraonët me krevata që nuk dijnë vetëmse të krekosen e të flasin. Hosni Mubaraku iku nga Egjipti por mjerisht kemi dhe shumë të tillë që duhet t'i largojmë ndryshe do të vuajme mëkatet e tyre. Allahu xh.sh. thotë: **"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kinie dro Allahun se Allahu di hollësisht për atë që veproni"**.¹⁴

Faraonet kanë qënë edhe më përpara por nuk do të thotë se nuk ka dhe tani të cilet veshen me petkun e deles por zemrën e kanë dhelbër apo ujk. Hz. Muhamed a.s. ka thënë: *"O ju njerëz! Ruhuni nga padrejtësia, ngase ajo do të jetë errësirë në Ditën e Gjykimit"*. Çka kuptojmë me këtë? Kuptojmë që ne duhet të respektojmë të tjerët, t'ua japim hakun e punës dhe të mos abuzojmë me të tjerët, çdo punëdhënës duhet të ketë kujdes me nënpunësin e tij, mos ta ofendojë e kritikojë pa pasur një arsye dhe pa ia dhënë hakun që e meriton.

Kritika fillon nga vetvetja dhe nuk mund të krahasohet deveja me milingonën, sepse deveja është shumë e madhe dhe milingona shumë e vogël, pozitat i kanë të ndryshme. Flasin për tolerance, për drejtësi por drejtësi nuk ka, mjerë populli dhe nënpunësit qyqarë që vuajnë pasojat e faraonëve me krevata që nuk njohin se ka varfëri apo ka njerëz që nuk kanë çati mbi kokë dhe shpesh here mbesin pa bukën e gojës.

**Prishtinë,
22.02.2011**

¹⁴ Kur'an-i: Surja: Maide, ajeti: 8.

15. Studimi i fenomeneve në histori

Duket nganjëherë se bota nuk ka kuptim atëherë kur njerëzit me vështirësi nuk arrijnë ta kuptojnë të kaluarën dhe të arrijnë ta ndërtojnë me të, të tashmen dhe të ardhmen. Fenomenet historike ndodhin në çdo moment si fjala vjen çdo minutë histori apo ngjarje. Kemi histori që definojnë në kohë dhe hapësirë. Mjeshtri i historisë modern Ranke thoshte: *“Pa dokumente nuk ka histori”*, por *“Mjeshtria e historianit - thoshte Bloch është mençuri duke ju paraprirë pasojave”*.

Jemi dëshmitarë okular të shumë problemeve, vendet tona ku flitet gjuha shqipe, historia gojore ka qënë inekzistente dhe na ka munguar një Aleksandër Portelli që të grumbullojmë fakte përmes dëshmimeve nga dëshmitarë okular të ngjarjeve apo fenomeneve. Sot flitet për “Everyday History - Çdo ditë histori” kjo vërtet që në shikim të parë duket komplekse por dhe aq e frikshme por realisht shumë reale dhe shumë aktuale për kohën.

Në veprën “Fenomenologjia”, të filozofit Edmund Hyserli theksohet se sot ne në Ballkan përballemi me fenomene ku vërtet qeveria si duket i ka lënë pasdore fenomenet dhe shkencëtarët e talentuar. Por ka njerëz që lënë gjurmë në memorijen e njerëzimit, njerëz që bëjnë epokë nga më të thjeshtit, p.sh.: studentë që arrijnë të zbulojnë formula matematikore që sfidon shkencën ndërkombëtare apo dhe njerëz që e kanë shkruar historinë me gjak e me dhunë ose prej atyre që janë simbol i paqes.

Një pjesë të rëndësishme sot luan edhe historia e ideologjisë, studim i ka bërë Collingwoodi, e cila edhe pse në kohën e komunizmit ka pasur ndikim me të madh. Në periudhat e qytetërimeve të mëdha të hershme, flasim mijëra vjet para epokës sonë në civilizimet e lashta si Egjipti, Mesopotamia, sumerët e lashtë, babilonasit etj, edhe ata kanë pasur zhvillimet e tyre historike nganjëherë hynore dhe mitike por shpeshherë me tendenca realiste historike.

Njerëzimi që nga origjina ka njohur hyjnitë, ndërsa disa popuj më të integruar dhe realistë kanë njohur monoteizmin kur ju janë bindur shkrimeve të lashta hyjnore, vlen të përmendet Upanishada e vitit 1400 p.e.s.. Sa i takon antikitetit kemi përpjekjet e grekëve dhe romakëve të cilët e akumuluan diturinë dhe kulturën nga Lindja si fjala vjen etruskët të cilët erdhën nga Lindja si shkak i zisë së bukës dhe thatësisë, por ndërtuan Romën. Këtë e gjejmë tek autori Karl Grimberg, apo fenikasit të cilët i mësuan shkrimin grekëve. Burimet e autorëve antikë si Herodoti, ndryshe babai i historisë apo Hesiodi i cili i jep ngjyra religjioze historisë, kurse Tukididi fillon përmes narracionit (rrëfimit) të luftimeve të Peleponesit t’i largojë pak mitet dhe të bëhet më realist për fenomenet historike të kohës. Mesjeta është një grumbull historie e kamufluar me monarki, perandori si dhe përplasje qytetërimesh dhe ngritje të ideve religjioze.

Krishterimi me Jezusin a.s. apo Islami me Muhamedin a.s., epoka e artë andaluziane (Spanja Islame) e cila nuk ka gjetur vend të duhur në kapitujt e historisë për meritat e saj, që dha shumë për Renesansën evropiane. Shumë rryma, pikëpamje, koncepte dhe ide u shfaqën në mesjetë (që nga themelimi i Bizantit (324), rënia e Romës (476) nga rënia e Bizantit (1453) deri tek themelimi i Perandoris Osmane (1299) mbi rrënojat e Konstandinopojës 1453 dhe marrja e saj nga Sulltan Mehmet Fatihu II). Lufta e Papatit, koncilet ekumenike dhe monarkitë që lidheshin me Papatin, ndarja e dy kishave me 1054, lindja e ortodoksisë si ndarje nga polarizimet krishtere, apo Inkuizicioni i krishterë fatalist i cili i shpalli luftë shkencës me obskurantizmin e saj duke djegur në turrën e drunjëve shkencëtarin Galileo Galileun, ky gabim filloi të zgjerohet derisa kisha filloi të abuzonte me pasuritë e popullit dhe skamja shihej kudo jashtë oborreve të Kishës. Kjo gjë sjelli Reformacionin nga Martin Luteri 1516 edhe pse më herët kemi Lëvizjen e Jan Husit në Çeki (1420-1431).

Libër i njohur rreth studimeve të fenomeneve në histori është ai i autorit Edward Hallett Carr: “Çfarë është Historia?”, studim i vitit 1960 e në vazhdimësi, libër i njohur nga ky historiografë. Ai diskuton rreth historisë, fakteve, paragjyqimeve të historianëve, shkencës, moralit të individëve dhe shoqërisë, si dhe gjykimet morale në histori. Analizat historike dhe opcionet e studimit të saj tregojnë për të kaluarën e cila shprehë nuanca kuptimore dhe sinjifikative për të tashmen dhe i paraprinë të ardhmes, p.sh.: historia jonë shqiptare njihet armiq të tanë tradicionalë të cilët na shkelën, na vranë dhe masakruan, historia përsëritet, ata sot mundohen me armë të ftohta duke përdorur vegla perëndimore, të na bëjnë operacion edhe me imtësira që shpesh dijnë të bëhen si kancer i ngadalshëm dhe shkatërrues i vlerave njerëzore-shoqërore.

Sot ne jetojmë me ngjarjen, por ngjarjet lënë gjurmë tek ne dhe memorien tone, andaj lapsi shënon dhe jeton me aktualitetin e një intelektualit dhe shkencëtari mendjempreht që ka dëshirë t’u tregojë popujve se edhe ne kemi historinë apo ndodhitë tona që duhet t’ua tregojmë të tjerëve ndryshe ato do të na zënë frymën dhe do të vdesim me to pa u çliruar, dhe me ndërgjegje dhe shpirt të ngarkuar. Dhe në fund historia e popujve të lirë ka treguar se ata kanë ditur të jenë vetvetja, andaj ne duhet të çlirohemi nga frika dhe të jetojmë me realitetin, të tregojmë historinë reale, aktuale pa deformime politike apo ideologjike, lokale, nacionaliste, dogmatike, etj.

Prishtinë,

2011

16. Teoria e Perandorive

Nismëtari i parë që diskutoi për shtetin ishte filozofi i hershëm grek Platoni në veprat e tij “Politia” dhe “Nomi” (Shteti dhe ligjet) apo siç flet ai vetë mbi idetë dhe vendosmërinë e tij ku dhe në dyert e Akademisë së vet shkroi këto fjalë: “*Le të mos hyjë askush që nuk di gjeometrinë*”, sikur i paraprinë asaj se gjërat pa u matur mirë nuk duhen ndërmarrë.

Sot shtetet e integruara me procese të implementimit bashkëkohor i masin gjërat gjeometrikisht ndryshe, prognoza e tyre do të ketë pasoja ekonomike siç kishte f.v.: kriza e Opekut - e naftës me 1973 ku u tregoi vendeve të zhvilluara se sa i rëndësishëm është ky burim i energjisë për ekonominë botërore. Ngritja e befasishme dhe e shpejtë e çmimeve të naftës shkaktoi rrëmujë dhe recesion global dhe kriza të ngjashme u përjetuan në vitet që pasuan këtë ngjarje në tërë botën ashtu dhe në ShBA.

Ernest Renan – studiues i njohur i kombeve dhe nacionaliteteve thotë: “*Qëllimi i botës është të mbretërojë arsyeja, mirepo kur aferat korruptive shfaqen në instancat shtetërore vetvetiu shteti do të degradojë dhe nuk do jetë i aftë të bashkojë as tregjet dhe bashkëpunimin mes popujve tjerë*”. Bashkimi European i cili është një bashkim i disa shteteve evropiane i themeluar me qëllim të lirisë së qarkullimit të mallrave, ku edhe Shqipëria tashmë e anëtarësuar por me shumë punë para vetes për rregullim dhe strukturim. Kurse sa i takon Kosovës ajo duhet të punojë shumë që të kapë këtë projekt integrues edhe pse rrota e kohës së pushtesit serb e mbajti peng Kosovën, dukuritë diplomatike, liberaliteti me vendet e Evropës si dhe bashkëpunimi i madh me ShBA-në, të cilat e shpëtuan nga gremina dhe spastrimi etnik duke e shpëtuar nga planet e fundit katastrofike të “*Sllobo-s*” me shokët e tij çetnikë që historikisht u bënë gjëmën shqiptarëve.

Perandoritë ranë me lufrat ballkanike 1912-1913 por idetë nuk bien kurrë e as startegjitë politike apo gjeo-politike. Ish-perandoritë e mëdha u shkrinë por vendet që kishin prirë denjësisht u paraprijnë këtyre segmenteve kohore. Në vazhdim sjellim tre fakte dhe një analizë: Bashkimi Evropian në kuadër të të cilit shtrihen vendet evropiane duke bashkuar tregun, ekonominë, liberalizimin e vizave apo lëvizjen e lirë është një indikator se një supergjigand imperator është formuar dhe ka para vetes disa interesa por dhe ide për arritje të qëllimeve dhe synimeve evropiane dhe atyre që i prijnë këtij flamuri dhe kësaj makinerie promovuese të ideve dhe objektivave që ajo synon.

Turqia edhe pse e anëtarësuar në Nato, me teorinë e saj që e shfaqti nga vetë diplomati dhe ministri i jashtëm turk Ahmet Davutoğlu i cili e paraqet qartë sistemin *osman* dhe teorinë e shtrirjes dhe bashkëpunimit me popujt tjerë, këtë e vërejmë edhe tek ekonomia, pothuajse e paprekur nga recesioni global, u rrit me 11.7 % në tremujorin e

parë të këtij viti dhe 10.3 % në të dytin. Si një Perandori Osmane e rilindur, Turqia ka mbështetur krijimin e një zone pa viza me Sirinë, Jordaninë dhe Libanin, dhe po shkon drejt krijimit të një zone të tregtisë së lirë. Dhe Turqia është një forcë jo vetëm në fqinjësinë e vet por edhe në botë.

Ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë republikë federative kushtetuese e përbërë prej 50 shtetesh dhe një qarku federal. Vendi shtrihet kryesisht në Amerikën e Veriut, ku 48 shtete të ngjitura dhe Uashington D.C. - qarku i kryeqytetit, ndodhen midis oqeanëve. Kjo e fundit ka bërë hapa të fuqishëm me kohën duke u integruar dhe hyrë në çdo shtëpi në botën ku frymon njeriu në planetin tokë, bile edhe në Rusinë e cila i bën rivalitet të lartë dita-ditës dhe është në garë me këtë imperator të kohës siç është ShBA.

Nuk mund të lë pa përmendur vendet e largëta të Azisë si: Kina, Japonia, etj. por këto do t'i kemi mjet diskutimi në një sintezë tjetër të rradhës. Analiza është se kjo bota dhe njerëzit e duan më të fortin apo atë i cili u jep qetësinë shpirtërore dhe mirëqënien sociale si dhe linjat e humanizmit. A thua vallë cila nga perandoritë e mësipërme është më adekuate për botën? Përgjigjen ua lëmë globalistëve dhe shkenctarëve teoricientë dhe gjithsesi një rezultat i përpashkët do na dale, sepse ne kemi nevojë për dikënd dhe dikush ka nevojë për ne.

**Prishtinë,
05.10.2010**

17. Piramida shqiptare

Që nga gjeneza e njerëzimit bota graviton në planin hapësirë dhe kohë, ashtu dhe shoqëria shqiptare funksionon si piramida. Ta marrim shembull piramidën: duket diçka serioze për një biolog kur ka parasysh atë të renditjes dhe klasifikimit të kafshëve apo për një historian që i kujton piramidat egjiptiane. Hosni Mubaraku i mori plaçkat u largua ashtu siç vdiq Enver Hoxha bashkë me sistemin e tij totalitarist, antifetarist, monist.

Në idenë e një ekonomisti piramida nga Bruto në Neto apo sistemi piramidal në Shqipëri më 1997 që ishin si të prekurit nga djalli apo diskutimi i ditëve të sotme për rrëzimin e piramidës në Tiranë, piramidë e cila e ruan hijen dhe krenarinë e medaljonit komunist. Apo kohët e fundit ku Tirana digjej nga turma huliganësh që digjnin makina e thyenin dyqane, kurse disa qëndronin si spektatorë përmbi piramidë. Bunkerë me beton e hekur Shqipëria enveriane, që la ende mbeturina marksiste hegjemoniste, të cilat vërehen në tunele pafund e depo si “Gërdeci” që ishte tragjedi pas shpërthimit.

Piramida nuk di si do të na dalë por po shoh se me të vërtetë edhe populli shqiptar ka hyrë në një labirint aq të rrezikshëm që ka shumë dyer dhe kode si piramidat që po u dëshifruan do të shpëtojmë nga ndonjë kaos i mundshëm politik. Disa janë faraonë që

synojnë karrigën, kurse disa të tjerë shtangen si mumje duke vuajtur pasojën e mëkatit e disa të tjerë flejnë gjumë në sarkofagë të mëdhenjë prej graniti dhe mermeri jo si ai i Prishtinës me radioaktivitet, por në brendi të tyre ka përplot stolira. Dhe si përfundim populli i mjerë është skllav apo rob i punës së palodhur për të ndërtuar piramidën dhe kështu shoqëria jonë ndërtohet dhe në fund Viktor Hygo thoshte: *“Të këqinjët e kanë një lumturi të zezë”*.

**Prishtinë,
16.02.2011**

18. Halifati Islamo-kontemporan dhe idetë e zhardhokut të patates

Fjala “*Halifat*” vjen nga Kur'ani që ka kuptimin e “zëvendësit apo mëkëmbësit të Allahut në tokë: “(Përkujto Muhammed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!" Ata thanë: "A do të vëshë në të atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdëriminTënd dhe plotësisht të adhurojmë!" Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini!“¹⁵

Kurse Halifati apo udhëheqja e sistemit qeverisës islam u ngrit nga i dërguari Muhamed a.s., ky organizim shtetëror kishte jetë në të gjallë të hz. Muhamedit a.s. në vitet 622-632. Nuk dua të ndalem në linja historike por më shumë në ato ideore. Islami si fe e paqes dhe lumturisë e ardhmërisë dhe jo e bestytnisë, tiranisë dhe diktatorisë, kaloi trende interesante në kohë e hapësirë. Halifati njeh këtë sistem udhëheqësie në kohëra:

1. Halifati nën udhëheqjen e hz. Muhamedit a.s.,
2. Halifati i katër halifëve të drejtë: Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit dhe Aliut,
3. Emevitët,
4. Abasitët,
5. Selxhukët,
6. Osmanlinjtë, etj.

Halifati kontemporan kërkohet që nga rënia e tij, mirëpo më lartë duhet theksuar se: sistemi mbretëror monarkist i sjellur si novacion nga Muaviu, e humbi imazhin e vërtetë të Halifatit.

Sot njerëzimi vuan për një prijes të drejtë që t'i thotë stop: korrupsionit, padrejtësisë, hajdutërisë dhe ideve të gabuara diktatoriale. Pse zhardhoku i patates këtu? Darvini thoshte se njeriu ka origjinën nga majmuni sepse ka kromozomet e afërta, kurse në realitet zhardhoku i patates i ka më të afërta dhe ne jemi vëllezër dhe motra nga patatja sipas kësaj teorie të dështuar dhe të gabuar. Muslimani kontemporan është ai musliman që mendon për kojshiun e tij, për të pastrehin, për të varfërin, për studentët në rrugën e dijes.

Kurse sot ndodh e kundërta, halifët mendojnë për kravatat e tyre të bukura dhe kostumet që i ndërrojnë çdo ditë, për barkun si ta rrisin më shumë, për makinën e tyre se a ka harmoni në ecje, e jo për barazi, liri, gjykim, drejtësi, etj. Pra, pse ky zhadhok i prishur po gjëmon dhe mbanë peng muslimanët? Logjikë e thjeshtë. Mbretëria dhe diktatura ka fajin poashtu dhe “demokracia” që vetëm emrin e ka si të tillë. Presidentë, monarkë dhe myftilerë ku jeni me fjalën e sahabiut Umer ibn Hatab r.a.: “*Drejtësia është themeli i një shteti*”. Padrejtësi islame, nuk ka themele familja , shoqëria, as shteti e as bashkësia qoftë islame apo lokale, publike apo private.

Dikush sot jeton me disa vende të punës sepse ka autoritet, kurse dikush me asnjë edhe pse ka kualifikim, sepse nuk ka autoritet dhe fund i historisë jemi ne, në kolapsin e nepotizmit, familjarizmit dhe klanizmit ogurzi.

¹⁵ Kur'an-i: Surja: Bekare, ajeti: 30.

Mjerisht halifati nuk po funksionon, funksioni do vjen një ditë me lejen e Allahut i cili është shumë afër, më pas do t'i sheshojë gjërat mes palëve të vendosi drejtësinë. Dihet se vendosja e drejtësisë në jetën e njerëzve është një nga qëllimet madhore të Islamit. Në bazë të kësaj drejtësie janë krijuar qielli dhe toka, u dërguan peygamberët dhe u zbritën librat: **"Kemi dërguar bashkë me të dërguarit edhe sqarimet, i kemi zbritur atyre librat dhe peshoren që të vendosin drejtësinë".**¹⁶

Dhe këtë e funksionalizon halifati i vërtetë islam dhe jo ai i zhardhokut të patates, andaj të marrim mësim sepse jeta e muslimanit është e shenjtë ashtu siç është gjaku i tij që sot në botën arabe po derdhet si ai i mizave nga diktatura e mbjellur. Allahu na faltë!

**Prishtinë,
gusht 2011**

¹⁶ Kur'an-i: Surja: Hadid, ajeti: 25.

19. Islami dhe ideja e diplomacisë së sotme

Sot në shek. XXI, diplomacia është një mjet i cili shërben ose për të mirën e njerëzimit ose për ngatërrimin e tij në ndonjë rrugë pa drejtim. Allahu xh.sh. e krijoi njeriun dhe e pajisi atë me mendje të logjikoje dhe veprime të drejta. Allahu xh.sh. thotë: **“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur. . Pastaj e zbritëm atë në më të ultin e të ultëve”**.¹⁷

Njeriu është krijesë e Zotit xh.sh., gabimtare, por ai duhet të mundohet t'i minimizojë gabimet, në mënyrë që ta kaplojë mëshira e Allahut dhe të fitojë premtimin e dhënë besimtarëve nga ana e Krijuesit Fuqiplotë, vetë Xhenetin.

Ibën Abasi r.a. ka thënë se: *“Pejgamberi a.s. kur e dërgoi Muadh bin Xhebelin r.a. në Jemen i tha: “Ti do të shkosh në një popull nga ithtarët e Librit, le të jetë e para gjë në të cilën do t’i ftosh ata, Adhurimi i Allahut...”*. Pra kjo ishte një diplomaci e kulluar apo metodë taktike që Hz. Muhamed a.s. e përdorte për ambasadorët kur ata i dërgonte si rasti i Muadhit të cilin e informoi për situatën në vend dhe e mësoi se si të vepronte.

Islami njohi diplomatë të mëdhenj nga krijimi i njerëzimit e deri në ditët e sotme. Dua të përmend disa diplomatë apo emra të tyre të cilët bënë epokë, disa njihen botërisht e disa janë fshehur nga inati se ishin besimtarë të vyer. Duhet përmendur Hz. Hidrin a.s., njeriu të cilit Allahu xh.sh. i kishte dhënë një dije speciale të veçantë i cili në udhëtim me Hz. Musain a.s. i dha disa leksione që vërtetë kishin kuptim të madh, të cilat i gjëni në Kur'an në suren el-Kehf. Kemi edhe Hz. Dhul-karnejn a.s. që bëri pengesën mes je'xhuxhëve dhe me'xhuxhëve ku me diplomaci dhe mjeshtëri kërkoi nga populli ndihmesë vullnetare.

Ibrahimi a.s. i njohur si mik i dashur i Zotit dhe pejgamber me besim të pastër monoteist, i cili theu idhujt e mëdhenj të kohës që ishin statuja dhe la vetëm më të madhin dhe i tha popullit të tij: “Pyetni atë më të madhin se kush i theu ata që kishte rrotull? Por ai (idhulli) nuk përgjigjej sepse vdekësia e mendjeve të pazhvilluara nuk mund ta kuptonte zhdërvjelltësinë dhe mençurinë e pejgamberit Ibrahim a.s.. Hz. Muhamed a.s., vula e pejgamberëve, i cili i ftoi tri perandoritë e kohës me letra të shpallura: *“Ejani në Islam”*, i cili komplet Gadishullin Arabik e nxjerri nga paganizmi dhe ideologjitë tradicionale politeiste.

Sot nga taktika e tij të cilat ia kishte dhënë Zoti Fuqiplotë, Islami është feja më e përhapur në botë, ndërsa figura e Hz. Muhamed a.s. më njohura globalisht. Kemi edhe Ibn Batutën - njeriu gjenial dhe diplomat, udhëpërshkrues dhe historian, i cili njihej për diplomaci botërore. Tregtarët arab ishin diplomatë të mëdhenjë, ata bënë tregti por krahas tregtisë përhapnin Islamin dhe idenë e paqes islamo-globale. Andaluzianët dhe Osmanët kur ecën në konturet e bazave islame, ata zhvilluan veten dhe ditën të bëjnë diplomaci me të tjerët duke u shtrirë në një gamë të gjërë veprimi kontinentale dhe ndërkontinentale.

¹⁷ Kur'an-i: Surja: Tin, ajeti: 4-5.

Sot Islami ka hyrë në çdo shtëpi, edhe pse ngjarjet në botën arabe po trondisin çdo njeri. Raportet flasin se në Perëndim mijëra njerëz pëlqejnë diplomacinë reale islame dhe pranojnë Islamin me dëshirë. Bota po ballafaqohet me probleme të ndryshme si: korrupsioni, krimi, vetëvrasja, narkomania, prostitucioni, çrregullimi i ekosistemit si dhe gjeosistemit. Diplomacia islame dhe paqësore është zgjidhja si ilaç i sëmundjeve të ndryshme, që vijnë nga mediopatia apo telopatia, sociopatia, disekuilibri, dis-harmonia, çrregullimi në ushqim si p.sh.: hyrja e derrit dhe alkoolit thuajse në çdo produkt ushqimor, apo veshja e shthurur rinore patalogjike, epshërore, etj.

Sëmundjet e ndryshme në sistemin e sotëm jetësor mund të shërohen vetëm me diplomacinë islame. Diplomacia politike është kur politika bëhet drejtë edhe pse në politikën e politikanëve të sotëm mund të quhet utopi si tek vepra e Thomas Morit “*Utopia*”. Por diplomacia islame di dhe t’i shmanget pushtetit laik dhe të jetojë më vete si një ishull i artë, siç “As’habul-Kehfi” u larguan nga pushteti tirano-romak duke ruajtur besimin e pastërt në një Zot, apo siç Hz. Muhamed a.s. u largua nga Meka në Medine por me diplomaci duke rritur numrin e besimtarëve falë ndihmës së Zotit xh.sh. çliroi Meken dhe hyri triumfalisht e paqësisht me fitore pa derdhur gjak njeriu.

Sot diplomacia ka krijuar grupe, organizata, institucione publike, private dhe sekrete. Çdo diplomaci e cila ka për objektiv mirëqenien e racës njerëzore pa dallim gjuhe, ngjyre apo nacionaliteti është diplomaci e mirëfilltë dhe pozitive, dhe është diplomaci reale islame. Sot diplomacinë e luajnë fuqitë e mëdha, fuqi të mëdha që kanë arsenal të madh ushtarak, militant, kan pasuri si: ari, naftë, gaz, pastaj pasuri të tjera me rradhë. Sa i takon diplomacisë së ftohtë është diplomacia e kokave apo elitave të cilët janë rritur e shkolluar në shkollat më prestigjioze të kohës, si në: Harvard, Oksford, Sorbonë, Bolonjë etj.

Universitete e para prestigjioze botërore dikur muslimanët i themeluan si: el-Ez’heri, Kordova, ku aty u gatuan diplomatët e mëdhenjë të kohës. Por dhe sot muslimanët po ripërtrihen edhe në aspektin diplomatiko-shkencor kudo nga: Pakistani, Indonezia, Turqia, Azia, Afrika, Evropa, Ballkani, si dhe nga Amerika. Kisha rastin të lexoj librin e një muslimani amerikan i cili ishte dijetar dhe diplomat botëror, i cili kishte mbajtur 28 tribuna islamo-shkencore brenda një muaji në 28 shtete të ndryshme të botës. Diplomacia sot është një vegël e cila luan rol shumë të madh për shoqëritë, shtetet, qytetet, lagjet, etj. Diplomacia islame ka hyrë dhe ka goditur edhe manipuluesit e Islamit të cilët me dez-informatat e tyre kanë hedhur në treg nocionin *Islamofobi* apo *Frika nga Islami* me mashtrimet dhe skemat e tyre diplomatike.

**Prishtinë,
tetor 2011**

20. Islami dhe racizmi

Ideja e Islamit është cituar dhe zbërthyer si nocion apo rrymë si në aspektin teorik ashtu dhe në atë praktik, kuptimi i të cilit është paqe, solidaritet dhe nënshtrim ndaj ligjeve të Zotit. Ligjet e Zotit janë të skalitura në Kur'an me drejtësi, barazi, dashuri dhe me vlera të larta morale. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: **“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz”**.¹⁸

Pra ky ajet kur'anor jep sinjalin kuptimplotë se Islami nuk është fe e një ngjyre të caktuar por është fe e të gjitha ngjyrave dhe gjithë njerëzve. Ideja e racës njerëzore, që mund të ndahet nga antropologët si raca e bardhë dhe ajo e zezë në mënyrë gjenerale. Nëndegët e këtyre racave sjellin kozmopolitanizmin, përzierjen gjenetike, si fjala vjen të kuqen ose të mesmen, as bardh as zi. Allahu xh.sh. i krijoi të gjithë njerëzit me barazi dhe pa veçuar një racë nga tjetra por njerëzit seleksionohen nga devotshmëria me Krijuesin e tyre.

Allahu xh.sh. thotë: **“O ju njerëz! Vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre (Ademit dhe Havës), ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni ndërmjet vete, e nuk ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që është më i devotshëm (më i njerëzishëm), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”**.¹⁹

Sahabiu i njohur Bilali r.a. ishte *muezini* i parë që me dashuri ju tha të thërriste ezanin, ku pejgamberi a.s. shpesh i thoshte: *“O Bilal, na kënaq zemrat tona me ezan”*. Sikur Islami të kishte racizëm do ta përulte sepse ai ishte i zi, por pejgamberi a.s. në *Hutben* e Lamtumurës u shpreh qartë: *“O besimdrejtë! Ta dini dhe të mos harroni se të gjithë muslimanët janë vëllezër. Ju të gjithë jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe detyra. Nuk ka kurrfarë përparësie arabi ndaj jo-arabit, e as jo-arabi ndaj arabit, as i ziu ndaj të kuqit, e as i kuqi ndaj të ziut përveç me devotshmëri. Të gjithë jeni pasardhësit e Ademit, ndërsa Ademi është prej dheut”*.

Ne e dimë mjaft mirë historinë e luftërave racore antizezake në Amerikë që nga koha e presidentit Abraham Linkoln e deri tek koha e Martin Luter Kingut ku fushata e Birminghamit ishte një betejë që arriti kulmin e lëvizjes për të drejtat civile. Për shumë analistë, kjo qëndron si një simbol i sakrificave të bëra nga organizatori Luter King dhe mijëra zezakë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Teoria racore, inferiore, e sjellur nga Darwinizmi dhe më thellë paganizmi, ka dëmtuar shumë shoqëritë deri në kohët e sotme. Diskriminimi racor sjelli përbuzjen e racave dhe etnive të tjera duke sjellur ksenofobinë, ekstremizmin, separatizmin, krimin, terrorizmin, etj.

¹⁸ Kur'an-i: Surja: Rum, ajeti: 22.

¹⁹ Kur'an-i: Surja: Huxhurat, ajeti: 13.

Islami nuk është fe e racizmit. Ne e dijmë mjaft mirë se muslimanët e Afrikës së Veriut jetuan si muslimanë me tolerancë duke e ngritur Andaluzinë, Islamin dhe shkencën zhvillimore në Spanjë. Inferioriteti racor dhe ideja e sundimit të klasave të forta ndaj atyre të dobëta sjelli luftërat më shkatërrimtare që ka përjetuar njerëzimi ndonjëherë, si luftërat botërore, që sjellën miliona viktima të pafajshme. Racizmi nuk ka të bëjë asgjë me Islamin poashtu dhe e anasjelltas, andaj Islami çdoherë dhe në çdo kohë e ka luftuar racizmin duke mbjellur në zemrat e njerëzve drejtësinë, barazinë, sepse të gjithë jemi bijtë e një babai e ai baba është Ademi a.s., ku Allahu xh.sh. nga shpina e tij nxjerri shpirtërat tonë dhe nga ai lindi raca njerëzore me lejen e Tij.

Sot shumë somalezë dhe afrikanë janë lënë në mëshirë të kohezionit dhe janë shtypur e kolonizuar me inferioritet, ata nuk kanë as bukën e gojës për të ngrënë kurse toka e tyre përmbajnë diamante dhe xhevahirë të çmuar me të cilat zbukurohen kazinot e Las Vegasit, Britanisë së Madhe etj. Në fund për t'i vënë kapakun kësaj teme, transmetohet se Irbad Ibën Sarije të ketë thënë: *"Një ditë u ngrit i Dërguari a.s. dhe na këshilloi me një këshillë mbresëlënëse, prej së cilës zemrat u drodhën dhe sytë u përplotën. (Dikush i tha) "O i Dërguari i Allahut! Na këshillove sikur të ishte këshilla jote e fundit. A na le pas ndonjë testament?" (I Dërguari) Tha: "Ju këshilloj me frikërespekt (devotshmëri) ndaj Allahut, dëgjoni dhe respektoni (udhëheqësin), edhe nëse është rob nga Abisinia (Etiopia). Pas meje do të shihni divergjenca dhe kundërshtime të forta, por ju pasojeni Sunnetin tim dhe të udhëheqësve të drejtë e të udhëzuar, kapuni për të me dhëmballë dhe kini kujdes nga gjërat e shpikura sepse çdo risi është humbje."*

Prishtinë,

Tetor 2011

21. Islami dhe nacionalizmi

Nacionalizmi e ndau botën në kanale duke i bërë njerëzit të kenë ego të lartë për vendin e tyre dhe duke mos pasur dinjitet dhe partneritet solid me vendet e tjera. Nacionalizmi është një rrymë që ngre lartë vlerat e një komuniteti apo etnie, ku logjikisht fyen nacionalitetin apo origjinën e palës tjetër që jeton në atë komunitet. Herbert Luthy thotë: "Nacionalizmi është një besim që mbështetet në një grusht dogmash, të cilat nuk mund të shpjegohen nga pikëpamja shkencore dhe intelektuale, ndërsa autenticitetin e vet e mbështet në mendjen e ithtarëve të tij".

Nocioni nacionalizëm i cili nënkupton shprehjen komb, rrjedh nga fjala latine *"natio"* dhe *"nitus"* që kanë kuptimin e vendlindjes. Shkencëtarët që merren me këtë çështje dhe që studiojnë politikën e nacionalizmit, e kanë përkufizuar në mënyra të ndryshme. Sipas këtij përcaktimi, organizimi i përbashkët politik dhe uniteti kulturor janë faktorët kryesorë për formimin e kombit. Në periudhen e artë islame në të gjallë të hz. Muhamed a.s. u lidh gërsheta e besimit midis *muhaxhirëve* (emigruesve nga Mekka) dhe *ensarëve* (nikoqirëve nga Medina). Ata u bënë familje dhe vëllezër. Aty u lidh gërsheta

ndërmjet muslimanëve arabë dhe vëllezërve të tyre, Suhejb Er-Rumi (romak), Bilal El-Habeshiu (etiopian) dhe Selman El-Farisiu (persian), po ashtu u tret fanatizmi i fisit, racës dhe vendit.

I Dërguari a.s. u tha atyre: "*Braktiseni fanatizmin, se ai është kundërmues*". Po ashtu u tha: "*Nuk është prej nesh kush thërret në fanatizëm, nuk është prej nesh kush lufton për fanatizëm dhe nuk është prej nesh kush vdes për fanatizëm.*" Kështu përfundoi çështja e këtij kundërmimi, kundërmimit të fanatizmit të prejardhjes. Vdiq edhe çështja e mburrjes arrogante, mburrjes me racë. Po ashtu u mënjana njolla e kombit dhe njerëzit filluan të thithin aromën e pozitive të larta, larg nga kundërmimi i mishit dhe gjakut dhe zhytjeve të dheut e tokës. Që nga ajo ditë vatani i muslimanit nuk mbeti toka, por mbeti Shtëpia e Islamit. Në shtëpinë të cilës dominon besimi i tij dhe në të cilën gjykon vetëm Ligji i Zotit xh.sh..

Islami nuk veçon një etni nga tjetra por është fe globale, fe e të gjitha etnive apo kombeve. Nacionalizmi është një iluzion i formësuar nga ideja e kombit, e forcuar nga revolucion i borgjez francez me 1789 i cili ishte shkatërrues për perandoritë e kohës. Ekziston vetëm një e vërtetë, ajo nuk përpjesëtohet, çdo gjë pas saj është iluzion. Allahu i Lartmadhërishtëm thotë: "**Pas të vërtetës nuk ka tjetër pos iluzione, e si po ia ktheni shpinën (të vërtetës)?**".²⁰

Nacionalizmi e shkatërroi Perandorin Osmane e cila deri vonë ecte në konturet e pastërta islame duke futur egon e kombit dhe nacionalizmit në emër të reformave. Perandoria Osmane së bashku me shqiptarët po gëlltiste nacionalizmin e tejskajshëm i cili vinte si pasojë e lënies së dijes islame dhe pasimit të bestytnive nacionaliste me frymë të Marksit, Engelsit, Leninit si dhe Darvinit me teoritë e tij të dështuara. Andaj pasojat po afroreshin dita-ditës, derisa pjella masone i solli në vatër argatët e saj. Shqiptarët e ndanë këtë trazirë dhe boshllëk me aleatët e tyre të natyrshëm dhe vëllezërit e tyre në fe, osmanlinjtë, ku $\frac{3}{4}$ po ti pyesje: "*çfarë jeni ju?*", do të përgjigjeshin: "*jemi myslimanë, elhamdulillah!*" (shyqyr Zotit) - sipas Eqrem Bej Vlorës në librin e studiueses Nathalie Clayer.

Nacionalizmi futi përçarje në mesin e popullit arab dhe berber, i ndau në grupe muslimanët në Spanjë, ku disa fryheshin se ishin spanjollë, gjak i pastër mbretëror, disa se ishin berberë dhe kanë çliruar vendin, disa se ishin arabë dhe feja islame ka ngritur shkencën, kështu muslimanët harruan ajetin e Kur'ani: "**Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e Allahut, e mos u përçani! Përkujtone nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntitë e Tij aguat të jeni vëllezër**".²¹

Nacionalizmi solli pranverën arabe ku: Tunizia dhe Egjipti pati mijëra të vdekur, si dhe rasti Libisë dhe eksodi i madh ku mijëra musliman u mbytën pa ndalë, dhe si përfundim u vritet diktatori Gadafi nga grupi rrebel që feston me çokollatat amerikane

²⁰ Kur'an-i: Surja: Junus, ajeti: 32.

²¹ Kur'an-i: Surja: Ali Imran, ajeti: 103.

Kit-Kat. Po si do vjen fati i këtyre muslimanëve që kërkojnë demokraci, kësaj pune i vëjmë një pikëpyetje të madhe? Nacionalizmi sjelli luftëra, gjaqe, eksode, ku edhe sot serbët radikalë ballafaqohen ta mbajnë peng gjysmën e Mitrovicës. Pansllavizmi i egër sllav forcoi nacionalizmin që ishte i lidhur me kishën ortodokse nga konjunkturat mitike, masone, sllave, ku në emër të kombit u rrënuan me gjenerata të tëra.

Prishtinë,

22.10.2011

22. Islami dhe ekonomia

Të shkruash për këtë temë do duheshin libra me vëllime për tu bërë. Ekonomia në ditët e sotme është bërë komanduese e njeriut dhe jo e kundërta, sepse kur ne nuk i kthehemi ligjeve të Allahut xh.sh., për ekonominë atëherë *taguti* do na i verbojë sytë pas kësaj bote ku do të humbasim edhe botën tjetër. Ekonomia në optikën islame ka dy trungje të mëdha:

1. Ekonomia e lejuar në bazë të rregullave dhe normave të Kur'anit dhe Sunetit, dhe
2. Ekonomia e ndaluar, e cila sot po pushton botën me korrupsion, kamatë dhe shitblerje të haramit.

Gjithmonë besimtari e shikon jetën në këndin islam dhe e analizon me dy sy, me syrin e jashtëm dhe të brendshëm dhe jo vetëm me një sy sepse ai do të sjellte pasoja të rënda për individin. Tani do të ju referohemi disa ajeteve kur'anore për ekonominë:

“E kur Ne u japim njerëzve begati të mira, ata u gëzohen atyre, e nëse ata i godet ndonjë e keqe për shkak të veprimit të tyre, atëherë ata e humbin shpresën.

Vallë, po a nuk shohin ata se Allahu i jep furnizim të mjaftueshëm atij që do Ai dhe ia pakëson. Në këtë, ka argument për një popull që beson,

Andaj, jepja të afërmit atë që i takon, e edhe të varfërit edhe udhëtarit, e kjo është shumë më e dobishme për ata që veprojnë për hir të Allahut dhe të tillët janë ata të shpëtuarit.

Dhe çka të jepni nga pasuria për ta shtuar e rritur (me kamatë), në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet tek Allahu, e çka të jepni nga sadakaja (bamirësia) me qëllim që t'i afroheni Allahut, të tillët janë ata që u shumëfishohet (shpërblimi).

Allahu është Ai që ju krijoi, që ju furnizoi, që ju bën të vdisni e pastaj ju ngjall. A ka ndonjë prej zotave tuaj që mund të bëjë diçka nga këto? I pastër është Ai, i pa të meta, i madhëruar është Ai nga çka ata ia mveshin dhe trillojnë.

Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat)“²²

Sot ekonomia kinse moderne është e bazuar në interes, andaj *tagutët* e kanë bërë të pamundur imagjinimin e një ekonomie apo aktiviteti ekonomik, pa pasur interes indirekt apo direkt qoftë ai interes. Në fillimet e Islamit, në kohën e gjeneratave të arta kur ekonomia bazohej në ligjet e Krijuesit të gjithësisë atëherë suksesi nuk dinte kolaps dhe shtet islame dhe të gjitha shtresat ishin në rahat dhe siguri ekuilibruese, ekonomike sepse institucioni i zekatit e mundësonte këtë.

Sot ari dhe gjërat e shtrenjta janë zëvendësuar me ato të pashtrenjta, me letra të pavlera, këtë gjë e bënë sionistët, bankierët çifutë e të pafe, ku ata sollën kamatën si shkatërrim për njerëzimin dhe ngritje për vetveten dhe Rendin e Ri Botëror që ata duan të formojnë.

²² Kur'an-i: Surja Rum, ajetet: 36-41.

Familjet si Rotshild, Rokfeler dhe avangardat e bankierëve që në fillimet e historisë së njerëzimit stabilizuan familjet e tyre me pasuri duke shitur bursa falso dhe duke futur letrën e pavarë dhe kamatën e cila është harami dhe tradhëti më e madhe që i është bërë njerëzimit ndonjëher. Allahu xh.sh. në lidhje me këtë ka paralajmëruar rrezikun vdekjeprurës për shoqërinë njerëzore në rast se ajo konsumohet: **"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe largojuni asaj që ka ngelur prej ribasë (kamatës) nëse jeni besimtarë! Nëse nuk e bëni këtë, atëherë përgatituni për luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij, e nëse pendoheni, atëherë merrni vetëm origjinën e të hollave tuaja! Kështu ju nuk i bëni padrejtësi askujt dhe nuk iu bëhet padrejtësi".**²³

Uba'de bin Samit r.a. transmeton se hz. Muhamed a.s. ka thënë: *"Ari me ar, argjendi me argjend, gruri me grurë, elbi me elb, hurma arabe me hurmën arabe (temër) dhe kripa me kripë (shkëmbehen) në të njëjtën sasi, në të njëjtën peshë, dorë më dorë. Nëse ndryshojnë këto lloje, atëherë shisni si të doni me kusht që të jetë dorë më dorë".*

Nëse shitet një nga këto lloje me të njëjtin lloj, si p.sh. ar me ar, apo hurmë arabe me hurmë arabe, atëherë është e ndaluar shtesa e njëres anë dhe gjithashtu është i ndaluar edhe afati. Duhet patjetër që të jenë të njëjtë në peshë e masë pa marrë parasysh cilësinë, si dhe duhet patjetër që të kryhet shkëmbimi i mallit dorë më dorë në vendin dhe çastin e aktit. Ebu Seid el Hudrij r.a. transmeton se hz. Muhamed a.s. ka thënë: *"Mos e shisni arin me ar, vetëm nëse janë të barabartë dhe mos shtoni në njërën anë ...dhe mos i shisni ato një në dorë e një në mungesë!"*

Umer bin Hatabi r.a. transmeton se hz. Muhamed a.s. ka thënë: *"Ari me ar është kamatë, vetëm nëse shkëmbehet dorë më dorë, gruri me grurë është kamatë, vetëm nëse shkëmbehet dorë më dorë, elbi me elb është kamatë, vetëm nëse shkëmbehet dorë më dorë, hurma arabe me hurmën arabe është kamatë, vetëm nëse shkëmbehet dorë më dorë."*

Ibën Seidi r.a. thotë: *"Në kohën e të Dërguarit a.s. na vinin hurma arabe të përziera dhe shkëmbehim dy tasa me një. Kur e mori vesh i Dërguari a.s. këtë gjë tha: "Jo dy tasa hurme me një, as dy tasa grurë me një dhe as një dirhem me dy dirhem!"*

Nëse shitet një nga këto gjashtë lloje me lloj tjetër jo prej të njëjtit lloj si p.sh. të shkëmbesh ar me argjend, ose grurë me elb, atëherë lejohet dallimi në peshë apo masë me kusht që të bëhet shkëmbimi i mallit në vend, ashtu siç thuhet në hadithin e lartëpërmendur Uba'des.

Aishja r.a. transmeton se: *"I Dërguari a.s. bleu ushqim (grurë) prej një çifuti për t'ia paguar pas një afati të caktuar dhe i la peng mburojën e tij të luftës."*

Emir Sanani thotë në librin "Subulus Selam": *"Dije se dijetarët kanë rënë dakord në lejin e shkëmbimit të një lloji në të cilin rrjedh kamata me një lloj tjetër në të cilin rrjedh kamata, por të cilët nuk janë të të njëjtit lloj. Ky shkëmbim lejohet me afatizim apo me dallim në masë e peshë, siç është shkëmbimi i arit me grurë, argjendit me elb, etj."*

²³ Kur'an-i: Surja: Bekare, ajeti: 278-279.

Nuk u lejohet shkëmbimi i hurmave të njoma me të thata, përveç se të varfërve që nuk zotërojnë pemë hurme. Atyre u lejohet që të blejnë hurma të njoma (rutab) të marra prej pemës, me hurma të thata. Abdullah bin Umeri r.a. transmeton se: *"I Dërguari a.s. ka ndaluar nga shitja me kile e frutave që janë në pemën e hurmës me hurma të thata, si dhe nga shitja me kile e rrushit të njomë me rrush të thatë."*

Zejd bin Thabit r.a. transmeton se: *"I Dërguari a.s. ka lehtësuar për të varfërit që kanë hurma të thata, t'i shkëmbejnë ato me hurma të njoma, duke i përcaktuar me mendje ata që kanë përvojë."*

Shkaku që i Dërguari a.s. ka ndaluar nga shkëmbimi i hurmave të njoma me të thata është se të njomat nëse thahen, atëherë pakësohen. Seid bin ebi Vekkasi r.a. thotë: U pyet i Dërguari a.s. për shkëmbimin e hurmave të njoma me të thata dhe ai tha: *"A pakësohen të njomat nëse thahen? Thanë: "Po". Atëherë ndaloj nga kjo gjë."*

Mjerisht, pata rastin të jem musafir si imam i një xhemati që konsumonte me të madhe kamatën, çuditërisht atyre u ishte bërë shpërlarje truri, të falësh pesë kohët e namazit dhe të jesh i përkushtuar në Islam, por në të njëjtën kohë t'i shpallësh luftë Allahut me kamatë vërtetë është humbje e madhe, si rasti atyre njerëzve që do të vijnë me vepra të mira sa kodra e Uhudit dhe Allahu xh.sh. do t'ua shumëzoj me zero Ditën e Gjykimit.

Sigurisht që puna e ndershme është ekonomia e qëlluar, poashtu dhe shitblerja me rregulla dhe drejtësi. Në lidhje me ekonominë islame do të parashtrojmë disa hadithe që janë mësim për ne dhe mbarë umetin që kanë mendje të shëndoshë.

Transmeton Mikdami r.a. se i Dërguari a.s. ka thënë: *"Askush nuk ka ngrënë ushqim më të mirë se ai i duarve të tij. Edhe i Dërguari i Allahut, Daudi a.s. hante prej punës së duarve të tij."*

Xhabir bin Abdullah r.a. transmeton se i Dërguari a.s. ka thënë: *"O njerëz! Kini frikë Allahun dhe kërkojeni rrizkun në të lejuar (hallall), sepse nuk do të vdesë ndonjë trup pa plotësuar rrizkun e tij edhe nëse ai i vonohet. Kini frikë Allahun dhe kërkojeni rrizkun mirë! Merrni atë që është e lejuar (hallall) dhe lini atë që është e ndaluar (haram)."*

Hakim bin Hizam r.a. transmeton se i Dërguari a.s. ka thënë: *"Shitësi dhe blerësi janë të lirë në zgjedhje deri sa të ndahen. Nëse ata janë të singertë dhe të qartë (në tregtinë e tyre), atëherë tregtia e tyre ka begati; nëse i fshehin dhe mashtrojnë njëri-tjetrin, atëherë tregtia e tyre zhvishet nga begati."*

Ukbetu bin Amir r.a. thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin a.s. të thotë: *"Muslimani është vëlla i muslimanit. Nuk i lejohet muslimanit që t'i shesë vëllait të tij diçka që ka ndonjë të metë, vetëm nëse ia bën atë të qartë."*

Kuptohet se ekonomia islame nuk funksionon pa pasur këto pika:

1. Drejtsinë,

2. Zekatin,
3. Sadakanë,
4. Kontrata-Marrëveshja,
5. Bazuar në Kuran dhe Sunet,
6. Ecje në spjegimet e dijetarëve islam të njohur botërisht,
7. Bamirësinë dhe besimin,
8. Mirëkuptimin dhe vërtetimin.

Në fund e lusim Allahun Fuqiplotë të na mbrojë nga e keqja jonë dhe e keqja e Shejtanit qoftë ai prej njerëzve apo exhinëve, dhe të na bëjë prej bamirësve, të drejtëve dhe jo nga ata që konsumojnë kamatën. Shpresoj të kemi rikujtuar disa segmente të ekonomisë islame. Allahu e di më së miri, tek Ai kërkojmë furnizim, mbrojtje dhe strehë.

Prishtinë,
nëntor 2011

23. Islami dhe kriminologjia

Dihet se krimi e ka origjinën shumë herët, por krimi ndahet në disa shkallë. Krimi i parë që ndodhi në historinë islame është kur Kabili vret vëllanë e tij Habilin, vërtet një krim i madh familjar por edhe njerëzor, mësim për ata që kanë mend dhe dy sy, sytë e jashtëm dhe të brendshëm. Allahu thotë në lidhje me këtë: “: **“Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras”. Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë. Unë parapëlqej të marrësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd e kështu të bëhesh ndër banorët e zjarrit. Ky është ndëshkimi i keqbërësve”. Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau. Kështu, ai u bë nga të humburit. Allahu dërgoi një sorrë që rrëmihte në tokë, për t’i treguar sesi ta mbulonte kufomën e të vëllait. (Kabili) tha: “Mjeri unë, a nuk qenkam i zoti të bëhem si kjo sorrë e ta mbuloj trupin e tim vëllai?!” E u bë nga të penduarit”.**²⁴

Arritja e devotshmërisë është objektivi kryesor i çdo muslimani sepse devotshmëria e shkrinë inatin, xhelozinë, injorancën dhe hapë sytë e mendjes. Çdo vrasës në momentin e vrasjes ka gjaknxetësi e cila vjen nga Shejtani i mallkuar, armiku numër një i yni sepse dhe ne jemi bijtë e hz. Ademit a.s të cilit Shejtani i shpalli luftë pas krimit që bëri duke mos respektuar urdhërat e Krijuesit. Krimi e ka shkatërruar familjen, fisin, shoqërinë, ka shpjerë deri tek vëllavrasja dhe gjenocidi shkatërrimtar.

Termi Kriminologji rrjedhë nga: “*Crimen*” dhe “*logia*” që ka kuptimin “akuzë” dhe “shkencë” pra studimi shkencor i natyrës, shkallës, shkaqeve, kontrollit të sjelljes kriminale në të dyja anët qoftë individuale apo shoqërore. Allahu i Madhëruar në lidhje me vrasjen dhe krimin në Kur'an thotë: “...**kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t’i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t’i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit...**”²⁵

Përmes ajeteve të mësipërme marrim shumë mësim, leksione që na bëjnë mendjehapur dhe syçelë. Në lidhje me këtë Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Më mirë është të rrëzohet Qabja nëse munden sesa të vritet njeriu pa të drejtë*”. Kurse në një hadith tjetër thotë: “*Vrasësi dhe i vrari janë në zjarr*”. I thanë: *Për vrasësin është e qartë, po i vrari pse është në zjarr? Ndërsa përgjigja e Muhamedit a.s ishte: “Është në zjarr, ngase edhe ai kishte shumë dëshirë ta vriste shokun e tij”.*

²⁴ Kur'an-i: Surja: Maide, ajetet: 27-31.

²⁵ Kur'an-i: Surja: Maide, ajeti: 32.

Disa nga llojet e krimeve do i selekcionojmë me numra rendorë ku për çdo njërin do të bëhej temë në vete por vlen të citohet se krimi më i madh është të bërit shok Allahut, pastaj vijnë:

1. Vrasja e njeriut pa të drejtë,
2. Narkotikët (droga, alkooli, gjërat e tjera dehëse dhe shkatërruese),
3. Prostitucioni (zinaja, homoseksualizmi, lesbicizmi),
4. Veset e këqija (përgojimi, vjedhja, mashtrimi, tradhëtia),
5. Mendjemadhësia (dyfytirësia, lakmia, arroganca),
6. Marrja e pasurisë së jetimit padrejtësisht,
7. Mosdhënia e hakut punëtorit pa ju tharë djersa në trup.
8. Shpifja (korrupsioni, spiunazhi, zullumi).
9. Lëshimi i fesë,
10. Zilia etj.

Të gjitha këto dhe shumë të tjera bëjnë pjesë tek krimet, disa janë më të mëdha që ndëshkimi është më i rëndë, kurse disa më të vogla ndëshkimi më i lehtë. Kriminologjia si pjesë e sociologjisë është studim i krimit si fenomen shoqëror, përfshirë këtu shkaqet dhe pasojat e krimit, sjelljes kriminale si dhe zhvillimin dhe ndikimin e ligjeve. Hulumtimet në kriminologji përdorin metoda shkencore për të testuar hipotezat dhe rrjedhimisht për të zhvilluar teoritë që ndihmojnë për të sqaruar shkaqet dhe aspektet e tjera të krimit. Edhe pse që të dyja merren me krimin, kriminologjia ndryshon nga e drejta penale në atë që kjo e fundit fokusohet në komponentet e sistemit juridik përfshirë këtu policinë, gjyqet dhe sistemin korrektues.

Ato ndryshojnë edhe në aspektin funksional se e drejta penale veç përcaktimeve ligjore dhe funksionit shtetëror, është shumë më e përqëndruar për mundësitë që interpretohen dhe përcaktohen nga sociologjia dhe pamundësive ligjore, për trajtimin e problemeve ligjore që hasen në praktikë nga kjo shkencë. Pra mendimi im është se sociologjia dhe kriminologjia e studiuar në optikën islame janë një mjet rregullator për të drejtën penale kur ajo ka burim Islamit dhe gjegjësisht librin e shenjtë Kur'anin sepse përmirëson dhe zhvillon këtë të drejtë në bazë të zhvillimit të shoqërisë së shëndoshë. Në fund Allahu na bëftë prej atyre që kur e shohin ndonjë të keqe apo krim, ta largojmë me dorë nëse jo me gojë nëse as me këtë nuk mundemi ta urrejmë të paktën me zemër edhe pse është më e dobëta e besimit.

**Prishtinë,
24.10.2011**

24. Islami dhe demokracia

Fjala “*Demos*” dhe “*kracia*” që ndahet në dy fjalë “Popull” dhe “sundim” ka gjenezën nga Greqia antike por në opinionin tim argumentues edhe më heret. Në këndin islam popujt janë udhëhequr nga pejgamberët, *evlijatë*, njerëzit e dijshtëm, të urtë dhe të moralshëm. Ndërsa sot termi demokraci është zëvendësuar me elektokraci, pra ata që zgjidhen, sundojnë, korruptojnë, manipulojnë masën e gjërë. Pejgamberi a.s ishte njeriu më demokrat në rruzullin tokësor. Thoni ju pse? Sepse ai respektonte dhe përkrahte të gjitha shtresat, të gjitha racat, të gjithë popujt. Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlart zbritur Muhamedit a.s. thotë: **“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre”**.²⁶

Sot demokracia manipulohet dhe nuk është reale, ajo në emër të popullit shkatërron popullin, ajo është zëvendësuar në anarki. Sipas Linkolnit, demokracia është qeveri *“që i përket popullit, del nga populli dhe i shërben atij”*. Ndërsa Krijuesi ynë Allahu i Plotfuqishëm ka treguar se si duhet të jetë një popull i formuar dhe demokrat dhe çfarë parimesh duhet të ketë, ku thotë: **“Ju jeni populli më i dobishëm i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun”**.²⁷

Pra populli i mirë urdhëron për mirë dhe ndalon nga e keqja kështu është një demokrat i vërtetë. Allahu Fuqiptotë është Krijuesi i të gjitha krijesave, Ai e din se çfarë iu duhet dhe nevojitet atyre dhe çfarë nuk iu duhet dhe nevojitet atyre prej ligjeve dhe dispozitave, kurse njerëzit dallojnë në mençurinë e tyre, në moral dhe tradita, njerëzit janë të paditur çfarë iu nevojitet atyre me gjithë respektin e tyre që kanë nga dituria për përmirësimin e të tjerëve dhe për këtë arsye shoqëritë të cilat kanë zgjedhur gjykimin e demokracisë dhe neneve nuk iu është parë asnjëherë e mirë por vetëm shkatërrim, shthurje të moralit dhe shoqëri të prishura.

Shumë njerëz mendojnë se fjala “*Demokraci*” d.m.th. “*Liri e të shprehurit*”. Ky mendim është i prishur edhe pse kjo është një nga frazat e demokracisë. Me lirinë e të shprehurit në demokraci kuptojmë: *“Liria e besimit, liria e shthurjes së moralit, liria e shprehjes së mendimit, etj”*. Të gjitha këto kanë dëme në shoqërinë islame derisa arriti çështja në sharjen e Pejgamberit a.s. dhe mohimin e shpalljes së tij, sharja e Kur'anit dhe Sahabëve duke thënë se kjo është “liri e të shprehurit” me këtë demokraci u lejua: lakuriqësia, udhëtimet e kota, përhapja e fotove dhe filmave të fëlliqur me argument se kjo është “liri e të shprehurit” dhe kështu gjatë një periudhe të gjatë e cila e tëra ishte në shkatërrimin e *Umetit* islam nga ana e moralit dhe fesë së tyre.

Në emër të demokracisë jan përhapur shumë gjëra negative për shoqërinë ku e kanë fundosur njerëzimin në një greminë të pafundme. Zgjedhja e demokracisë së drejtë do të ishte gjykimin me ligjet e Allahut dhe veprimi me demokraci reale islame, sepse Allahu

²⁶ Kur'an-i: Surja: Ra'd, ajeti: 11.

²⁷ Kur'an-i: Surja: Ali Imran, ajeti: 110.

gjykon drejtë dhe është Krijuesi ynë. Populli dëshuron gjykime të drejta dhe të balancuara me ekuilibër dhe jo ekstreme, qoftë në të djathtë apo të majtë, gjykimi i takon Allahut. Qeverisja e së drejtës në Islam është një atribut tejet i rëndësishëm i udhëheqjes së pushtetit shtetëror islam. Ligjësia Islame “Sheriati” është sistem ligjor i cili duhet të respektohet maksimalisht dhe duhet ta ketë fuqinë më të madhe ligjore. Sheriatin mund ta konsiderojmë edhe si akti më të lartë juridik ngase në përputhshmëri me të nxirren aktet konkrete juridike. Ai konsiston në respektimin e ligjit dhe konsideron të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë përball ligjit.

Shikuar nga këndi i drejtës kushtetuese Sheriati është rend juridik i cili bën pjesë në akte juridike të forta, ngase ai nuk ndryshohet. Islami e konsideron atë si të pandryshueshëm dhe panevojshmëri e plotësisht të tij sepse është ligj hyjnor, plotësisht i kompletuar. Për fund e lusim Allahun Fuqiplotë që të na bëjë prej të drejtëve dhe atyre që luftojnë me mund që popujt e mirë që qeverisin mirë të udhëheqin këtë tokë, dhe vërtetë këtë botë e udhëheqin dhe do ta udhëheqin të drejtë dhe të mirë.

Prishtinë,

23.10.2011

25. Islami dhe teknologjia

Sot bota ka ecur shumë në aspektin teknologjik, mirëpo teknologjia është e gjërë si shkencë dhe bukalisht rrjedhë nga gjuha e vjetër greke “*techne*” – art, aftësi artizanale, dhe “*logia*” - shkencë, studim. Termi ose mund të aplikohet në përgjithësi ose në zona të veçanta: shembujt përfshijnë: teknologjinë e ndërtimit, teknologjinë mjekësore dhe teknologjinë e informacionit. Por pyetja shtrohet, sa flet Kur'ani dhe Suneti për teknologjinë? Sa dijetarët islam gjatë kohërave kontribuan për këtë fushë? Sa janë sot muslimanët në këtë problem të aftë ta zhvillojnë dhe sa e kanë zhvilluar apo sa kërkohet zhvillimi saj?

Ne duhet ta dimë se teknologjia kërkon mjete të sofistikuara për të zhvilluar problemin qoftë ajo teknologji shkencore, kompjuterike, motorike, bimore, ushqimore, shtazore, njerëzore etj. Kur'ani ka plot raste kur flet për teknologjinë p.sh.: rasti i teknologjisë dhe aftësisë që Allahu iu dha dy pejgamberëve hz. Sulejmanit a.s. dhe babait të tij hz. Davudit a.s të bënin këmisha-rroba nga hekuri si teknologji e tekstitil: **"Ne i patëm dhënë Davudit dhuratë të madhe nga ana e jonë: "O male dhe shpezë, lartësoni (me tesbih) së bashku me të!" Ne ia zbutëm atij edhe hekurin (si brumë). (I thamë) Puno këmisha të plota (nga hekuri) dhe thurri me precizitet ato. Dhe bëni vepra të mira (o familje e Davudit), se Unë vëzhgoj atë që ju punoni"**.²⁸

Apo aftësia e hz. Sulejmanit të lëvizë me anë të erës, vërtetë kjo një teknologji e lartë dhe e sofistikuar që njeriu të flururojë me lejen e Allahut me forcën e erës. Muslimanët i ndihmuan njerëzimit në shumë zbulime teknologjike, disa nga to janë të rënditura si më poshtë:

1. Kirurgjia - Afër 1000 vjet më parë doktori i famshëm el-Zahravi e publikoi enciklopedinë e ilustruar për kirurgji prej 1500 faqesh, e cila në Evropë u përdor për 500 vitet e ardhshme. El-Zahravi njihet edhe me disa nga operacionet e para që ka bërë.
2. Kafeja - Pija pa të cilën shumica e njerëzve nuk mund të kalojnë ditën, për herë të parë u paraqit në Jemen. Gjatë ditëve të punës është pirë për të ndihmuar njerëzit të jenë të zgjuar gjatë lutjeve të natës. Pastaj e kanë transferuar në Kajro dhe është përhapur shumë shpejt nëpër vendet muslimane. Në shek. XIII ka arritur në Turqi ndërsa në Evropë në shek. XVI nëpërmjet tregtarëve venedikas.
3. Makinat fluturuese - Shpikësi Abas ibn Firnas ka qenë njeriu i parë i cili ka bërë një gjë të cilën me të vërtetë ka fluturuar. Në shek. IX ai ka dizajnuar një konstruksion i cili ka ngjarë në një zog. Në përpjekjen e tij të famshme nga minarja e xhamisë së Kordobës në Spanjë ai ka fluturuar, por për një kohë të shkurtër është rrëzuar dhe ka vdekur, si shkak i një gabimi tek bishti i fluturakes, për të mbajtur drejtpeshimin. Dizajni i tij ishte inspirim për zbuluesin dhe artistin italian Leonardo Da Vinçi.
4. Universiteti - Në vitin 859 princesha Fatima al-Fihri ka hapur universitetin e parë i cili ka dhënë diploma në qytetin Fes të Marokut. Motra e saj e cila ka hapur një xhami të

²⁸ Kur'an-i: Surja: Sebe', ajetet:10-11.

cilën e kanë shfrytëzuar edhe si shkollë. Sot, pas 1200 vjet ende funksionon, vetëm për të rikujtuar njerëzit se dituria dhe shkollimi është një traditë muslimane.

5. Algjebra - Ky term vjen nga traktati matematikor i Persisë me emrin "Kitab al-Jabr al-Mukabele" e cila ka lindur në shek. IX. E ndërtuar sipas sistemit Hindu dhe Grek, algjebra ka qenë sistemi i vetëm për numra dhe gjeometri.

6. Optika - Shumë nga zbulimet që kanë të bëjnë me optikën vijnë nga bota muslimane. Rreth vitit 1000 shkencëtari musliman el-Hejthem ka vërtetuar se njerëzit shohin objektet nga reflektimi që bën drita në to dhe shkon te syri i tyre. Me atë ai ka zbuluar teoritë e Euklidit dhe Ptolomeut të cilët kanë menduar se vetë syri i njeriut emiton dritën.

7. Brusha e dhëmbëve - Thuhet se vetë Muhammedi a.s. është ai i cili i pari e ka popullarizuar përdorimin e brushës së dhëmbëve rreth vitit 600. Duke përdorur degën e një peme të quajtur Misvak, ai ka pastruar dhëmbët dhe ka freskuar frymën. Substanca të ngjashme me Misvakun sot përdoren në pastat e dhëmbëve.

8. Losti (vinçi) - Shumë nga gjërat që përdoren në automatikën moderne, për herë të parë janë shfrytëzuar në vendet muslimane. Duke kthyer lëvizjen rrotulluese në lineare losti ka mundësuar ngritjen e lehtë të sendeve të rënda. Kjo teknologji është zbuluar nga el-Xhezari në shek. XII, dhe për një kohë të shkurtër është përhapur në gjithë botën.

9. Spitali - Spitalet të cilat i njohim sot, me personel dhe salla speciale vinë nga Egjipti në shek. IX. Qendra e parë e këtij lloji ka qenë spitali "Ahmed ibn Tullun" e hapur në vitin 876 në Kajro. Ky institucion ka siguruar shërim falas për të gjithë të cilët kanë qenë të nevojshëm, e cila është bazuar në traditën muslimane në të cilën duhet të kujdesesh për të sëmurët. Nga Kajroja këto qendra pastaj janë përhapur në vendet muslimane.

Në shumë shoqëri, teknologjia ka ndihmuar në zhvillimin e ekonomive më të avancuara përfshirë edhe ekonominë globale të sotme dhe ka lejuar rritjen e një klasë të kohës së lirë. Sot bota e zhvilluar nuk mundet të funksionojë si duhet pa pasur telefon, kompjuter, internet, makina, aeroplana, makineri të cilat kryejnë punën e 100 punëtorëve e më shumë. Allahu xh.sh. në shumë vende në Kur'an na thërret në meditim dhe ta adhurojmë Atë për shumë gjëra teknologjike që Ai i ka krijuar dhe që i kemi falas dhe nuk kemi nevojë që t'i paguajmë, si p.sh.: **"Ai e bëri diellin shndëritës, e hënën dritë dhe asaj (hënës) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë. Allahu nuk e krijoi këtë për tjetër, pos me qëllim të caktuar. Ai ia sqaron argumentet një populli që kupton.**

Në ndërrimin e natës e të ditës, dhe në çka krijoi Allahu në qiej e në tokë, vërtet ka fakte për njerëzit që kanë drojë".²⁹

Sot poçet elektrike që i kemi apo ndriçimi elektrik më i avancuar qoftë dhe me tela përçues ari apo argjendi nuk mundet ta zëvendësojë dritën e diellit që Allahu xh.sh. ka krijuar në shërbimin tonë. Allahu xh.sh. e sistematizoi kohën dhe vuri rregulla disiplinore për njeriun që ai të funksionojë me rregullat që Allahu xh.sh. i ka vendosur për të, një fakt i tillë është edhe ndërrimi i ditës dhe natës. Kur'ani flet për: fizikën,

²⁹ Kur'an-i: Surja Junus, ajetet: 5-6.

astronominë, mjekësinë, gjeologjinë, zoologjinë, kiminë, matematikën, sociologjinë, historinë, psikologjinë, industrinë, të gjithave u ka lënë vend, por e jona është të gjejmë ekspertë të cilët u takojnë fushave të mësipërme që ata t'i elaborojnë me dritën e Kur'anit, të cilan janë të spjeguar mjaft mirë por kërkojnë metodologji të sqarimit dhe komentimit.

Me të vërtet një teknologji madhështore ishte edhe Israja dhe Mi'raxhi i të Dërguarit a.s. i cili u nis me Burakun-mjetin e udhëtimit në përcjellje të Xhibrilit a.s. për në Mesxhidul-Aksa në Jerusalem. Pas arritjes në këtë vend, e lidh Burakun për hallkën e derës së xhamisë dhe aty falë namazin bashkë me pejgamberët tjerë ku u bëhet edhe *imam* atyre. Pastaj bashkë me Xhibrilin a.s. niset për në sferat e larta qiellore, dhe në qiej takohet me pejgamberë të mëparshëm të cilët i përshëndet, edhe ata ia kthejnë përshëndetjen, i dëshirojnë mirëseardhje dhe e rikonfirmojnë besimin në pejgamberinë e tij. Pastaj ngritet në *Sidretul-munteha*, pikën më të lartë, e pastaj në horizontet e tjera të Allahut xh.sh.. Për këtë ndodhi madhështore, mrekulli teknologjike të sofistikuar për krijesën më të dashur Allahu xh.sh. e bëri mësim për ne dhe ndihmesë për Muhamedin a.s.. Kur'ani thotë për këtë:

“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është Dëgjuesi (i fjalëve të Muhammedit), Shikuesi (i punëve të Muhammedit)”³⁰ (Kuran Isra 1)

Nga kjo ngjarje e Israsë dhe Mi'raxhit nxjerrim këto mësimet për teknologjinë në Islam :

1. Buraku- një mjet udhëtimi që sfidon anijet kozmike dhe çdo mjet udhëtimi teknologjik që ka shpejtësinë më maksimale të mundëshme
2. Udhëtimi në kohë dhe hapësirë brenda një pjese të natës duke pasur takime me pejgamberët e tjerë.
3. Ngritja e tij dhe arritja e cakut më të lartë ku sfidon çdo aparat teknologjik qoftë ai satelit, anije kozmike supersonike, etj.
4. Dhe në fund fuqia e ngritjes, dhe kushtet e ngritjes, ku nuk kishte nevojë për oksigjen apo për motorë elektro-bërthamorë apo teknologji të tipit të lartë, e nxitë imagjinatën e çdo shkencëtari musliman të fushave teknologjike apo tjera.

**Prishtinë,
Nëntor 2011**

³⁰ Kur'an-i: Surja: Isra, ajeti: 1.

26. Islami dhe idetë ateiste

Allahu i Plotfuqishëm i dha mendjen njeriut me të cilën ai të logjikojë, arsyetojë dhe nga teoria t'i hedhë gjërat në praktikë. Tek njeriu Zoti xh.sh. vendosi rregulla jetësore, kur ato shkelen njeriu humbet qëllimin e ardhjes së tij në këtë botë. Ateizmi si një doktrinë anti-fetare sjelli pasoja letale, vdekjeprurëse për njerëzimin. Historia e dëshmoi pasojën e kësaj ideologjie verbale dhe anti-humane. Miliona njerëz të pafajshëm vdiqën nga luftërat botërore dhe idetë fashisto-komuniste, vdiqën për ide dhe teori të gabuara, vdiqën pa e ditur errësirën e petkut që fshehë kjo ideologji me emrin ateizëm.

Shumica e tyre e mohonin ringjalljen dhe i shpallën luftë feve, cënuan dhe përdoqën kulturën, fenë dhe harruan se janë njerëz dhe janë të vdekshëm dhe do të ringjallen dhe do të japin përgjegjësi për çdo send. Allahu atyre u tregon se: **“Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata pluhur (të kalbur)? Thuaj (O Muhamed): I ngjall Ai që i krijoi për here të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim”**.³¹

Ky ajet u përgjigjet ateistëve që thonin: a do të ngjallemi pasi të vdesim e të bëhemi pluhur? Ata shtronin lloj-lloj pyetjesh dhe nuk mendonin fare rreth krijimit të tyre, duke besuar vetëm atë që e shihnin. Pyetja jonë që i shtrohet ateistit është edhe rrymën që furnizon tërë qytetin me drita nuk e beson sepse ti nuk e sheh atë, apo ta marrim një qeremide të godasim në kokë sepse ti ndjenjën apo dhimbjen nuk e sheh.

Ateizmi është ide e cila promovon mosekzistimin e Zotit, pra është kulmi i marrëzisë dhe mosarsyetimi më i madh i njeriut që ka mend në kokë. Feja islame ka një qëllim që ateistit t'i mësojë pjesën e dytë të dëshmisë, pra ateisti pranon se “nuk ka zot” kurse e jona si muslimanë është që atë ta bindim se “Nuk ka zot përveç Allahut”. Idetë ateiste janë shpërndarë kudo në botë, sidomos me të madhe në shek. XVIII, XIX dhe XX. Shtrohet pyetja përse? Sepse ishin pikërisht disa figura që e instaluan këtë ide me të madhe në mesin e tyre spikatë Karl Marksi me veprën e tij “Kapitali”, por nuk duhet harruar edhe Nikolo Makiaveli i cili qysh në Mesjetë me veprën e tij “Princi dhe Sundimtari” lansoi dikataturën si ide dhe kishte moton “*Qëllimi justifikon mjetin*” pra duhet të shkatërrosh qoftë puna çdo send edhe vetë njerëzit, që të arrijshë famë, karrikë, pushtet, etj.

Ndërsa Muhamedit a.s. idhujtarët e Mekes ia ofruan të gjitha gjërat dhe ai i refuzoi sepse Zoti xh.sh. u premtan njerëzve në botën e përtejme shumë të mira të mëdha në krahasim me këto kalimtare të kësaj bote afatshkurtër. Njeriu i mençur mendon jetë të gjat dhe të lumtur në këtë botë dhe në tjetrën duke pasur qëllim lumturinë në botën e përtejme, ku nuk ka sëmundje, vuajtje, uri, padrejtësi, një vend i pastër dhe i mire, i përgatitur për të pastërtit dhe të mirët ata që këtë botë e kuptuan se është kalimtare dhe sprovë për njerëzimin. Allahu xh.sh. thotë: **“A menduan ata, të cilët vepruan në të**

³¹ Kur'an-i: Surja Jasin, ajetet: 78-79.

këqija, se në jetën e tyre dhe në vdekjen e tyre do t'i bëjmë të barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar është gjykimi tyre!³²

Pra gjërat janë të qarta, për ata që përdorin intelektin dhe mendojnë rreth asaj që Kur'ani i porositë, e jo si njerëzit naivë dhe ateistë që pa lexuar Kur'anin japin analiza monstruoze, anti-islame dhe anti-njerëzore, duke fyer një komunitet të tërë. Ringjallja është një realitet ashtu siç është realitet kur një mashkull hedh farën te vezoret e femrës dhe ajo ngelë shtatzënë ku nga asgjëja sjellë me lejen e Allahut xh.sh. një gjë e cila krahas materies ka dhe shpirtin. Islami respekton dhe ngritë njeriun, mëshiron më të voglin, ka tolerancë ndaj tjetrit, thërret në paqe si dhe në nënshtrim ndaj Zotit, Krijuesit të universit i cili e krijoi atë me urtësi dhe kjo urtësi na jep model neve se në ligjet e Zotit ka jetë.

Ateizmi shtypë të voglin, paraqet inferioritetin ndaj racave, toleranca nuk ekziston ndaj komunitetit idealist apo fetar, mohon Krijuesin e gjithësisë dhe është vetë armiku i njeriut. Idetë ateiste sjellën luftëra, Islami sjelli paqe, kulturë dhe zhvillim, ateizmi sjelli miliona viktima, vëllavrasje, krime, Islami sjelli qytetërimin në Gadishullin Arabik, në Spanjë, në Sicili, në Perandorinë Osmane që shtrihej në tre kontinente, si dhe përhapi idenë e paqes dhe faljes në mëse 7 miliardë njerëz që ka planeti Tokë.

Sot propagandat mediatike si el-Xhezira, CNN, BBC dhe shumë kanale mediatike tjera mundohen ta njollosin Islamin me nacionalizëm, komunizëm, ateizëm, sekularizëm, laicizëm, etj.

Jemi në një shekull me trazicion ku propaganda sekulare-ateisto-sioniste e paraqet Islamin si fe të terrorit dhe dhunës, si fe e diktaturës dhe fe e prapambeturisë, gjëra të cilat nuk kanë të bëjnë me Islamin dhe as nuk marrin erë fare nga feja islame. Historia e dëshmoi dhe do ta dëshmon se feja islame është zhvillim, integrim për ata njerëz të cilët e lexojnë Kur'anin dhe mendojnë sepse dhe Kur'ani i përmend ata të cilët mendojnë dhe na shtyn të mendojmë ku shpesh gjatë leximit hasim këto shprehje: A nuk po mendoni? A nuk po e shikoni? dhe këto gjëra i kuptojnë vetë ata të zotët e mendjes, pra ata që kanë mendje të shëndoshë ,jo ata të cilëve u është bërë shpërlarje truri nga sistemet politike nga hierarkia mediatike qoftë ajo e shkruara apo audio-vizuele. E lusim Allahun që të na ruaj nga kjo humbje e madhe, Amin!

**Prishtinë,
10.11.2011**

³² Kur'an-i: Surja: Xhathije, ajeti: 21.

27. Taborret Masone

Stuhitë e kohës na dokumentojnë popuj me ngjyra dhe ide të ndryshme, ky impakt i shtruar në rangun filozofik do na shpie tek ideja se nga erdhi masonizmi? Çfare ideje ka dhe hebrenjtë çka synojnë? Nga Talmudi, libri i i tyre i shenjtë citojmë tre versete që tregojnë dogmën e tyre:

“Gjithë popujt që nuk janë hebrenjë duhet të diskriminohen, maltreohen dhe të vriten si derra”.

“Lidhja jonë krijohet me tjerët vetëm përmes gjakut por nga ana e meshkujve hebrenjë dhe femrave johebrejë”.

“Ne do të udhëheqim botën si popull i zgjedhur i Zotit”.

Civilizimet më të hershme na e kanë treguar rangun e këtyre njerëzve të Judesë si bataqçinjë të rradhës, ideja e tyre përmes përfitimeve materiale ekonomike që të fusin përçarje në rradhët e popujve jo-hebrenjë. Që nga Judea dhe Mesopotamia, që nga forca dhe dhuna e Faraonëve duke ushtruar terror mbi popullatën civile, duke i nënshtuar si robër dhe skllevër, shumicën dërrmuese të cilat i vërejmë edhe në vizatimet murale. Tirania, terrori i ushtruar ndaj pejgamberëve njerëzve të mirëqenies, vrasja e tyre, goditja, ushtrimi i terrorit ndaj masës duke futur frikën dhe duke krijuar zotëra nga vetë njeriu dhe duke i ngritur si perandorë që i udhëheqë, nocion ky tërësisht i gabuar.

Idetë ripërtërihen në Greqinë dhe Romën antike duke u tërhequr nga Lindja e lashtë, dhuna e qytetërimeve në emër të zotave, duke e parë luftën si mjet absolut për të arritur qëllimin, munda çdo sfidë globale dhe shfaqti aparençën e lartë destruktive të mitit duke thyer idenë e proklamuar nga njeriu që ndërton zota. *Beni israelitët* si popull kryeneç në bindje anti-jezuiste, anti-muhamedane, fortunë ekstremiste, duke sjellë afekcion dhe çrregullim kolapsues për kohërat në linjë llogaritëse jetësore. Ngatërrimi mes shenjtërisë dhe monetës materiale, duke humbur besimin për kapital si treshja Marksi-Lenini-Stalini, që dënuan pronën private dhe vendosën ideologjitë gjithpërfshirëse, si: *“ne udhëheqim botën”* term ky aneksues i imperializmit, apo duke u krahasuar me iluministët, si: *“ne jemi koka të përndritura si da Vinçi apo Mikelanxheloja”*, dhe duke shkuar tek politika e Bizmarkut apo Garibaldit me moton: *“Bashkimi bën fuqinë – imperatorinë”*. Ata këndojnë pranë Murit të Vajtimit në Jerusalem, kërkojnë por nuk munden ta marrin ngase ka pengesa, arsyeja sepse vendi është i mbrojtur e shenjtëruar.

Bankierët Rotshild dhe Rokfeler krijojnë boshtin e bankierëve përfitues në kohëra të mëhershme duke ndjekur rrugën e karavaneve përfituese të stolive dhe gjërave me vlerë. Por edhe pse me shumë aftësi, shteti i paligjshëm i Izraelit u bë me vonesë nga David ben Gurion më 1948 pas shumë përpjekjesh dhe manovrash duke përfituar nga masakra hitleriane në Luftën e Dytë Botërore duke marrur pretekst gjenocidin e ushtruar ndaj tyre. Izraeli dhe Palestina, konflikti vazhdon mes të dyve sepse duhet vendosur drejtësia në rregullat e pronave dhe të drejtave të etnive përkatëse, këtë e tregon mirë

shprehja e hershme: *israelitë* dhe *filistinë*, dy fise, dy popuj, dy ngjyra, dy kultura, dy gjuhë, dy mendime dhe ide tërësisht të ndryshme, ta quajmë ashtu kur edhe besimi ka dallim madhor mes këtyre dyve dhe detyrimisht konflikti vazhdon, nëse nuk do të ketë një ndërhyrje madhore që ta shuaj këtë luftë të pandalshme masone, atë ndërhyrje mund ta bëjë vetëm Imam Mehdiu.

**Prishtinë,
Mars 2010**

28. Islami dhe njeriu

Islami e ngriti njeriun duke e veçuar nga të gjitha krijesat, e veçoi duke i dhënë mendjen dhe shumë dhunti dhe e dalloi nga krijesat tjera. Zoti xh.sh. thotë: **“Vërtet, Ne e krijuam njerin në formën më të bukur. Pastaj e zbritëm atë në më të ultin e të ultëve. Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira; ata kanë shpërblim të pandërprerë”**.³³

Allahu xh.sh. i tregon në këto ajete dy palët e njerëzve, ata që i krijoi dhe i ngriti dhe e falenderuan të cilët janë besimtarë dhe vepërmirë që shpërblimi për ta është i pandalshëm, si dhe atë pale që e uli veten duke mohuar Zotin, duke mos qenë falenderues nga mirësitë që Allahu i ka dhënë e të cilat janë të panumërta. Njeriu sipas Kur'anit gjithmonë ka qënë studim në të gjitha shkencat, nga ato humane, shoqërore, ekzakte, shkencore, pedagogjike, fetare, etj.

Njeriu i parë ishte hz. Ademi a.s. babai ynë dhe i mbarë racës njerëzore, ai gaboi dhe ne jemi gabimtarë. Dijetari Ibn Kajim el-Xheuzije ka thënë: *“Po të mos gabonte Ademi a.s., do të humbiste nga mendjemadhësia, pra gabimi ishte provë për babain tonë dhe është për mbarë njerëzimin deri në fund të kësaj bote”*.

Njeriu ka këto etapa jetësore:

- 1) Lindja,
- 2) Rritja,
- 3) Vdekja,
- 4) Jeta në varreza,
- 5) Ringjallja dhe gjykimi,
- 6) Pragu përfundimtar i përhershëm Xheneti për besimtarin, Xhehenemi për jobesimtarin.

Njeriu në këtë botë përballet me sprova të shumta si: sëmundje, varfëri, pasuri, vetmi, familje, grua, fëmijë, etj. Njeriu ka vese të shumta negative, nëse arriti të lirohet nga ato, do të bëhej rob i Krijuesit Fuqiplotë e jo rob i krijesave të paplota dhe të mangëta. Çlirimin nga veset negative njeriu e arrinë vetëmse duke iu referuar Kur'anit dhe Sunetit duke marrë mësimet nga aty joformalisht, por ato mësimet të jetësohen në përditshmërinë e tij.

Njeriu i krijuar nga dheu prej anës së Allahut xh.sh. duhet gjatë jetës ta kuptojë se ka ardhur për një mision i cili është pikërisht në ajetin kur'anor ku thotë: **“ Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë”**.³⁴

Njeriu si krijesë e Allahut xh.sh. duhet nënshtruar vetëm Atij dhe askujt tjetër, qoftë ai sistem, ideologji, subjekt apo objekt, sepse vetë fjala “Islam” është nënshtrim paqësor ndaj Allahut, Krijuesit të gjithësisë. Islami e urdhëron njeriun t'i bindet dhe nënshtrohet Allahut e jo OKB-s, NATO-s, BE-s, e as ndonjë grupi apo partie politike apo

³³ Kur'an-i: Surja: Tin, ajetet: 4-6.

³⁴ Kur'an-i: Surja: Dharijat, ajeti: 56.

apolitike. Islami e ktheu njeriun në origjinën e tij, që është “*njeriu human*” që vjen nga terminologjia latine “*Humanus*”, pasi Zoti xh.sh. e di më së miri se për çfarë ka nevojë njeriu pasi Ai është Krijuesi i tij nga një pikë e vogël uji që nuk shikohet me sy të lirë, e cila kur bashkohet me vezoren femërore dhe formohet njeriu. Pikërisht këtë gjë të mrekullueshëm që para pak kohësh e zbuloi edhe vetë shkenca. Kur'ani e tregonte para 14 shekujsh, ku Allahu xh.sh. thotë: **“Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkëdyzuar për ta sprovuar atë, andaj e bëmë të dëgjojë e të shohë”**.³⁵

Islami e kthen terminologjinë latine dogmatike filozofike nga “*homo-homini lupus* – *njeriu për njeriun është ujk*“ në “*homo est homo per homini* - *njeriu është njeri për njerëzit*“. Pra besimtari rregullon mirqenien në planet, eviton konfliktet dhe pason rrugën e peygamberëve, sepse këtë botë do ta udhëheqin njerëzit e mirë ata të cilët besojnë Allahun. Zoti xh.sh. na bëftë prej krijesave të bindura, falënderuese dhe adhuruese ndaj Tij, Amin!

**Prishtinë,
29.11.2011**

³⁵ Kur'an-i: Surja: Insan, ajeti: 2.

29. Islami dhe tregtari i Venedikut

Evropa kuptohet se ka jetë të gjatë në historinë e saj zhvillimore por ajo i falënderohet shumë kulturave në formësimin e saj si kontinent dhe qytetërim, dhe më së shumti i duhet falënderuar Islamit dhe realitetit që ai u mundua Evropës t'i japë. Po çfarë lidhje ka Islami me tregtarin e Venedikut dhe vetë Venedikun? Kuptohet. Kësaj i duhet dhënë një sqarim të hollësishëm por të shkurtër dhe të prerë qartazi.

Ishte pikërisht libri “Tregtari i Venedikut” të cilin e shkroi autori anglez William Sheakspear, që më bëri të rradhise këta rreshta. Ngjarja apo drita jeshile hyn pikërisht në shek. XV dhe fillimin e shek. XVI. Libri trajtohet në skena por mesazhi i tërë librit është tmerri për njerëzimin pa u kuptuar fare, atëherë shkatërrimi ekonomik do vjen në emër të lehtësimit tregtar dhe do të hyjë dhe zhvillohet si sëmundje në shekuj.

Çdonjëri prej jush do pyes për çka është fjala? Fjala është për kamatën, kreditë bankare dhe planet masonike dhe sioniste që atëherë, duke zëvendësuar paranë e çmuar me atë të letrës fallso dhe të pa vlerë. Një mashtrim i hatashëm për njerëzimin dhe një fitore e një grupi botëror njerëzish, diletantë bankierë që duan botën ta fundosin drejt kolapsit ekonomik. Po Islami çfarë thotë për kamatën dhe gjërat e tilla që mashtrojnë njerëzimin?

Në temën “Islami dhe ekonomia” kemi treguar disa gjëra, por kjo i takon ekskluzivisht këtij truku bastardësh të cilët kanë skemë për shkatërrimin e njerëzimit dhe në veçanti ata duan t'i shkatërrojnë tokat islame dhe muslimanë e të formojnë shtetin e tyre kinse të epokës së artë kur shteti i Judesë ishte në kulmin e fuqisë së tij shumë shekuj më parë p.e.s., në kohën e pejgamberit Sulejman a.s. që Allahu xh.sh. i kishte dhënë fuqi dhe besim të pastër islam. Allahu xh.sh. në lidhje me kamatën thotë: **“O ju që besuat, kini frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë të singertë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata. E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk heqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në luftë me Allahun dhe të dërguarin e Tij...”**³⁶

Letërsia angleze dhe ajo botërore me njeriun gjigand të letërsisë na servirë në formë drame dhe teatri shkatërrimin njerëzor përmes interpretimeve ideologjike që bien në kundërshtim me Kur'anin, drejtësinë e logjikën e pastër, duke e bërë njeriun rob të *dinarit* dhe *dërhemit*, ku në lidhje me këtë Pejgamberi a.s. na ka paralajmëruar kohë më parë duke thënë: *“U shkatërrua rob i dinarit dhe dërhemit”*.³⁷

Por sot në çfarë realiteti jemi? Populli evropian i cili është bërë skllav i bankave masono-sioniste ku ato çdo ditë e më shumë po kontrollojnë ekonominë tonë derisa të vjen momenti që të na skllavërojnë dhe robërojnë tërësisht. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Do të vijë një kohë për njerëzit ku do të hanë kamatën.” Ebu Hurejra pyeti: “A të gjithë njerëzit?” Ai tha: “Ai që nuk do të hajë prej tyre do të marrë prej pluhurit të saj”*.³⁸

³⁶ Kur'an-i: Surja: Bekare, ajetet: 278-279.

³⁷ Transmeton Buhariu.

³⁸ Transmetojnë: Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe.

E vërteta është se jemi afër Kijametit, kur dihet se rob po i robërohet parasë së pavlerë të letrës që nuk ka një gram floriri dhe nuk po i robërohet Allahut xh.sh. që është Krijues, Furnizues, Fuqiplotë, depot dhe pasuria e të Cilit janë pa kufi, pa limit dhe të përhershme. Tregtari i Venedikut i cili u propagandua dhe u zhvillua edhe sot me mediat sioniste është bërë gjigand i kredive dhe interesave të bankierëve masonë. Fati i tregtisë së naftës apo shumë materialeve të tjera me vlerë do të bankrotojë shumë shpejtë. Pas parave nga letra e pavlerë duke fituar atë me vlerë që është e çmueshme si ari, nafta, metalet e rralla, mëndafshi, tekstili, vajërat, etj.

Tani sionistët duan ta zhvlersojnë edhe dollarin dhe të gjitha kartëmonedhat fallso që ata vetë i inskenuan në tregun botëror. Jemi në prag të kapitullimit të dollarit dhe Eurozonës e cila do të shkatërrojë ekonominë botërore për të pasur një lloj tjetër përfitimi nga kastat sionisto-masone të cilat do të formojnë paranë elektronike për të na pasur nën kontrollin total të tyre, por lusim Allahun xh.sh. që mos të bijmë viktimë edhe kësaj rradhe sepse shoh disa lëvizje të dijetarëve muslimanë që po shpalosin realitetin e këtyre mashtruesve botëror siç janë sionistët. E lusim Allahun Fuqiplotë që të fitojmë sa më parë në luftën ndaj tyre për të cilën ka treguar Profeti a.s. para 14 shekujve. Amin!

**Prishtinë,
Dhjetor 2011**

30. Ideologjia e tmerrit

Pse ky titull? Sapo nisa këto pjesë shkrimesh në librin tim “Islami dhe ideologjia” i cili me lejen e Allahut do të dalë në botim së shpejti dhe do jetë në duart tuaja. U mundova të skalis në këtë temë disa vese degjeneruese dhe shkatërruese për njerëzit. Sapo kalova disa pjesë të lagjeve të Prishtinës pashë që në çdo skaj të rrugës bastoret sportive me emra të ndryshëm ishin stërmbushur me rini që brohorisnin për ekipin e zemrës, ndërsa unë vrapoja për të zënë namazin e *akshamit* ku *ezani* dëgjohej në çdo skaj.

Prishtina dikur e mbushur me gra me *ferexhe* e burra me *çallme*, është mbushur me minifunde dhe burra me varëse në qafë dhe vathë në veshë që u ngjanin popullit të Lutit a.s. të cilet ishin devijantë homoseksualë. Ndërsa një pano lakuriqe propagandonte veshjen e një gjysmë femre lakuriqe me shishe të alkoolit që fuste në kokat e të rinjve ideologjinë e tmerrit në emër të modernizmit apo ndryshe një ditë që quhej se kinse “dita e rinisë”. Padrejtësi kudo, *fukarenjtë* kishin mbushur udhët, ndërsa bosët e tenderave harxhonin naftë duke u endur kot së koti nëpër vende qejfi.

Po Tirana si duket? Rrugë të hapura kudo, disa pleq të dërmuar nga vuajtja e fëmijëve të tyre të rritur që i kishin lënë në azil prindërit duke i hedhur *skarco* e duke mos pasur aspak kujdes kush për ta. Rini e shthurur! Hyra në qytetin Studenti, në vend të

shihje qytetin duke lexuar e shkëmbyer literaturë dhe mendime mësimore i shihje të fundosur në alkool dhe drogë, dhe rrallë shihje një femër me veshje të edukuar. Koka e të rinjve tanë që manipulohet nga filmat *hollywoodian*, disa *horror*, tmerr dhe krime, disa abuzim apo seriale ku shfaqet hapur kurvëria, ku instrumentalizohet e tmerrohet mendja e të rinjve tanë.

Tmerruese për ne, kur rinia jonë harxhon apo vret kohën duke shpenzuar paratë nëpër kazino, *harame*, dhe duke mos menduar si të blejnë një libër të ri të cilin ende nuk e kanë lexuar. Shfrenim dhe imoralitet kudo. Si ta parandalojmë këtë vëllezërit e mi lexues? Si mendoni ju ta eliminojmë të keqen – tmerrin. Këtë na e ka mësuar i Dërguari a.s. para 1400 vjetësh i cili ka thënë: **“Kush nga ju sheh një të keqe - le ta ndryshojë me dorë, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë - atëherë me gjuhën e tij, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë - atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët”**.³⁹

Por për këtë duhet punë ekipore dhe të ndihmohemi mes veti me atë që thotë Allahu në Kur'an: **“Ju jeni populli më i mirë i ngritur për njerëzimin: ju jeni që urdhëroni për të mirën dhe ndaloni prej të keqes, dhe ju besoni në Allahun”**.⁴⁰

Ajeti dhe hadithi kërkojnë të zërthehen dhe praktikohen në pikat si mëposhtë:

1. Hapja e medreseve islame dhe edukative,
2. Hapja e universiteteve islame dhe edukative,
3. Mejetpet nëpër xhami të jenë shumë funksionale,
4. Formimi i instituteve islame, edukative dhe shkencore,
5. Futja e mësim-besimit nëpër shkolla fillore dhe të mesme,
6. Mbajtja e takimeve me të rinjtë nëpër qendrat studentore,
7. Shpërndarja e librave, cd-ve, fletushkave islame me karakter moral dhe edukativ,
8. Mbajtja e tribunave fetaro-shkencore,
9. Takim dhe ligjërata islame me pyetje-përgjigje nëpër lagje të qytetit ndërsa nëpër fshatra, takim me fshatarët,
10. Vizitat e hoxhallarëve nëpër ceremoni gëzimi apo ngushëllimi, dhe aty të flitet për fenë islame,
11. Tribunë me intelektualë dhe studentë në ambiente bibliotekash, sallash mësimore dhe paraqitje e Islamit përmes metodave interaktive me monitor apo video-projektor,
12. Hapja e televizioneve dhe radiove islame në frekuencat tokësore, satelitore dhe në internet,
13. Promovimi dhe botimi i librave me përmbajtje islame, shkencore dhe edukative për njerëzit, etj.

**Prishtinë,
08.12.2011**

³⁹ Transmeton: Muslimi.

⁴⁰ Kur'an-i: Surja: Ali Imran, ajeti: 110.

31. As'habu'l-Kehfi nga e kaluara në të sotmen

Kur Allahu dëshiron t'i shpëtojë robërit e Tij, Ai u gjen atyre zgjidhje dhe rrugë të lehta shpëtuese ku mendja e njeriut nuk e kupton dot. Andaj e kaluara shpesh herë përsëritet, vetëm personazhet ndërrojnë kurse subjekti dhe qëllimi është po ai, edhe pse mund të ketë konotacion modern për kohën. Tema që do ta analizojmë ka të bëjë me një sëmundje apo kurth që ka rënë njerëzimi që nga koha e Hz. Nuhut a.s. kur filloi pabesimi dhe bërja ortak Krijuesit dhe nga atëherë vazhdon edhe sot. Allahu xh.sh. e ka spjeguar qartë ngjarjen e As'habu'l-Kehfit në ajetet vijuese:

9. A mos mendove ti se ata të vendosurit e shpellës dhe Rekimit ishin nga mrekullitë Tona më të çuditshme?

10. Kur djelmoshat u strehuan në shpellë e thanë: "O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë!"

11. Ne u vumë mbulojë mbi veshët e tyre (i vumë në gjumë) në shpellë për disa vite me radhë.

12. Pastaj ata i zgjuam (prej gjumit) për të parë se cili prej atyre dy grupeve është më preciz në njehsimin e kohës sa qëndruan gjatë.

13. Ne po të rrëfejmë saktë çështjen e tyre. Ata ishin disa djelmosha, kishin besuar Zotin e tyre, e Ne atyre edhe më ua shtuam bindjen.

14. Edhe i forcuam zemrat e tyre saqë kur u ngritën, thanë: "Zoti ynë është Zot i qiejve e i tokës, nuk adhurojmë ndonjë zot tjetër pos Tij", pse atëherë do të thoshim diçka shumë mizore!"

15. Këta, populli ynë ka besuar zota të tjerë pos Atij, pse pra nuk sjellin ndonjë argument të qartë për ata? A ka më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj Allahut?

16. Derisa jeni izoluar prej tyre dhe prej asaj që adhurojnë ata, pos Allahut, atëherë strehohuni në shpellë, e Zoti juaj ju dhuron nga mëshira e Tij e gjerë, dhe ju lehtëson në çështjen tuaj atë që është në dobinë tuaj.

17. Dhe ti e shihje diellin, kur lindte bartej prej shpellës së tyre nga ana e djathtë, e kur perëndonte largohej nga ata nga ana e majtë, e ata ishin në një vend të gjerë të saj. Kjo ishte një nga argumentet e Allahut. Atë që e udhëzon Allahu, ai vërtet është udhëzuar, e atë që e humb, ti nuk do të gjesësh për të ndihmës që do ta udhëzonte.

18. Do të mendoje se ata janë të zgjuar, ndërsa ata ishin të fjetur, e Ne i rrotullonim herë në krahun e djathtë e herë në të majtin. Qeni i tyre i kishte shtrirë këmbët e para pranë hyrjes. Sikur të kishte hasur në ta, do të ishte kthyer duke ikur dhe do të ishte mbushur frikë prej tyre.

19. Ashtu (sikurse i vumë në gjumë) i zgjuam ata që të pyesin njëri-tjetrin (se sa kanë fjetur). Njëri prej tyre foli e tha: "Sa keni ndejur?" Ata thanë: "Kemi ndejur një ditë ose një pjesë të ditës!" Disa thanë: "Zoti juaj e di më së miri se sa keni ndejur, prandaj dërgojeni njërin prej jush me këtë argjend (monedhë argjendi) në

qytet, e të zgjedhë ushqim më të mirë, e t'ua sjellë atë juve dhe le të ketë shumë kujdes e të mos i japë të kuptojë askujt për ju".

20. Pse, nëse ata (të qytetit) kuptojnë për ju, do t'ju mbysin me gurë, ose do t'ju kthejnë në fenë e tyre, e atëherë kurrë nuk keni për të shpëtuar.

21. Dhe ashtu (sikurse i zgjuam nga gjumi) i zbuluam (t'i shohin njerëzit), e të kuptojnë se premtimi i Allahut (për ringjallje) është i sigurt dhe se katastrofa e përgjithshme (kijameti) është e padyshimtë. (I zgjuam) Mu atëherë kur ata (populli) bisedonin për çështjen e tyre dhe thanë: "Ndërtojuni atyre një ndërtesë (të jetë shenjë). Zoti i tyre di më së miri për ta. E ata që ishin me shumicë thanë: "Do të ndërtojmë gjithqysh në hyrjen e tyre një xhami".

22. Ata (që bisedonin për këtë) do të thonë: "Ishin tre, i katërti i tyre ishte qeni i tyre, dhe thonë: "Ishin pesë, e qeni i tyre ishte i gjashti i tyre", kjo ishte hamendje, po edhe thonë: "Ishin shtatë, e qeni i tyre ishte i teti!" Thuaj: "Zoti im di më së miri për numrin e tyre, përveç një pakice nuk di kush për ta, e ti (Muhammed) mos polemizo për numrin e tyre vetëm ashtu në tërësi, dhe askë mos pyet për ta".

23. Dhe mos thuaj kurrësesi për ndonjë çështje: "Unë do ta bëj këtë nesër!"

24. Vetëm (nëse i shton): "Në dashtë Allahu!" E kur të harrosh, përmende Zotin tënd dhe thuaj: "Shpresohet se Zoti im do të më japë udhëzim edhe më të afërt prej këtij (të As'habu'l-Kehfit)".

25. (dhe thonin) Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind e nëntë vjet.

26. Thuaj: "Allahu e di më së miri sa kanë ndejur, Atij i takon fshehtësia e qiejve dhe e tokës. Çfarë (i çuditshëm) është të pamurit e Tij dhe çfarë është të dëgjuarit e Tij! Pos Tij ata (njerëzit) nuk kanë ndihmëtarë. Në vendimin e Tij nuk mund t'i përzihet askush.⁴¹

Të gjitha këto ajete do të meritonin komentim të detajuar me të cilat do të dilnin libra me shumë vëllime. Por ne do e sqarojmë në mënyrë telegrafike mesazhin e këtyre ajeteve ku Allahu xh.sh. tregon për forcën stoike të këtyre burrave të cilëve Ai ua kish forcuar besimin, adhurimin e pastër në atë kohë dhe në atë periudhë kur Perandoria Romake ishte stërmbrushur me idhuj, statuja dhe besime të kota pagane, ku njerëzit edhe pse me gjithë atë civilizim të lartë u kishte humbur udha në oborr dhe kishin rënë në humbje dhe errësirë paditurie duke adhuruar gjëra të kota.

Mirëpo fuqia e Allahut xh.sh. iu solli argumentet nga mesi i tyre, një elitë aristokratësh besimtarë dhe të privilegjuar kundërshtuan perandorin dhe perandorinë e padrejtë e cila adhuronte idhuj të kotë, pra kishte devijuar total dhe besimi i tyre ishte adhurimi i djallit, i varreve dhe statujave si: Mërkuri, Jupiteri, etj. Po ata djelmosha bën *hixhret* dhe u shpërngulën edhe pse kishin dhimbje në zemër për vendin e tyre dhe familjet e tyre, ata kundërshtuan atë hierarki të dhunshme paganiste. Zoti Fuqiplotë ua shtoi bindjen dhe adhurimin duke i marrë në mbrojtje, por me besim të pastër.

⁴¹ Kur'an-i: Surja: Kehf, ajetet: 9-26.

Sot paganizmi manifestohet sërish, por ajo ngjarje është mësim edhe për ne besimtarët e shek. XXI, që të mos pajtohemi duke ju bindur sovranit kur ai vetë adhuron Djallin apo vetë subjektin apo objektin, që mund të jetë një parti që adhurohet, statujë, varrezë, apo lider i një organizate duke hedhur poshtë fjalën e Allahut xh.sh. dhe adhurimin që i takon vetë Atij.

Këta djelmosha të sinqertë sjellin mesazh për mbarë muslimanët dhe njerëzimin në përgjithësi se si duhan dhe u sfiduan për hir të Krijuesit Fuqiplotë dhe vetëm që ta adhuronin Atë të qetë, qofshin në male të larta, fshatra apo qytete, lugina apo rrafshnalt, kodra apo shpella. Pra kudo Allahu Fuqiplotë adhurohet dhe çdo gjë i bën *sexhde* Atij përveç atij që ka humbur dhe është i humbur larg në errësirë dhe adhurime të kota, andaj të gjitha Allahu xh.sh. i falë përveç *shirkut*.

Ata djelmosha janë simbolikë nga e kaluara në të sotmen, se si robi adhures i përkushtuar në devotshmëri ndaj Allahut është i aftë të sakrifikojë pasurinë, familjen, sigurinë e tij dhe çdo gjë për Allahun, Krijuesin tonë Fuqiplotë i Cili na i dha të gjitha. Dita e tyre erdhi, ata ngadhënjyen ndërsa shumë perandorë vdiqën e u harruan në gërmadha ashtu siç vdiqën shumë diktatorë.

Islami dhe besimtarët jetuan dhe e zhvilluan besimin e pastër edhe në ato momente kur iu rrezikohesh jeta dhe çdo gjë e tyre. Allahu xh.sh. i morri në strehë, e ku ka mbrojtës më të madh se Krijuesi i gjitha krijesave? Vërtet njeriu është i mangët dhe nuk e din se a do të agojë nesër apo do të vdesë në gjumë, kur dihet se Allahu xh.sh. ka në dorë shpirtrat tanë.

Banorët e Shpellës dhe e tërë Surja “Kehf” ka në vete përfitime dhe mësim se si krijesa duhet t’i mbështetet vetëm Allahut Fuqiplotë, dhe atëherë me lejen e Tij shpëtimi do të jetë i sigurtë sepse kjo botë është një ëndërr e shkurtër ku do na zgjojë ose në lumturinë e përhershme ose në makthin dhe në fatkeqësinë e tmerrshme. Allahu na ruajt, na pastroftë nga mëkatet dhe na bëftë prej adhuresve të Tij të përkushtuar mëngjes e mbrëmje, Amin!

**Prishtinë,
11.12.2011**

32. Islami dhe integrimet

Zoti xh.sh. e pajisi njeriun me aftësi dhe mençuri që ai të përdor aftësit e tij që të integrohet në kohë dhe hapësirë, të jetë praktik dhe të jetojë me botën duke përdorur teknika dhe metoda për të pasur një mirëqenie sa më të mirë. Ajeti parë kur'anor na shtynë të nisim hapat e parë drejt integritit, ku na thotë që ta zhdukim analfabetizmin dhe ta lexojmë vetveten, por edhe të studiojmë dhe arrijmë zhvillim të lartë duke na thënë: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi çdo gjë. Krijoi njeriun prej pikës së ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo, se Zoti yt është më bujari!”**⁴²

Ndërsa sot të ashtuquajturat integrame evropiane na ushqejnë me media të shkruara dhe dixhitale përmes reklamave se integrim është: zhveshja, lakuriqësia e femrës, konsumimi i drogës, prostitucioni, fjetja dhe marrëdhëniet intime me qenë apo kafshë shtëpiake, filma me përmbajtje imorale, telenovela që bastardojnë mentalitetin e femrës, dhuna që shfaqet në media, indoktrinimi me festat e tyre pagane të fundvitit, etj. Poshtërsi, dhunë, krim, korrupsion, blasfemi, strese psikologjike, imponim të ideve, shthurje dhe tërë të zezat ofrojnë mediat në emër të integritit.

Ndërsa feja islame e orienton njeriun kah drita e Krijuesit Suprem që është Dritë integruese dhe shpëtuese për tërë njerëzimin. Allahu xh.sh. thotë: **“Allahu është Dritë (ndriçues, udhëzues) i qiejve e i tokës. Shembulli i dritës së Tij i gjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët. Kandili gjendet brenda një qelqi si të ishte yll flakërus e që ndizet prej (vajit të) një druri të bekuar, prej ullirit që nuk mund të quhet as i lindjes e as i perëndimit, e vaji i tij ndriçon pothuajse edhe pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë. Allahu udhëzon kah drita e Vet atë që do Ai. Allahu sjellë shembuj për njerëzit. Allahu çdo gjë di shumë mirë”**.⁴³

Muslimanët do të integrohen vetem kur t'i kthehen Kur'anit dhe Sunetit, sepse Allahu xh.sh. në këtë Kur'an ka ofruar katalogun e jetës për njeriun, se si ai të zhveshet nga egoja e mendjemadhësia dhe ingrigat e Iblisit të mallkuar i cili i ka shpallur luftë njeriut që nga koha e hz. Ademit a.s. e deri në fundin e kësaj gjithësie. Në kohën kur Dexhalli do t'i shfaqet njerëzve lakmitarë pas kësaj bote të përkoheshme, gjërat e këqija do t'ua zbukurojë në emër të integritit në Evropë apo kinse në imitime të ashtuquajturve *“yje të kinemave”* të cilët divorcohen çdo muaj dhe kanë një jetë të shthurur me prostitucion dhe drogë.

Muslimanët në historinë e tyre të kaluar u integruan kur ju dhanë Kur'anit duke e studiuar atë dhe duke gravituar në botën e tij ku në të ka shkencë, ligje dhe zgjidhje për çdo gjë sepse Zoti xh.sh. thotë: **“ Ne ty ta shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për muslimanët”**.⁴⁴

⁴² Kur'an-i: Surja: Alek, ajetet: 1-3.

⁴³ Kur'an-i: Surja: Nur, ajeti, 35.

⁴⁴ Kur'an-i: Surja: Nahl, ajeti: 89.

Pra ky Kur'an ka sqarim për çdo send nga: kimia, mjekësia, biologjia, historia, sociologjia, fizika, botanika, gjeologjia, ligjet, zoologjia, matematika, ekonomia dhe shumë gjëra të cilat i ofron ky libër si udhëzues dhe sqarues për çdo problem jetësor që ka njeriu.

Fjala integrim është që njeriu të ecë në tokë të Allahut xh.sh. dhe të punojë sipas urdhërave që Ai e urdhëron dhe ta fitojë furnizimin, ta fitojë mirësinë dhe të punojë i përkushtuar në rrugë të Tij. Allahu xh.sh. i dha integrim të lartë hz. Sulejmanit a.s. duke ia mundësuar përpunimin e rrobave nga hekuri dhe duke i pasur në komandë njerëzit, exhinët dhe kafshët. Poashtu edhe hz. Muhamedit a.s. i dha integrim të lartë duke i nxjerrur arabët paganë nga errësira e idhujtarisë në dritën e Allahut xh.sh. dhe zhvillimin e tërë Gadishullit Arabik duke u shtrirë në tërë botën drita islame në mënyrë të ngadalshme por të sigurtë.

Integrim i lartë ishte edhe udhëtimi i Israsë dhe Mi'raxhit, mrekulli që Allahu ua dëshmoi mosbesuesve të asaj kohe se tek Ai është integrimi dhe Ai ka në dorë që brenda një natë ta çojë robin e tij nga toka deri në sferat më të larta qiellore dhe të ketë takime me shumë peygamberë të Allahut që kanë qenë më parë.

Integrimi islam sjelli që muslimanët të ndërtojnë shtetin me drejtësi të Allahut siç bënë halifët e drejtë, të ndërtojnë shtëpinë e parë në Mekë - Qaben, xhaminë e Pejgamberit në Medinë, të formojnë shkolla, mejtepe, xhami, universitete, Samarkandin, Andaluzinë, Perandorin Osmane, dhe shumë e shumë qytetërime dhe zhvillime.

Andaj ardhmëria dhe integrimi do të vjen kur ne ta lëmë egon, mendjemadhësinë, padrejtësinë, shirkun dhe t'i qasemi studimeve të fjalës së Allahut – Kur'anit Famëlartë. Allahu na bëftë prej të integruarve në fenë islame dhe me fjalën e mirë, shembulli i të cilës është si pema e mirë, rrënjët e së cilës janë thellë në tokë dhe frytet me bollëk dhe bereqet lart në degë, Amin!

**Prishtinë,
16.12.2011**

33. Musa a.s dhe Hidri a.s. - reflektim nga e kaluara deri më sot

Jeta e njeriut është mësim, mësimi mund të vjen edhe nga gjërat e vogla apo nga njerëzit e thjeshtë që nuk kanë grada por janë fisnikë dhe të devotshëm me Allahun xh.sh.. Ne e dijmë shumë mirë nga Kur'ani dhe historia islame se Hz. Musai a.s. ka qënë një peygamber i veçuar dhe përmendur më së shumti në Kur'an, i cili bisedoi me Allahun xh.sh. dhe Ai ia zbriti atij Tevratin, e bëri njeri të zgjedhur duke jetuar në oborrin e pallatit të Faraonit i cili ishte njeriu më i neveritshëm dhe po ky faraon kishte dhënë urdhër të vrasë fëmijët e vegjël, në mënyrë që këtë fat ta ketë edhe Hz. Musai a.s. si i vogël, por Allahu xh.sh. ia solli kundërshtarin në sofër pa e ditur ai.

Allahu xh.sh. na tregon qartë që Ai e din atë që ne nuk e dijmë, poashtu Ai na tregon në rastin me melaiket dhe Hz. Ademin a.s. kur iu tha atyre: **“...Unë di atë që ju nuk e dini!”**⁴⁵

Mirëpo tani do të fokusohemi në një fragment nga Kur'ani, është fjala për udhëtimin misterioz të Hz. Musait a.s dhe Hidrit a.s., njeri të cilit Allahu xh.sh. i kishte dhënë dije të veçantë dhe urtësi shumë specifike. Allahu xh.sh. na tregon në këta rreshta këtë tregim me shumë urtësi dhe mësim:

65. Dhe e gjetën një nga robtë Tanë, të cilit i kemi dhuruar mëshirë nga ana Jonë dhe e kemi mësuar me një dituri të posaçme nga Ne.

66. Atij (Hidrit - njeriut të mirë e të dijshtëm) Musai i tha: "A pranon të vijë me ty, që të më mësosh nga ajo që je i mësuar (i dhuruar) ti: dituri të drejtë e të vërtetë?"

67. Ai (Hidri) tha: "Sigurisht, ti nuk do të mund të kesh durim me mua!"

68. Si do të durosh për atë që nuk je i njoftuar?"

69. (Musai) Tha: "Në dashtë Allahu, do të shohësh se do të jem i durueshëm dhe nuk do të kundërshtoj ty për asgjë!"

70. Ai i tha: "Nëse më shoqëron ti mua, atëherë mos më pyet për asgjë, derisa unë vetë të të tregoj për të".

71. E ata të dy shkuan (duke ecur) deri kur hipën në anije, ai (i dishmi) e shqeu atë. Ai (Musai) tha: "A e shqeve që t'i fundosësh udhëtarët e saj, vërtet bërë një punë të hatashme?"

72. Tha: "A nuk të thashë se nuk do të mund të kesh durim me mua?"

73. (Musai) Tha: "Mos më qorto përse harrova dhe mos më mendo me vështirësi në këtë shoqërim timin (lehtësoma punën)!"

74. Vazhduan të shkojnë deri kur takuan një djalë të ri, e ai (i dijshtëm) e mbyti atë. (Musai) Tha: "A e mbyte njeriun e pastër, pa mbytur ai askë?! Vërtet ke bërë një punë të shëmtuar!"

75. Ai (i dijshtëm) tha: "A nuk të thashë se vërtet ti nuk do të mund të kesh durim me mua?"

⁴⁵ Kur'an-i, Surja Bekare, ajeti: 30.

76. (Musai) Tha: "Nëse pas kësaj të pyes (të kundërshtoj) për ndonjë gjë, atëherë mos më lejo të shoqëroj. Tashmë ndaj meje ke arsytim (të mos më shoqërosh)!"

77. Vazhduan të shkojnë deri sa arritën te banorët e një qyteti që prej tyre kërkuan t'u japin ushqim, po ata nuk deshën t'i pranojnë si musafirë (e as t'i ushqejnë), e ata të dy gjetën aty një mur që gati po rrëzohej, e ai e drejtoi atë (murin). (Musai) Tha: "Sikur të kishe dashur do t'u merrje shpërblim për këtë!"

78. Ai (i dijsmi) tha: "Tash ka ardhur koha e ndarjes mes meje dhe mes teje, e unë do të tregoj për domethënien e asaj që nuk munde të keshë durim!"

79. Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e do të varfërve që veprojnë në det, e unë desha ta bëj atë me të meta, ngase para tyre ishte një sundues që grabiste çdo anije (të aftë - pa të meta).

80. Sa i përket djaloshit, dy prindërit e tij ishin besimtarë, e u frikësuan se ai do t'i shpie ata të dy në humbje e në mosbesim.

81. Dëshëm që Zoti i tyre t'u japë në vend të tij një më të mirë se ai dhe më të afërt në respekt dhe në mëshirë (ndaj prindërve).

82. Përsa i përket murit, ai ishte i dy djelmoshave jetima të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (jetima) ta arrijnë pjekurinë e vet dhe ta nxjerrin ata vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë e Zotit tënd (ndaj tyre). Dhe unë nuk e punova tërë atë sipas bindjes sime (po sipas udhëzimit të Zotit). Ky, pra, është sqarimi i asaj për të cilën nuk munde të kesh durim!⁴⁶

Fillimi i Sures "Kehf" nisë me falënderim dhe me fjalën që Kur'ani nuk ka kundërthënie dhe ashtu është pa pikë dyshimi sepse ruajtës i tij është Allahu xh.sh.. Pikërisht tregimi, mes hz. Musait a.s. dhe hz. Hidrit a.s. në shikim të parë të duket disi kundërthënës sepse Hidri a.s. bën disa veprime që duken jo logjike, por Islami nuk është logjikë e thjeshtë njerëzore, por ky Islam është me plot mësim. Mësime të cilat na tregojnë për kategori personash të ndryshëm që ekzistojnë edhe sot, dhe po ta kuptojmë Suren "Kehf" dhe tregimin mes hz. Musait a.s. dhe hz. Hidrit a.s. mund t'i ndalojmë këto kategori nga nxitimi, pasioni, krimi, antiligji dhe mund t'i orientojmë ata drejt ekuilibrit, drejtësisë dhe barazpeshës.

Dituria, urtësia e hz. Hidrit a.s. dhe taktikat e tij i dhanë hz. Musait a.s. një seri leksionesh, ku përmes këtij tregimi Allahu xh.sh. sjellë shembuj sesi njeriu duhet të jetë i matur të mos paragjykojë, të mos dënojë dhe të mos jetë i nxitueshëm, të bëjë durim dhe të matet para se të veprojë mirë. Fjalët çelësa që përçohen nga tregimi mes hz. Musait a.s. dhe Hz. Hidrit a.s. janë:

1. Dija që Allahu xh.sh. i ka dhënë hz. Hidrit a.s. duke ia komunikuar hz. Musait a.s. gjatë udhëtimit,
2. Durimi që kishte hz. Hidri a.s. me pyetjet që hz. Musai a.s. i bënte,
3. Modestia e hz. Musait a.s. me pyetjet që bënte dhe sjellja e hz. Hidrit a.s..

⁴⁶ Kur'an-i: Surja: Kehf, ajetet: 65-82.

4. Udhëzimi se hz. Hidri a.s. tërë ato veprime si i kishte bërë me lejen e Allahut xh.sh. dhe udhëzimin e Tij.
5. Drejtësia që vuri në vend hz. Hidri a.s. duke mbytur djaloshin e padrejtë dhe duke ndihmuar jetimat.
6. Mëshira që hz. Hidri a.s. kishte ndaj besimtarit që mund t'i kushtonte marrja e anijes komplet dhe mëshira që ai kishte për jetimat që u drejtoi murin, etj.

Prishtinë,
27.12.2011

34. Prishtina, Perëndimi dhe Orienti

Qyteti i Prishtinës paraqet trende interesante gjatë ecejakjeve në kohë dhe hapësirë. Gjurmët e banimit në Prishtinë dhe rrethinë i gjejmë që në parahistori, si p.sh.: lokalitetet e neolitit të hershëm, si në Matican, Ulpianë, Graçanicë, këto gjegjësisht dardane apo ilire me origjinë nga pellazgët e Lindjes që i kemi edhe në Dodonë por çuditërisht në të njëjtën kohë kemi dy emra qytetesh të mëdha. Dardania mu në zemër të Orientit - Trojës së Azisë së vogël, tash Turqia, kjo sinonim apo lidhje që do shkëputet te pellazgët që do ta bartin kulturën nga Lindja monotesite e civilizuar dhe në perëndimin pagan etj.

Pastaj në epokën e bronzit deri te etnokultura dardane që nga shek. VIII dhe VI p.e.s. e vërteton këtë. Në të dhënat historike të shkruara deri në shek. XIV, për Prishtinën kemi të dhëna dhe fragmente të pakta. Shkrimet e para për Prishtinën si një fshat janë bërë nga Johan Kantakuzeni, perandor i Bizantit. *Sanxhaku* i Prishtinës gjatë kohës së Perandorisë Osmane ishte pjesë administrative e *Vilajetit* të Kosovës. Qendër e *Sanxhakut* ka qenë qyteti i Prishtinës.

Gjatë vitit 1898, roli i Prishtinës si qendër rajonale kishte rënë edhe pse aty gjendej *mutesarifi* (administratues sanxhaku) Valinazif Pasha, i cili nuk e kishte mbështetjen e shqiptarëve të cilët i shikonin me dyshim ndryshimet që ndodhnin në Perandorinë Osmane. Sipas shënimeve të viteve 1905-06 në këtë *Sanxhak* jetonin 364.915 banorë. Shënimet japin të dhëna për përkatësinë fetare të 254.605 muslimanëve (shqiptar) dhe të 110.310 banorëve (katolikë shqiptar dhe ortodoksë me kombësi shqiptare, serbe, bullgare dhe rumune).

Prishtina sot ndahet në dy struktura interesante si qytet ku edhe pamja e piktorit mundet ta spikatë mjaft bukur. Gjysma e Prishtinës së vjetër që i takon stilit oriental apo lindor me frymë islame, kulturore dhe me vlera të mëdha monumentale, si f.v.: kulla e vjetër, xhamia e Jashar Pashës, xhamia e Qarshisë, xhamia e Hasan Begut, xhamia e Alaudinit ku pranë oborreve ka qenë medreseja e vjetër dhe xhamia.

Kurse sot “Prishtina perëndimore” që po merr tone ndërtimi të vrullshme ku shumica nuk kanë as leje ndërtimi kanë prishur imazhin e tërë strukturës së qytetit kulturor duke e lënë në mëshirë të fatit koheziv. Sot në mes të Prishtinës shqiptarët muslimanë kur dikur baballarët e tyre garonin pas *mejtepeve* dhe mësimi të fesë islame në qytet, po këta muslimanë me emra rrahin gozhda, ngjeshin kolonat e Katedrales e cila e rrafshoi vatrën shkollore “Xhevdet Doda”, pra këta janë shqiptarët muslimanë me emra që po e ndërtojnë një identitet që në të vërtetë nuk i takojnë.

Katedralja tmerrësisht po zë vend mu në mes të Prishtinës kurse sa i takon Qendrës Islame nuk paska vend për të në Prishtinë, kur dihet se shumica e popullatës (96%) janë të besimit Islam. Kjo sëmundje u imponon shqiptarëve një identitet që nuk përshtatet aspak me vlerat e realitetit që ka, pra Perëndimi po shkatërron një kulturë

shekullore të strukturës së Prishtinës dhe po imponon një kulturë të huaj dhe pa plan, ashtu siç janë pa planimetri banesat që ndërtohen vend e pavend në qytet.

Këto ditë më ra në sy gazeta “Bota Sot” e shtypit të përditshëm kosovar dhe duke lexuar një artikull vëreja një shkrim të Agron Tufes i cili nuk pëlqente idetë e mendimtarit Fet’hullah Gülenit duke i quajtur ato “Renesancë Islamike” në shenjë ironike. Në realitet duke mos e ditur se vërtetë nga ka ardhur Renesansa. A mos vallë ishin arabët e Andaluzisë islame apo ish-Spanjës së sotme që e sjellën në Evropë Renesancën?

Reagime të tilla kishte edhe Pirro Misha ndaj ministrit turk Ahmet Davutoğlu që fliste rreth Turqisë Osmane dhe Islamit. Por as Agronit, as Pirros dhe as Perëndimit si pëlqejnë idetë islame purifikuese dhe as ato Turke-Osmane si të Gülenit sepse ato janë islame paqësore që i kundërvihen dukurive negative në shoqëri dhe ndimojnë për vlerat ideale në familje, shoqëri, shtet dhe në botën mbarë.

Si përfundim njësitet e Unmik-ut u larguan tani erdhi Eulex-i. Bukur po shkon puna por në përfundim si do të jetë fati i qyteteve islame osmane, si: Prishtina apo Prizreni që duken si me qenë mes Perandorisë Osmane ku gjyshërit tanë falnin dhe sot falin 5 kohët e namazit, ku imami na mëson kulturën, mirësinë, etikën dhe moralin kulturues me dobi për brezat e rinj që Perëndimi përmes mediave i zhytë dita-ditës me mesazhe djallëzore ku edhe përmes organizatave humanitare, nganjëherë edhe përmes disa unioneve fatkeqësisht me shfrenimin dhe humbjen e moralit të rinisë prishtinase.

Prishtinë,

25.03.2010

35. Qyteti ideal islam

Gjithmonë qytetet janë si mikro-shtete apo mikro-qeveri, ku çdo institucion brenda qytetit ka rolin dhe funksionin përkatës. Për qytetet islame foli shumë dijetari Ibn Tejmije i cili tërë jetën e shkriu në dituri dhe shkrime ku la shumë vepra në të mirë të *umetit* islam. Ndërsa Alex de Touqevile flet poashtu te “Filozofia Politike” për organizimin e familjes ku si në qytete apo qeveri, edhe në familje çdo njeri ka vendin e tij nga: kryefamiljari, babai, nëna, fëmijët, etj.

Thomas Mori siç e kemi përmendur në disa shkrime të tjera flet për ishullin-qytet ku ka njerëz që punojnë pa u shfrytëzuar nga të tjerët dhe pa qënë shfrytëzues vetë ata, pra një utopi. Ne nuk do flasim për utopi dhe as dogma por me pak fjalë do të mundohemi të tregojmë si funksionon një qytet ideal islam.

Ne e dijmë shumë mirë se qytetet si: Meka, Medina, Bagdadi, Kajro, Korbova, Toledo, Stambolli etj., funksionuan për mrekulli kur ato aplikuan me njëshmërinë e Zotit të mbjellur në zemrat e besimtarëve dhe popullatës poashtu kur ata ju qasën shkencës, dijes dhe punës së ndershme dhe dinjitoze. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: “**Betohem në këtë qytet**”⁴⁷.

Betimi i Zotit xh.sh. aludon në Meken e Bekuar ku ndodhet Xhamia e Shenjtë e rindërtuar nga Ibrahim i a.s. me dy bijtë e tij pejgamberë nga të cilët lindi raca njerëzore është fjala për Hz. Ismailin a.s. dhe Hz. Is'hakun a.s.. Meka ku u rrit i Dërguari a.s., njeriu epokal, pra qytetet e tilla kanë në kuadër njerëz që Zoti xh.sh. i zgjedhë mirëpo pejgamberllëku ka mbaruar dhe nuk ka më pas Hz. Muhamedit a.s..

Duhet ditur se qytetet e mirë organizuara me ligjet e Zotit xh.sh. nxjerrin burra të mëdhenj dijetarë dhe njerëz që shërbejnë edhe për mbarë njerëzimin në shërbim të shkencës dhe dijes, si f.v.: ibn Hejthem, ibn Firnas, ibn Sina, ibn Batuta etj.

Qytetet e zhvilluara shumë janë promotor të ideve dhe grupacioneve që herë-herë na shpalosin njerëz të humanizmit dhe mirësisë, por fatkeqësisht ka raste që prodhojnë grupe kriminelësh. Qytetet kanë dijetarë, mësues, ambasadorë, kryetarë, njerëz të mirë por edhe të këqinjë, kanë njerëz të shkolluar dhe pro-shkencor por kanë njerëz të pashkolluar dhe anti-shkencor.

Qyteti ideal islam nuk lejon të pashkolluarit të jetojnë në shoqërinë apo rrethin e tyre sepse i sulmon gjithmonë ata me objekte dhe vendtubime të dëturisë, si: xhamitë, që kanë shërbyer në historinë e Islamit si shkolla, mejtepe, medrese, universitete, etj. Vlen që të përmendet edhe el-Ez'heri, një prej universiteteve të para botërore ku Evropa ishte në errësirë dhe Amerika ishte ende e pazbuluar nga evropianët.

Qytetet përmbajnë shtresa të ndryshme të shoqërisë, si: të varfër, të mesëm, të pasur, poashtu shtresa që vijnë nga grupe që u takojnë formacioneve dhe ideve të ardhura nga jashtë por që ka edhe shumicë nga ata që janë autoktonë, kjo ide e formuar nga ata që kanë ardhë më herët dhe janë më të hershëm të vendosur aty në atë njësi gjeografike.

⁴⁷ Kur'an-i: Surja Beled, ajeti 1.

Ka nga ato qytete që janë rrezik për mbarë shoqëritë kur qytetet mbajnë në brendinë e tyre shumicën e popullit injorant apo anti-njerëzor, qytetet që kanë synime imperialiste dhe mendojnë se vetëm gjaku i tyre është i pastër dhe ata janë të parët e njerëzimit, ku ata duhet të udhëheqin njerëzimin, si p.sh.: izraelitët, ku popujt e tjerë i konsiderojnë derra dhe që duhet të vriten, është fjala për ekstremistët çifutë si dhe sionistët-mason.

Por historia islame tregon për disa qytete që Allahu xh.sh. i shkatërroi me themel sepse shkelën ligjet e Zotit të shkruara në: Tevrat, Zebur, Inxhil dhe Kur'an. Mohuan të vërteten dhe e shkelën atë edhe pse atyre ju dërguan pejgamberët nga mesi tyre që t'i udhëzojnë ata por ata kundërshtuan sepse shejtani ua morri mendjen dhe i bëri kryeneçë dhe mendjemëdhën.

Shumë qytete kanë ditur të jetojnë me frymën islame duke ruajtur: xhamitë, faltoret, shkollat, vendet e dijes dhe duke sakrifikuar jetën e tyre për to duke vdekur si burra dhe jo si burreca. Nga qytetet formohen shtetet, pa drejtësi nuk ka shtet, as qytet, as fshat që mund të ecë përpara. Hz. Omeri r.a. ka thënë: *“Drejtësia është themeli i një shteti”*. Pa drejtësi nuk ka liri, dituri, lëvizje zhvillimore dhe kulturore. Ndërsa pejgamberi a.s. ka thënë: *“Kush lufton që fjala e Zotit të jetë më e larta është në rrugën e Zotit të madhëruar”*.

Kur ne luftojmë që fjala e Zotit – Sheriati të jetë në lartësi dhe të praktikohet, atëherë ne jemi në e duhur. Ai që del jashtë rrugës, ka dalë nga e vërteta dhe kush del nga e vërteta ka humbur fenë e vet, ka humbur dinjitetin e tij, dhe ka bërë ligjet e njerëzve të “mëdha”, ligje që bëhen nga njerëzit dhe thehen po nga njerëzit janë ligje të mangëta që bëhen nga njerëzit që vetë njeriu është i mangët, vetë gjumi, hutimi, kotja, lodhja, etj., tregojnë mangësinë e njeriut. Nëse duam një qytet ideal islam duhet të ecim së paku në këto konture islame:

1. Leximi, studimi, analizimi i Kur'anit së paku një orë në ditë,
2. Formimi i kuadrove nëpër universitete islame, medrese, mejtepe,
3. Mbajtja e tribunave, ligjëratave në qytet, nëpër lagje, në ambiente të hapura dhe të mbyllura,
4. Shpërndarja dhe promovimi i librave islamo-shkencor,
5. Shpërndarja e video-kasetave, cd-ve me tematikë islame, shkencore, edukative, morale, etj.,
6. Edukimi i brezave të rinj nga hapat e vegjëlisë deri në pjekuri dhe vazhdimësi,
7. Trajtimi i grupeve të mëdha të mësuesve të fesë dhe shkencës si dhe personave me aftësi oratorike,
8. Infiltrimi në media, internet, radio, televizione, gazeta, formimi i tyre me përmbajtje moralizuese, islame, shkencore, edukative,
9. Mbajtja e rregullt e tubimeve dhe konferencave islame, shkencore nëpër shkolla jashtë orarit mësimor, edukimi i mësuesve, policëve, mjekëve, ekonomistëve, inxhinjerëve, arkitektëve, gazetarëve, publicistëve, shkrimtarëve, imamëve, me frymën morale, islame, shkencore, productive, zhvillimore, integruese, etj.,

10. Formimi i sindikatave, organizatave, korporatave, institucioneve, islame, shkencore, me drejtësi dhe norma kur'anore sipas Sheriatit Islam, etj.

**Prishtinë,
28.01.2012**

36. Islamofobia - një absurditet!

Sot ka njerëz që kanë frikë edhe prej hijes së vet, por të kesh frikë nga Islami, nga paqja dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit si krijesë e mangët dhe që ke nevojë të plotësohesh, vërtetë frika e tillë është tmerr-absurditet!

Në fenë islame nuk ka dhunë, është sqaruar e vërteta nga e kota. Muslimanët e vërtetë janë njerëz që synojnë paqen dhe shpërndajnë *selame* mes veti dhe janë tolerantë ndaj feve të tjera, këtë e ka dëshmuar historia islame dhe vetë Hz. Muhamed a.s. i cili kur çliroi Mekën përkundër të këqijave dhe padrejtësive që populli mekas u kishin bërë muslimanëve, iu tha atyre: *“Dilni! jeni të lirë, ne nuk ju dëmtojmë dhe nuk ju bëjmë padrejtësi”*. Në një rast Hz. Muhamed a.s. kishte marrur vesh për fqinjën e tij çifut se ishte pa ushqim, e kishte marrur gjysmën e gjellës dhe ia kishte dërguar që edhe ai të hante dhe ushqehet njëjtë si ai. Murgjëve të kishës së Shën-Katerinës, Hz. Muhamed a.s. iu kishin dhënë garancinë dhe mbrojtjen e plotë.

“Fobia” në spektrin shkencor quhet një lloj frike e pa-arsyeshme, spekuluese, propaganduese pa bazë dhe fakte reale. Televizioni po na shokon çdo ditë me fytyra të rinisë së indoktrinuara nga organizata sekrete që paraqiten islame por nuk kanë të bëjnë asgjë me Islamin, duke i bërë ata të rinjë anti-humanë, anti-paqësorë, që atyre që nuk e duan Islamin të kenë arsye ku të bazohen se kinse Islami është njollë për njerëzimin. Sulme të ndryshme dhe akuza që u bëhen muslimanëve, me qindra organizata të paguara nga sionistët në emër të Islamit, fryhet zjarri i terrorit, dhunës dhe bëhen revolucione, një lloj inskenimi me një regjisor i cili aktorët i përdorë në emër të Islamit.

Neve nuk po na shqetëson këmbana e kishave, kurse zviceranëve po ju shqetëson thirrja e ezanit, neve nuk na shqetësojnë me dhjetëra organizata të krishtera që në mes të rrugës na dalin me broshura dhe fletushka në duar që të na servirin fene e tyre që tregojnë se vetëvrasja është kulmi i fesë së tyre, dalin kudo në publik pa u penguar fare nga shteti apo komuna.

Neve nuk po na shqetësojnë klubet e natës deri në ora 5 mëngjesit, gjithë natën që janë poshtë banesave dhe nuk na lejojnë fëmijët tanë dhe familjet tona ta bëjnë gjumin si duhet, por disa laikëve iu pengon ezani 3 minuta në sabah e jo muzika 24 orë me tone të larta e shfrenuese. Neve nuk po na pengojnë të rinjtë tanë nëpër alkool dhe drogë, por po na pengojnë të rinjtë tanë që shkojnë në xhami, të mësojnë lexim, dije, arsimim, paqe, edukim, etj. Neve nuk po na frikësojnë hipikët e pederastët homoseksualë që mbushin rrugët e Gjermanisë dhe Zvicrës, por neve po na pengon Islami që thërret në shpë dhe nderim të familjes, gruas, burrit dhe nderim të racave njerëzore.

Frika dhe mosndjekja e Islamit i ka mbushur shkollat me fëmijë të rrugës, të drogës, hajdutë dhe mafiozë. Frika dhe mosndjekja e Islamit ka divorcuar familje të tëra nën konsumimin e alkoolit dhe drogës dhe ka zëvendësuar dashurinë ndaj fëmijëve me atë ndaj qenëve, maceve dhe derrave. Frika dhe mosndjekja e Islamit e ka shtuar korrupsionin, shpërlarjen e parave, humbjen e drejtësisë, shtimin e kamatës, humbjen e

dashurisë ndër njerëz. Frika dhe mosndjekja e Islamit ka bërë që të adhurohet fotografia, varri, kryqi, statuja, dielli, yjet, njeriu, muzika, ligjet e njerëzve që janë formuar nga njerëzit dhe thyhen nga njerëzit e mangët.

Frika e paarsyeshme ndaj Islamit e ka bërë njeriun si shtazë që han pa qëllim, jeton pa qëllim dhe punon pa qëllim. Në lidhje me këtë për këta njerëz që kanë sy por nuk shohin, kanë veshë por nuk dëgjojnë dhe e shohin të vërtetën dhe nuk e pranojnë, Zoti xh.sh. thotë: **“Ata janë si kafshët, madje edhe më të humbur nga e vërteta”**.⁴⁸

Pra këta njerëz janë helmuar dhe pluhërosur nga:

1. Helmi i mediave, lajmeve, shpifjeve antiislame,
2. Cicëronët me shkrime dhe opinione antiislame,
3. Doktrinat dhe asociacionet e shtëpive botuese që garojnë të shkruajnë kundër Islamit me autorë që synojnë çmimet Nobel dhe të bëhen librat më të shitur duke përdorur gjuhën më ofenduese ndaj Islamit dhe Kur'anit,
4. Organizatat, institucionet që punojnë ditë e natë kundër Islamit,
5. Mediat e filmave, montazhet *hollywoodiane*, *disneylandiane* dhe telenoveliane.

Ndaj këtyre helmeve iu përgjigjemi me ajetin kur'anor: **“Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojë të tyre, po Allahu e plotëson (e përhap) dritën e vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët”**.⁴⁹ (*Saff ajeti 8*)

Prishtinë,

04.02.2012

37. Islami dhe drejtësia

Allahu Fuqplotë çdo gjë e krijoj me drejtësi, harmoni e rregull por krijesat e papërkryera e çrregulluan këtë ekuilibër. Por që përqindja jonë si krijesa të mangëta të shkojë me drejtësi më shumë, që peshorja jonë të anojë kah drejtësia duhet të ndjekim mësimet kur'anore dhe peygamberike që Allahu xh.sh. i sjelli shembull për ne. Ai nuk i bën padrejtësi askujt, hz. Nuhu a.s. ishte i drejtë me popullin e tij që i bënë padrejtësi vetvetes, poashtu dhe hz. Ibrahim a.s., hz. Sulejmani a.s., hz. Musai a.s., hz. Isai a.s., hz. Muhamedi a.s. dhe të gjithë peygamberët ishin të drejtë sepse punuan me ligjet e të Drejtë.

Kur tek një popull humbet drejtësia dhe shfaqet padrejtësia ata janë të dalur jashtë udhës së vërtetë, jashtë mësimave që Zoti ua ka sjellur përmes Kur'anit, peygamberëve dhe njerëzve të cilët janë të nënshtruar ndaj Allahut xh.sh.. Ne e dijmë sa i drejtë ishte hz. Muhamedi a.s. i cili u quajt “el-Emin - Besniku” sepse vendosi ekuilibrat mes fiseve arabe ku përçarja kishte qënë ekstremisht e gabuar për çështje shumë të vogla. Në lidhje me drejtësinë, Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: **“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi,**

⁴⁸ Kur'an-i: Surja: Furkan, ajeti: 44.

⁴⁹ Kur'an-i: Surja: Saff, ajeti: 8.

ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim“.⁵⁰

Këto janë ligjet e Zotit xh.sh. që urdhërojnë në drejtësi, bamirësi dhe rregull, në bazë të kësaj të gjitha ligjet e mangëta të njerëzve duhet t'u binden ligjeve të plota të Allahut xh.sh.. Një perandori, një shtet, një qytet, një fshat, një lagje pa drejtësi dhe Islam është e destinuar të zhduket dhe shfaroset sepse aty nuk ka rregull, nuk ka ligje dhe njerëzit veprojnë duke mos qenë të informuar apo urdhëruar për asgjë, e cila sjellë padrejtësinë, krimin, daljen jashtë sistemit jetësor dhe organizimit të tij.

Marrim shembull kompjuterin i cili ka një rregull manual pune pa të cilin ai do bllokohej nga virusët apo do të digjej nga rryma si dhe mosvendosja në vend të duhur do t'i shkaktonte ndonjë dëmtim nga lagështia që do të prishte elementet e brendshme. Merrni shembull një njeri në një dimër të acartë dhe ta linit gjithë natën pa rroba, në mëngjes ai do ngryset i ngrirë, por kjo varet nga imuniteti i tij por gjasat për mbijetesë do të ishin zero. Allahu xh.sh. tregon se mision i të gjithë pejgamberëve ka qenë drejtësia e Tij në tokë: **“Ne i dërguam të dërguarit Tanë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t'i përmbahen njerëzit të së drejtës“.**⁵¹ [Sure El-Hadid 25]

Sot shumë njerëz në emër të Islamit duke mbajtur pozita kyçe janë njerëzit më të padrejtë në shoqërinë islame, e cila bie ndesh me parimet e Islamit dhe urdhëresat kur'anore. Shumë dijetarë u vranë dhe u burgosën kur kritikuan mbretin apo sundimtarin kur ai vepronte padrejtësisht, siç kemi rastin e Sejid ibn Xhubejrit apo rastin e Imam Ebu Hanifes r.a.. Duke e studiuar Kur'anin kuptojmë se drejtësia është elementi primar për të qenë në rrugën e Krijuesit të Madhërishëm.

Ne si besimtarë në çdo namaz kërkojmë udhëzim dhe përforsim në rrugën e drejtë nga Allahu xh.sh.: **“Udhëzona (përforsca) në rrugën e drejtë!“**⁵²

Abdullah b. Amr ibn Asi r.a. regon se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Të drejtët te Allahu do të kenë kolltuqe-fotele nga drita..., ata që janë të drejtë në gjykimin e tyre ndaj familjes dhe atyreve që i kanë nën pushtet të tyre“.*⁵³

Nga kjo arrijmë të kuptojmë se drejtësia e krijesave të drejta në rrugën e drejtë islame manifestohet kudo në familje, në pozitat e kësaj bote që kanë në punët e ndryshme qofshin kryetarë, drejtorë, presidentë, kryeministra, imamë, mufti, etj., atëherë do të kenë shpërblimin e pakufishëm në Xhennet për shkak të drejtësisë dhe korrektësisë. Drejtësia islame përdoret në këto vende:

1. Drejtësia me fenë islame,
2. Drejtësia me familjen,
3. Drejtësia me farefisën,
4. Drejtësia me kojshiun,

⁵⁰ Kur'an-i: Surja: Nahl, ajeti: 90.

⁵¹ Kur'an-i: Surja: Hadid, ajeti: 25.

⁵² Kur'an-i: Surja: Fatiha, ajeti: 6.

⁵³ Transmeton: Muslimi.

5. Drejtësia me nënpunësin,
 6. Drejtësia me shoqërinë dhe njerëzit,
 7. Drejtësia me vetveten duke mos i bërë padrejtësi vetes, duke mos e mbytur veten me gjëra të ndalueshme dhe kryesorja duke mos humbur veten duke i bërë *shirk* Allahut xh.sh. dhe duke besuar dhe adhuruar tjetër kënd veç Tij.
 8. Drejtësia me jetimin,
 9. Drejtësia me fukarenjtë dhe bonjakët,
 10. Drejtësia me njerëzit në udhëtim që janë musafirë,
 11. Drejtësia të jetë kudo me ne, në rrug, në shkolla, universitete, spitale, shtëpi, tokë, det, ajër, kudo, sepse Allahu xh.sh. i do të drejtët.
- Allahu xh.sh. na bëfte të jetojmë me drejtësi dhe punojmë me drejtësi, Amin!

Prishtinë,

08.02.2012

38. Islami - një religjion i keqkuptuar

“Vërtet të njohësh vetëm një fe do të thotë që të mos njohësh asnjë” - thoshte Mileri (studiues i feve). Vetë Islami shpjegon edhe librat e mëhershëm të zbritur peygamberëve dhe *umeteve* të kaluara ku për ne kjo konsiston edhe si kusht prej kushteve të besimit pra besimit në librat e shenjtë (të Zotit). Allahu xh.sh. thotë: **“O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush ashtu që të jeni të devotshëm (të shpëtuar)”**.⁵⁴

Krijuesi Suprem këtu u drejtohet të gjithë njerëzve pa përjashtim qofshin ata të një ngjyre, race apo bindjeje tjetër. Kjo thirrje është apel për mbarë njerëzimin që ta adhurojnë Zotin Një, duke u treguar se edhe gjatë historisë ka pasuar pasues të denjë në adhurim ndaj një Zoti dhe ndjekës të mësimave peygamberike ku vet peygamberët si njerëz të thjeshtë janë inspiruar nga Zoti xh.sh. duke u bërë mësues të njerëzve në tokë.

Proceset pse Islami keqkuptohet kanë ekzistuar gjithmonë që nga kohrat e lashta e deri sot. Ne e dijmë rastin e hz. Nuhut a.s. i cili quhej njeri i çmendur nga populli i tij që nuk ju bind thirrjes së tij, ata e keqkuptuan dhe e anatemuan, e akuzuan si një i krisur, duke qeshur me të pse ai po ndërtonte anije në një vend ku gjasat për me pasë ujë ishin zero, mirëpo uji u shfaq, ata u përmbytën kurse hz. Nuhu a.s. shpëtoi me ata që e pasuan në anijen e tij.

Normalisht, që të kuptosh diçka duhet të studiosh, jo me syrin kritik e përjashtues por me syrin studimor dhe repektues, pra të lexosh me dy sy dhe jo me një sy apo me dy sy të verbuar apo siç thotë Allahu në Kur'an: **“Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë, por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor”**.⁵⁵

Shumë shkrimtarë apo publicistë mendojnë që përmes sharjes së Islamit të arrijnë çmime në letërsi apo shkencë. Përmes sharjes nuk ka fitore por humbje dhe humbja më e madhe është Xhehennemi. Shumë çifutë dhe të krishterë e keqkuptojnë fenë islame duke u munduar ta paraqesin si fe e terroizmit, por nuk kujtojnë rastin e hz. Muhamedit a.s. kur ai në një letër e dërguar në adresë të adresuar murgjëve të Manastirit të Shën Katerinës ku mbanë datën e vitit 628 thuhet:

"Ky është një mesazh nga Muhamed ibn Abdullah, si një pakt për ata që mbajnë Krishterimin, pranë dhe larg, ne jemi me ta. Me të vërtetë unë, shërbëtorët, ndihmuesit, dhe ndjekësit e mi i mbrojnë ata, sepse kristianët janë qytetarët e mi; dhe për Allah, unë jam gjithmonë kundër çdo gjëje që i dëshpëron ata. Asnjë lloj detyrimi nuk duhet të ketë mbi ta. As gjykatësit e tyre nuk do të hiqen nga puna dhe as murgjërit nga manastiret e tyre. Asnjë nuk lejohet që të shkatërrojë një shtëpi të besimit të tyre, ta dëmtojë atë, apo të marrë ndonjë gjë nga ajo për tek shtëpitë e muslimanëve. Në qoftë se ndonjë merr ndonjë nga këto, ai do të shkelë paktin e Zotit dhe nuk i bindet Profetit të Tij. Me të vërtetë, ata janë aleatët e mi dhe kanë statutin tim të sigurt kundër çdo gjëje që ata

⁵⁴ Kur'an-i: Surja: Bekare, ajeti: 21.

⁵⁵ Kur'an-i: Surja: Haxh, ajeti: 46.

urrejnë. Asnjë nuk do t'i detyrojë ata që të udhëtojnë apo t'i obligojnë për luftë. Myslimanët duhet të luftojnë për ta. Në qoftë se një femër krishtere martohet me një mysliman, kjo nuk duhet të ndodhë pa aprovimin e saj. Ajo nuk duhet të ndalohet të vizitojë kishën e saj për t'u lutur. Kishat e tyre duhet të respektohen. Atyre nuk duhet t'u ndalohet riparimi i tyre as shenjtërimi i pakteve të tyre. Asnjë njeri nga ymmeti (bashkësia myslimane) nuk duhet të shkelë këtë pakt deri në Ditën e Kiametit (fundit të botës)“.

Poashtu një rast që vlen të përmendet është kur hz. Muhamed a.s. merr vesh se kojshiu i tij i afërt çifut ishte pa ushqim, mori gjysmën e ushqimit që kishte dhe ja dërgoi atij edhe pse ai kishte pikëpamje të tjera.

Patrisia Hatixha Del Monte, një muslimane nga Italia në një intervistë për media ka thënë se feja islame është fe e keqkuptuar dhe keqinterpretuar në Evropë. Zonja Del Monte, e cila është edhe bashkëpunëtore e ueb sajtit “Islam Online“ në përgjigje të pyetjes në lidhje me librin e botuar kohëve të fundit në Itali me titull “Rroftë Izraeli“ ka thënë se autori i këtij libri Mukdi Al-lam posedon një qëndrim negativ ndaj fesë së pastër islame dhe se ky libër aspak nuk është serioz dhe nuk mund të pasqyrojë realitetin për të cilin ka nevojë sot bota. Ajo duke iu përgjigjur pyetjes rreth një deklaratë të liderit të partisë italiane “Bashkimi Kombëtar“, Xhan Franko Fratini, i cili kishte thënë se “hytbet nëpër xhamitë e Italisë duhen të lexohen në gjuhën italiane“, është shprehur se kjo deklaratë e Fratinit mund të shkaktojë urrejtje të muslimanët dhe funksionarët italianë duhet të tregojnë kujdes të madh kur flasin për fenë islame.

Për të gjithë ata që e keqkuptojnë Islamin duhet ta dijnë se Islami është:

1. Fe e cila siguron individin dhe shoqërinë,
2. Fe që respekton të gjitha fetë e tjera,
3. Fe që njeh barazinë dhe nuk cënon lirinë e tjetrit,
4. Fe e cila e ka lënë njeriun e lirë të zgjedhë pa imponuar, etj.

Këto dhe shumë pika të tjera të bazuara në Kur'an dhe Sunet flasin shumë, për ata të cilët e shohin fenë islame me syrin e mediave, televizioneve, radiove, revistave dhe gazetave të manipuluara nga antiislamistët që duan ta paraqesin Islamin si fe të dhunës, Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: **“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson tagutët, e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. Allahu është dëgjues i dijshtëm“**.⁵⁶

Tagutët janë ata të cilët e keqkuptojnë Islamin dhe mundohen të manipulojnë masën duke shpërfillur vlerat islame, duke ndjekur dhe vrarë dijetarët islam. E lusim Allahun xh.sh. të na mbroj nga e keqja e njerëzve prej shejtanëve dhe exhinve të cilët mundohen ta hutojnë njeriun që ta shpie në humbje, Amin!

Prishtinë,

02.03.2012

⁵⁶ Kur'an-i: Surja: Bekare, ajeti: 256.

39. Muslimanët në Perëndim

Normalisht se Islam i takon Lindjes dhe Perëndimit, i takon Veriut dhe Jugut, Islami kudo ka hyrë, hyn dhe ka për të hyrë me lejen e Allahut xh.sh.. Ai në Kur'an thotë: “(Allahu është) **Zot i lindjes dhe i perëndimit, nuk ka zot tjetër vetëm Ai, pra Atë merre për mbështetje**”⁵⁷.

Muslimanët në Perëndim janë duke u ballafaquar me problem të ndryshme si: paragjykimi, anatemi i tyre nga shoqëria, akuzimi i tyre si terroristë, anarkistë, ekstremistë, etj., mirëpo edhe pse ata po akuzohen dhe anatemojnë, numri i muslimanëve në Perëndim është në rritje shumë të madhe sa që në të ardhmen ata do ta marrin në dorë tërë Evropën, ku dihet se feja më në rritje është ajo islame. Kisha katolike e Romës me qendër në Vatikan është njëra prej institucioneve që përcjellë trendet e konvertimit. Një nga temat kryesore gjatë takimit të tetorit 1999 në Këshillin Evropian të Kishës, në të cilin morrën pjesë gati i gjithë kleri katolik, ishte “*Pozita e Kishës në Mileniumin e Ri*”. Diskutimi kryesor i konferencës ishte “*Përhapja e shpejtë e Islamit në Evropë*”.

Gazeta “*The National Catholic Reporter*” raportoi se: “*disa individë radikalë deklaruan se mënyra e vetme për të parandaluar forcimin e muslimanëve në Evropë është të stopohet tolerimi i muslimanëve dhe i Islamit*”, ndërsa disa individë të tjerë që ishin më të arsyeshëm dhe më objektiv, theksuan faktin se “*meqë të dy fetë besojnë në një Zot, nuk duhet të ketë vend për konflikt ose luftë në mes tyre*”.

Në një sesion kryepeshkopi nga Gjermania Karl Lehman nënvizoi se “*në Islam ka më tepër pluralizëm të brendshëm se sa vërehet nga shumë të krishterë dhe se deklaratat e radikalëve për Islamin nuk kanë bazë në vërtetësi*”. Konsiderimi i pozitës së muslimanëve me rastin e shqyrtimit të “*Positës së Kishës në Mileniumin e Ri*” ishte mjaft e natyrshme, sepse një analizë e Kombeve të Bashkuara tregonte se në mes të vitëve 1989 dhe 1998 popullata muslimane e Evropës u rrit 100 %. Raportohet për 13 milionë muslimanë që jetojnë në Evropë. 3.2 milionë në Gjermani, 1 milionë në Britani të Madhe, 4-5 milionë në Francë dhe pjesa tjetër e shpërndarë në vende tjera të Evropës, sidomos në Ballkan. Shifra paraqet më tepër se 2 % të popullsisë totale të Evropës.

Muslimanët në Perëndim janë duke ndërtuar një shoqëri oportune me një të ardhme të sigurt islame, xhamitë e tyre janë kthyer në qendra islame dhe vend takimesh e tubimesh ku promovohen vlerat e larta të zhvillimit islam dhe edukativo-mësimor. Në shumë qytete dhe shtete të mëdha perëndimore po ndërtohen xhami, qendra dhe institute islame zhvillimore.

Rast konkret këto ditë ishte fillimi i ndërtimit të xhamisë në Bruksel ku u vendosen themelet e xhamisë *Selimije*, për të cilën thuhet se përfaqëson kulmin e projektimit arkitektonik. E shënuar me simbolet e arkitekturës turke dhe asaj evropiane, xhamia është projektuar nga arkitekti i njohur turk Shefik Birkiye. Ajo do të ndërtohet në kuadër të komunës së Saint Josses, në hapësirë prej 2.700 metra², ndërsa ana e brendshme

⁵⁷ Kur'an-i: Surja: Muzzemmil, ajeti: 9.

e saj do të jetë në gjendje të pranojë 750 besimtarë. Me vënien e gurthemelit, pas përfundimit të namazit, Shefik Birkiye bashkë me ministrin në qeverinë rajonale, Emir Kir, vuri tullën e parë të xhamisë së re.

Apel për perëndimorët është fjala e Zotit xh.sh.: **“Thuaju (o i Dërguar): "O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë tjetër pos Allahut, të mos i shoqërojmë Atij asnjë shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos Allahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë!"**⁵⁸

Një hulumtim lidhur me Islamin në Perëndim ka investiguar se numri i muslimanëve në Evropë vazhdon të rritet dhe ka një thellim të vetëdijes fetare në mesin e jomuslimanëve. Sipas një studimi të bërë nga gazeta franceze *“Le Monde”* në tetor të vitit 2001, krahasuar me të dhënat e grumbulluara në vitin 1994, *“shumë jomuslimanë vazhdojnë të pranojnë Islamin dhe kryejnë faljet e tyre, duke shkuar në xhami dhe duke agjëruar”*.

Kjo vetëdije është vënë re shumë më tepër në mesin e studentëve të universitetit. Në një raport të bazuar në raportet e shtypit të huaj në vitin 1999, revista turke *“Aktüel”* njoftoi se hulumtuesit perëndimorë llogarisin se në 50 vitet e ardhshme *“Evropa do të bëhet njëra prej qendrave kryesore për përhapjen e Islamit”*.

Ja disa fraza në mediumet botërore perëndimore dhe nga njerez me renome që janë shprehur në lidhje me Islamin dhe muslimanët në Perëndim:

1. *“Islami është religjioni i cili më së shpejti rritet në Amerikë, udhëheqje dhe shtyllë e stabilitetit për shumë nga njerëzit tanë...”* - (Hillary Clinton, Los Angeles Times, 31 Maj, 1996),
2. *“Tani me më tepër se një miliardë njerëz, Islami është religjioni që rritet më së shpejti në botë”* - *“ABC News”*, www.abcnews.com,
3. *“Islami është religjioni që rritet më së shpejti në vend”* – *“News Day”*, 7 Mars, 1989,
4. *“Islami është religjioni që më së shpejti zgjerohet në Shtetet e Bashkuara...”* – *“New York Times”* - 21 Shkurt, 1989,
5. *“Muhammedi është njeriu më i sukseshmi prej të gjithë profetëve dhe personaliteteve religjioze”* - *“Encyclopaedia Britannica”*,
6. *“Tani ka më tepër muslimanë në Amerikën Veriore sesa hebrenjë”*, Dan Rathers *“Cbs News”*,
7. *“Islami vazhdon të rritet në Amerikë dhe askush nuk mund të dyshon në këtë!”* – *“CNN”*, 15 Dhjetor, 1995,
8. *“Religjioni i Islamit rritet më shpejtë sesa cilado prej religjioneve të tjera në botë”* - Mike Wallace, emisioni *“60 Minutes”*,

Këto dhe shumë të tjera shprehin qartë rritjen e Islamit kudo në Perëndim si dhe zgjimin e madh islam në mesin e muslimanëve ku nga pakica të bëhen shumicë dhe të

⁵⁸ Kur'an-i: Surja: Ali Imran, ajeti: 64.

ndërtojnë një shoqëri të sigurtë. Allahu na ndriçoftë fytyrat Ditën e Gjykimit dhe na bëftë dëshmitarë të këtij fesë islame i cili do të trokasë në çdo derë dhe do hyjë në çdo kontinent, perandori, shtet, qytet, fshat, lagje, fis, individ dhe qenie njerëzore.

Prishtinë,

11.03.2012

40. Muhamedi a.s. në notat e historisë evropiane

Vërtetë historia e Evropës është e gjatë dhe me shumë ndodhi dhe fakte, mirëpo notat, shënimet e saj herë paraqesin ngjyra të bardha e herë të zeza dhe aspak joshëse për njerëzimin. Pikërisht ishte një njeri i cili u zgjodh të mësonte evropianët dhe arabët dhe gjithë popujt sesi ata të dilnin nga errësira e paganizmit dhe verbalizmit të tyre duke i dhënë bardhësi historisë evropiane, ai njeri ishte hz. Muhamed a.s., i dërguar si mëshirë për mbarë njerëzimin.

Ishte periudha e Perandoris Bizantine ku hz. Muhamedi a.s. tregoi se Allahu Fuqiptotë i kishte shpallur se ata do të humbasin në pikën më të ulët gjeografike në tokë dhe që përsëri ata do të fitojnë:

“Elif, Lam, Mim. Bizantinët (rumët) u mundën, Në tokën më afër (tokës së arabëve), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjejnë brenda pak viteve. Çështja është vendim i All-llahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen“.⁵⁹

Megjithatë, këto momente që ajetet e para të sures “Rum“ u shpallën dhe u njoftua se bizantinët do të triumfojnë përsëri brenda pak viteve. Idhujtarët arabë menduan se kjo fitore e paralajmëruar në Kur'an kurrë nuk mund të ishte e mundur. Por si të gjitha zbulesat e tjera në Kur'an, kjo u bë gjithashtu një realitet i plotë, pasi që perandori bizantin Herakliu arriti të rimarrë Jeruzalemin dhe të fitojë sërish.

Në një rast Herakliu si parashikues dhe astrolog që ishte u ngrit në mëngjes i mërzhitur në vetvete. Disa nga priftërinjtë e tij e pyetën pse ishte në atë gjendje. Ai u përgjigj: "Natën kur vështrova yjet, pashë se është dukur (dhe ka triumfuar) prijësi i atyre që bëhen synet. Kush është ai popull?" Ata iu përgjigjën: "Përveç çifutëve askush nuk e praktikon synetllëkun, kështu që ti nuk duhet të kesh frikë prej tyre. Vetëm shkruaj urdhëra për gjithë anët e mbretërisë tënde për të marrë çdo çifut që gjendet gjithandej në mbretëri." Ndërsa ata ishin në këto fjalë, një lajmëtar i dërguar nga mbreti i Gassanit u sjell përpara Herakliut për t'i bërë të njohur lajmin për të Dërguarin a.s.. Duke marrë këtë njoftim prej tij, Herakliu urdhëroi njerëzit e tij të shkojnë dhe të shohin nëse ai (lajmëtari i Gassanit) ishte i bërë synet. Pasi e panë atë, i thanë (Herakliut) se ai ishte i bërë synet. Pastaj e pyeti për arabët dhe ai u përgjigj: "Edhe ata e zbatojnë bërjen synet." Pasi dëgjoi këtë, Herakliu bëri të njohur se sundimi i Muhamedit a.s. tashmë ka nisur. Herakliu i shkroi një mikut të vet në Romë, i cili matej me të në dituri dhe nga këtej u nis për Hims (qytet në Siri), duke pritur atje derisa i mbërriti letra e përgjigjes nga miku i tij. Sipas letrës edhe shoku i tij pajtohej me mendimin për ardhjen e Pejgamberit (Muhamed a.s.) dhe se me të vërtetë ky (Muhamedi a.s.) ishte Pejgamber. Atëherë Herakliu thirri krerët e bizantinëve për t'u mbledhur në pallatin e tij në Hims. Kur u grumbulluan, ai urdhëroi që të gjitha dyert e pallatit të tij të mbylleshin. Pastaj doli para tyre dhe tha: "O Bizantinë! Nëse dëshironi triumfin, nëse kërkonit udhëzim të shpejtë dhe, nëse doni që perandoria të

⁵⁹ Kur'an-i: Surja: Rum, ajetet: 1-4.

mbetet e juaja, atëherë jepiani besën këtij Pejgamberi." (Duke dëgjuar mendimet e Herakliut) të gjithë njerëzit u derdhën drejt dyerve të pallatit si gomarë të egër, por i gjetën të mbyllura. Herakliu, kur pa urrejtjen e tyre ndaj Islamit dhe duke humbur shpresën për ta për të besuar (që të përqafojnë Islamin), urdhëroi: "Sillini prapë tek unë." (Pasi u kthyen) u tha: "Ajo që sapo ju thashë, ishte vetëm për të provuar forcën dhe lidhjen që keni me fenë tuaj dhe tashmë e pashë atë." Të gjithë të pranishmit ranë me fytyrë për tokë para tij të kënaqur me të. Kështu pra ishte fundi i çështjes së Herakliut (në lidhje me besimin e tij). Në përfundim Herakliu iu dha një mesazh të gjithëve se ky pejgamber do të jetë ai i cili do të dridhë temelet e Bizantit.

Ashtu edhe ndodhi, sot qyteti i Bizantit apo Konstantinopoja për të cilën Pejgamberi a.s. kishte thënë se do çlirohet nga muslimanët, ajo u çlirua në vitin 1453 nga Sulltan Mehmet Fatihu II dhe tashmë në ditët e sotme udhëheqet nga Rexhep Taip Erdoğan - një musliman i përkushtuar në Islam.

H.z. Muhamedi a.s. ishte prijës i drejtë. Shumë historian, poetë dhe njerëz të letrave, evropianë dhe jo evropianë shkruan për të saqë njëri ndër ta, historiani i krishterë Michael Hart, në librin e tij *"100 personalitetet më me ndikim në historinë e njerëzimit"*, e renditë h.z. Muhamedin a.s. të parin dhe thotë: *"Përcaktimi im që Muhammedin ta vë në vendin e parë në listën e personaliteteve më me ndikim në botë, ndoshta te disa lexues do të shkaktojë befasi, ndërkaq te të tjerët dyshim, por ai është njeriu i vetëm në histori, i cili arriti sukses të jashtëzakonshëm si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë politik-diplomatik. Edhe pse me një prejardhje të thjeshtë, Muhammedi predikoi dhe përhapri njërin ndër religjionet më të mëdha në botë dhe u bë udhëheqës jashtëzakonisht i shkathët. Sot, trembëdhjetë shekuj pas vdekjes së tij, ndikimi i tij akoma është i fuqishëm dhe veprues"*.

Aq shumë ishte veprues saqë muslimanët kur ecën me mësimet e h.z. Muhamedit a.s. aq shumë ndikuan saqë 800 vjet në Spanjë ngritën renesancën islame në Kordova, Toledo, ku rinia spanjolle, franceze, italiane, evropiane shkonin në Universitetet e muslimanëve në Endelus, ku qyteti Medinetu-Zehra mahniste syrin e çdo vizitori. Aq shumë ndikuan mësimet e h.z. Muhamedit a.s. saqë el-Idrisi (1099) një musliman me etikë dhe edukatë të marrë nga Kur'ani dhe mësimet e h.z. Muhamedit a.s. i mësonte italianët dhe sicilianët se si të udhëtonin me harta dhe u mësonte gjeografinë dhe historinë evropianve injorantë.

Pikërisht në atë kohë kanë qenë el-Idrisi së bashku me udhëpërshkruesin musliman ibn Havkali. El-Idrisi në udhëtimin e tij gjatë bregdetit Adriatik deri në Trieste dhe nëpër bregdetin e Shqipërisë e deri në bregdetin grek tregon se: *"në këto troje ka një bujqësi të zhvilluar dhe tregje të vërshuara nga zejtarë dhe artistë muslimanë"*, gjithashtu flasin edhe për *"lagje të muslimanëve në Palermo dhe për plot shkolla, biblioteka dhe dijetarë muslimanë"*.

Ndër të tjerë vlen të përmendet rasti i Sari Salltëkut, i cili i maskuar si murg katolik ka predikuar Islamin në rrethinat e Krujës dhe njëkohësisht edhe në Kosovë. Ai ka shkëlur në trojet ilire-shqiptare që në vitin 1161 d.m.th. mbi 200 vite përpara që

Osmanët të vijnë. Shum njerëz eminentë në historinë e Evropës flasin për hz. Muhamedin a.s. dhe gjurmët e tij me ndikim në historinë e Evropës. Vlen të përmenden disa si:

Edward Gibon, historian eminent: *“Në fenë e Muhammedit, nuk ka vend për t’u hamendur, kurse Kur’ani është dritë e dëshmisë për njëshmërinë e Zotit”,*

Napoleon Bonaparta, udhëheqës francez: *“Musai (a.s.) popullin e vet, Isai (a.s.) ithtarët e vet, kurse Muhammedi (a.s.) tërë botën e ka lajmëruar se ekziston Allahu i Madhërishëm dhe është vetëm Një”,*

Emile Dermenghem,: *“Muhammedi është sigurisht një peygamber nga radha biblike”,*

Oto Von Bizmark,: *“O Muhammed, më vjen keq që nuk kam qenë bashkëkohësi yt”,*

Sir Bernard Show, fitues i çmimit Nobel në letërsi: *“Kam parashikuar se besimi i Muhamedit (a.s.) do të jetë i pranueshëm për Evropën e nesërme ashtu siç ka filluar të bëjë pranueshem për Evropën e sotme”,*

Johan Wolfgang von Gëte, letrar i njohur gjerman: *“Në histori kërkoja shembullin e një njeriu të shkëlqyer, e atë e gjeta te peygamberi Muhamed (a.s.)”,*

Muslimanët të inspiruar nga mësimet e hz. Muhamedit a.s. prekën çdo kontinent duke lënë gjurmë islame kudo dhe duke mbjellur paqe dhe mirësi mes njerëzve.

Gjatë udhëtimit për në Basel të Zvicër më la përshtypje një rrugë në Bazel të Zvicrës që quhej rruga “Salahudin Ejub“, ku mu kujtua çliruesi i Jeruzalemit nga forcat e kryqëzatave evropiane të cilat dështuan kur muslimanët ishin të bashkuar sepse ecën me fjalën e Allahut: **“Bashkohuni e mos u përçani”**.

Allahu na bëftë prej të mirëve dhe atyre që ndjekin hapat e Peygamberit a.s. i cili na mësoi adhurimin ndaj Allahut xh.sh. neve si popull evropian.

Prishtinë,

14.03.2012

41. Islami dhe mjekësia

Vërtetë të shërosh plagë dhe sëmundje ka mënyra të ndryshme, ashtu siç sëmundjet janë lloje-lloje, si sëmundje *akute* - të përkohëshme, *kronike* - të vazhdueshme apo *letale* – vdekjeprurëse. Të gjithë sëmundjeve Allahu xh.sh. iu ka gjetur shërimin, edhe vetë vdekjes, ndoshta çuditëmi pse dhe vdekjes, sepse edhe pas vdekjes na ka sqaruar sistemin dhe katalogun se çka do të pasojë pas saj dhe si të përgatitemi proces normal i njerëzimit.

Në botën greke antike Hipokrati njihet si “babai i Mjeksisë”, kurse muslimani Ibën Sina që dha një kontribut aq të madh për mjekësinë, sa që e tërë Evropa dhe bota mësoi nga mësimet e tij dhe konsiderohet themeluesi dhe vënësi i gurëthemelit të mjeksisë, që vlen të përmenden dy librat e tij: “El-Kanun fit-Tib – Ligji i Mjekësisë”, dhe “Kitabush-Shifaje – Libri mbi ilaçet dhe barërat shëruese”.

Një libër i arritur për kohën e sotme e jo të flitet për shek. X ku mjekësia e ibn Sina-it arriti kulmin. Mjekësia është shumë e vjetër sa vetë njeriu, ne e dimë se mjekësia popullore ishte shumë efikase për kohërat e hershme, por edhe mjekësia nga mrekullitë e pejgamberëve ishte shërbim special që bëhej nga ata me lejen e Allahut xh.sh.. Shembulli i hz. Isaut a.s. i cili shëronte të sëmurët nga lebroza si dhe u kthente të verbërve shikimin.

Të gjitha ilaçet dhe shërimet kanë burim nga Kur'ani dhe Suneti ashtu siç në të kaluarën *umetet* e librave të mëhershëm gjenin zgjidhjen në ilaçin e jetës në Tevrat, Zebur apo Inxhil, ndërsa ne në Kuran dhe Sunet. Një ndër emrat e Kur'anit është Shifa'-Shërues i cili shëron zemrat e plagosura dhe njollosura nga gjynahet duke i zbutur ato dhe shtuar besimin me dritë dhe hapur horizontin e kuptimit të realitetit të sotëm ku jetojmë, duke qënë edhe Furkan-Dallues i së vërtetës nga e kota.

Ibn Kajim el-Xheuzie shkroi një libër me titull: “*Mjekësia e Pejgamberit Muhammed a.s.*”, një vepër gjeniale e studiuar dhe e mirëshkruar nga ky dijetar islam, ku aty është një botë e tërë spjegimesh rreth Islamit dhe Mjekësisë ku vlen të theksohet “*fara e zezë*” ku i Dërguari a.s. ka thënë: “*Përdoreni rregullisht këtë farë të zezë, sepse ajo përmban në vete ilaç për të gjitha sëmundjet përveç vdekjes*”. Allahu xh.sh. ka zbritur Nahl, ku flet për bletën dhe thotë: “**Nga barqet e tyre (të bletëve) del lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka shërim (bar-ilac) për njerëz. Edhe në këtë ka arsye për atë popull që mendon thellë**”.⁶⁰

Mjekësia e Pejgamberit a.s. e cila është paraqitur në këtë libër ka të bëjë me aspektet fizike dhe psikike të shëndetit të njeriut. Këtu janë përshkruar dy lloje themelore të sëmundjeve (të shpjeguara në Kur'an): sëmundjet e zemrës dhe sëmundjet e trupit. Ibn Kajimi thotë që në shëndetin trupor ekzistojnë tre rregulla themelore: mjekësia parandaluese, heqja dorë nga gjërat e dëmshme, dhe pastrimi i trupit nga sekrecionet (tajitjet) e dëmshme.

⁶⁰ Kur'an-i: Surja Nahl, ajeti: 69.

Vlen të përmenden disa hadithe të Pejgamberit a.s. ku tregohet përkushtimi dhe dija e lartë e muslimanëve për mjekësinë :

1. *“Ai që e ka krijuar sëmundjen, e ka krijuar gjithashtu edhe ilaçin”,*
2. *“Kur dëgjoni që në një vend është paraqitur murtaja, mos shkoni atje”,*
3. *“Barku është shtëpi e çdo sëmundjeje, ndërsa matura (ndalimi) është kryet e çdo ilaçi, andaj përvetësojeni këtë traditë”,*
4. *“Çdo sëmundje ka ilaç. Njohja e ilaçit të vërtetë do ta shërojë sëmundjen me lejen e Zotit xh.sh.”,*
5. *“Fuqia e temperaturës është ajo që djeg fuqishëm sikur të jetë lëshuar nga zjarri përvëlues i Xhehenemit, andaj duhet ta ftohni me ujë”.*
6. *“Çdo musliman të cilin e godet ndonjë fatëkeqësi, qoftë sëmundje apo diç tjetër, Allahu me të ia shlyen të këqijat e tij njashtu siç largon druri gjethet e tij”.*

Mjekësia islame i dhuroi shumë mjekësisë botërore, qoftë nga mjekësia shpirtërore, popullore dhe mjekësia e barërave dhe ilaçeve. Muslimanët ishin të parët që i përpunuan mësimet greke të paformuluara duke i definuar dhe trasuar ato në themelet e tyre. Mjeku musliman duhet të jetë dy herë human, sepse ne e dimë se parimi i mjekut është humanizmi, kurse sot kur mjekë janë jashtë Islamit e kanë bërë mjekësinë komercializëm, biznes, duke harruar parimin fetar se *“kush bëhet shkaktar me shpëtu një njeri është si me shpëtu tërë njerëzimin”*.

Mjeku sot i cili nuk e njeh Islamin dhe humanen ai keqtrajton pacientin, nuk i jep rëndësi punës sepse ai nuk ka frikë Zotin dhe si zot i tij është bërë materia. Kurse muslimanët dhe Islami na mëson të jemi të ndershëm në profesion dhe të bëjmë dhe punë humane, falas dhe vullnetare. Allahu na bëftë prej të mirëve, Amin!

42. Islami dhe i ashtuquajturi ekstremitet

Sot shumë njerëz kanë probleme me kuptimin e nocioneve apo fjalëve, si mangësi e mospërdorimit të fjalorëve dhe kuptimit të fjalëve. Fjala ekstrem vjen nga latinishtja “*extremus*” që i bjen një superlative apo diçka jashtë mase, ose i përkushtuar jashtëzakonisht. Mirëpo duhet ta sqarojmë një gjë se ekstremiteti varet se kur përdoret dhe për çfarë përdoret, a është ai i dobishëm në disa raste dhe kur ai është i padobishëm. Vlen të përmendet se gjërat në tepricë janë ndëshkim hyjnor për njeriun, ngase Allahu xh.sh. thotë: “**Hani dhe pini mos e teproni...**”⁶¹ Ndërsa Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Nuk mbush biri i Ademit një enë me të keqe se barku i tij*”.

Allahu xh.sh. nuk i don ata që e teprojnë dhe kalojnë në ekstremitet – tepricë, mirëpo nuk i don edhe ata njerëz që muslimanin e përpiktë e quajnë ekstremist, pse ai u përmbahet rregullave strikte që Zoti xh.sh. e urdhëron nga Kur'ani Famëllartë dhe rregullat që Pejgamberi a.s. ia mëson. Kemi pra dy krahë, krahun etiketues - paragjykses të cilët bëjnë blasfemi ndaj muslimanëve të rregullt duke i quajtur ata ekstremistë për t'i larguar nga feja islame, por kemi edhe krahun realisht ekstremistë të cilët e teprojnë si në ushqim dhe mos përmbajtje estetike ndaj adhurimeve në lidhje me këtë ka thënë i Dërguari a.s.: “*Ruajuni nga teprimi në fe sepse janë shkatërruar para jush ata që e kanë tepruar në fe*”.⁶²

Në një rast hz. Muhamedi a.s. kur morri vesh se disa shokë të tij kishin vendosur të agjëronin gjatë ditës, të faleshin gjatë natës, duke u privuar nga gjumi dhe pushimi dhe nga jeta bashkëshortore me gratë e veta, erdhi dhe tha: “*Ç'mendojnë ata që e flasin këtë e këtë? Sa më përket mua, për Zotin, unë në mesin tuaj më së shumti i frikësohem Zotit dhe kam vetëdijen më të lartë për Të, por unë agjëroj dhe ha, falem dhe fle dhe bëj jetë bashkëshortore. Prandaj, kush devijon nga rruga ime - nuk është imi nuk i takon Sunetit tim*”.

Ky Islam është i lehtë por ka katalog dhe rregull, kush shkelë rregullat humbet, ashtu siç shoferi kur nuk respekton rregullat rrugore pëson aksident. Islami filloi së pari me mbjelljen e farës së besimit dhe ishte periudha mekase, pastaj pasi kaluan 13 vite erdhi periudha tjetër medinase. Populli ynë evropian qoftë shqiptar apo kosovar është ende në periudhën mekase, andaj shumë hoxhallarë nxitohen duke mos pasur metodë pune, ku shpesh kalojnë në shpjegime të periudhës medinase, rreziku që mund të sjellë kjo metodologji pune është shumë i madh sepse pa mësuar *shehadetin* dhe besimin, nuk mund të hysh në shpjegime për botën e exhinëve apo analiza të rënda për një audiencë që ende nuk e ka të qartë besimin.

⁶¹ Kur'an-i: Surja: A'raf, ajeti: 31.

⁶² Transmetojnë: Ahmedî, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe Hakimi.

Mësimi i njeriut se si ai duhet të besojë dhe adhurojë Allahun Një është lehtësim që ai të njohë esencën e fesë islame. Muslimanët akuzohen si ekstremistë nga vetë ekstremistët mediatikë. Kur gazetari perëndimor e pyeste pastorin (priftin protestant): pse po e djegë Kur'anin? Ai (pastori) nuk kishte arsye t'i kthente përgjigjen ngase nuk kishte argumente.

Muslimanët shqiptarë rrahen, keqtrajtohen në Maqedoni nga ekstremistët maqedono-ortodoksë dhe askush nuk ngre zërin se kush vërtet qenka ekstremistoterrorist. Burgjet e Guantanamos janë të mbushur me muslimanë ku me trupat e tyre bëhen keqtrajttime çnjerëzore, askush nuk e ngre zërin për ekstremizmin dhe terrorizmin që u bëhet këtyre njerëzve, ku kjo bjen ndesh edhe me të drejtat e njeriut.

Shumë pak shkruhet për ekstremizmin ndaj muslimanëve në Reçak-Kosovë që kishte ndodhur kur Kosova ishte okupuar nga serbët apo për masakrën në Srebrenicë ku me mijëra muslimanë u masakruan. Nuk di kush qenka ekstremist, por di që bota arabe po përgjaket kudo nga inskenimet masono-sioniste që paguajnë pilotë revolucionarë të bëjnë trazira dhe t'i shpiejnë muslimanët në gërmadha duke lënë fajin kinse terrorizmi islamik, kur dihet se Allahu xh.sh. thotë në Kur'an: **“Në fe nuk ka dhunë, është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat, e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. Allahu është Dëgjues, i Dijshëm”**.⁶³

Poashtu në një vend tjetër thotë: **“Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko(ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangut atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bëj të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit”**.⁶⁴

Allahu xh.sh. na ruajtë nga estremizmi dhe etiketizmi nga të tjerët. Allahu xh.sh. na ruajtë nga armiqtë e fesë islame dhe na bëftë të triumfojmë ndaj tyre dhe vërtetë kush i ka shpallur luftë Allahut xh.sh. ai e ka të humbur luftën pa dyshim pa ja nisur luftës.

Prishtinë,
13.03.2012

⁶³ Kur'an-i: Surja: Bekare, ajeti: 256.

⁶⁴ Kur'an-i: Surja: Kasas, ajeti: 77.

43. Islami në rrethin e Tropojës

Krijuesi ynë na krijoi në formën më të bukur dhe na bëri popuj, fise dhe *umete* që të njihemi mes veti, siç thotë në Kur'an: **“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”**.⁶⁵

Vend për t'u njohur është edhe rrethi i Tropojës në veri të Shqipërisë, një vend mikëpritës ku mikëpritja është dhunti e burrave të mëdhenj siç ishin pejgamberët dhe sahabët. Tropoja ka qytet BajramCurrin dhe dy qyteza: Tropojën e vjetër dhe Fierzën si dhe mbi 70 fshatra, ku fshati Bujan-Dojan është një ndër fshatrat që ka më shumë shtëpi dhe është në afërsi me qytetin.

Qyteti BajramCurr ka një xhami e cila u ndërtua në fillim të viteve 90-ta pas rënies së komunizmit në Shqipëri, xhamia e qytetit është funksionale dhe ka një *xhematë* të rregullt të drejtimit Sunni.

Fshati Pac poashtu ka një xhami si dhe Tropoja e Vjetër, gjithashtu edhe fshati Degë ka një xhami e cila u ndërtua nga *“Instituti për Qytetërim dhe Islam”*.

Fshati Margegaj i gëzohet një xhamie të re poashtu e ndërtuar me nismën e vëllezërve muslimanë nga qyteti i Prizrenit.

Fshati Bujan shumë shpejtë do t'i gëzohet një xhamie të re, poashtu në fshatrat Gri dhe Markaj pritet të ndërtohet nga një xhami, ku me lejen e Allahu xh.sh. autori i librit po të bëhet shkaktar.

Islami në Tropojë përfaqësohet nga një grup i të rinjëve, rrallë ndonjë ka moshë të vjetër andaj disa të rinjë kanë ende nevojë të piquen me Islamin dhe të kenë njohuri graduale në të dhe jo të nxitohen. Fshatrat kanë nevojë për kuadro të reja, medreseja “Alaud-din” dhe “Fakulteti i Studimeve Islame” në Prishtinë janë qendra që kanë shkolluar dhe po shkollojnë kuadro të reja për të ushtruar detyrën e shenjtë të thirrjes islame dhe imamllëkut në Tropojë. Disa të rinjë kanë diplomuar në medresenë “Alaud-din” në Prishtinë dhe në “Fakultetin e Studimeve Islame” në Prishtinë për arsye se Prishtina është larg me veturë 2 orë e 10 minuta, ku gjithashtu rruga është e asfaltuar dhe lidhja jonë me Kosovën është më e madhe se me Tiranën zyrtare që duhen pesë orë udhëtim dhe të shkohet në relacionin Gjakovë-Prizren për të kapur linjën e autostradës për në Tiranë.

Kuadro të njohur në rrethin e Tropojës që i kanë shërbyer në të kaluarën fesë islame, vlen të përmenden: hoxhë Dusha nga fshati Dushaj (Fierzë), hoxhë Dollapi nga fshati Koçanaj, si dhe shumë emra të tjerë eminentë që në mënyrë të fshehur kanë predikuar Islamin edhe pse komunizmi e luftonte në mënyrë mizore, ku shkatërroi afro 27 xhami.

⁶⁵ Kur'an-i: Surja: Huxhurat, ajeti: 13.

Nëna ime e nderuar tregon se në fëmijërinë e saj mbanë mend xhami madhështore në fshatin Babin të Tropojës e cila nuk ekziston më, dhe prindërit e saj nga Ballabani i Tropojës falnin pesë kohët e namazit fshehurazi që të mos hetoheshin nga regjimi enverist. Shumë xhami u rrënuan me temel, disa u kthyen në magazina drithi, stalla bagëtish dhe zyre e partisë enveriste. Në vend të Islamit servirej Marks, Engelsi dhe gota e rakisë dhe thuhej “*lavdi partisë*“, një regjim që shpalli Shqipërinë si vend të pafe botërisht. Por Allahu xh.sh. besimtarëve pas vështirësisë iu bjen lehtësimin sepse kështu thotë në Kur'an: “**Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi**“.⁶⁶

Sot Tropoja ka shumë të rinjë vitalë që posedojnë njohuri dhe janë hoxhallarë të arsimuar me arsim të mesëm dhe të lartë fetar. Feja islame çdo vit po rritet në rrethin e Tropojës, shkëmbimet mes hoxhallarëve dhe lidhjet e botës teknologjike po bëjnë të mundur të hapin hapësira ndërkomunikuese të thirrjes islame.

Qyteza e Fierzës shumë shpejtë do të ketë xhaminë e saj, nismëtar i kësaj ishte vetë deputeti Besnik Dusha që rrjedhë nga një familje hoxhallarësh.

Në Kasaj të Tropojës nga një vëlla musliman avokat janë hedhur temelet për një xhamie të re si dhe në fshatin Dragobi do të ketë një xhami sipas disa burimeve sepse është shumë e domosdoshme për fshatin dhe qindra turistë muslimanë që vizitojnë lumin e Valbonës dhe fshatin Dragobinë ku ata falen në livadhe të hapura në mungesë të xhamisë.

Rrethi i Tropojës ka 98% muslimanë, përqindja e vogël janë të krishterë në fshatrat Cernicë dhe Lekbibaj. Shumë të rinj nëpër shkolla kanë nevojë për më shumë integrim në Islam dhe në të ardhmen të kenë dhe ata një medrese apo qendër arsimore islame në Tropojë që të mësonin fenë e tyre.

BajramCurri ka shumë besimtarë të edukuar dhe disiplinuar për Islam, të diplomuar në fakultete islame si në: Medine, Jordani, Prishtinë, etj, që po t'u ofrohej mundësia do të bënin një qendër të madhe islame që do të merrte shembull i tërë veriu i Shqipërisë.

Qyteti më i afërt me Tropojën është Gjakova, apo 40 minuta me veturë në rruga të asfaltuar. Tropoja është vendlindja e kryeministrit shqiptar Sali Berisha si dhe e shumë intelektualëve si: Besnik Mustafaj dhe Aleksandër Byberaj. Tropoja është vendlindja e mulla Haxhi Zekës, burrë që ka lindë Malësia, musliman, hoxhë dhe haxhi, lindur në fshatin Shoshan të Tropojës më 1832 dhe formues i “Lidhjes së Pejës (Besa-Besë) në 1899, duke u nisur nga parimi i besës që ka muslimani me qenë besnik ndaj fesë dhe atdheut.

Tropoja është një ndër qytetet e para që e nisi revolucionin kundër diktaturës gjysmë shekullore të Enver Hoxhës që shkatërroi xhamitë dhe lirinë e veprimit të çdo qytetari. Ishin pikërisht Azem Hajdari dhe Sali Berisha, dy tropojanë që me studentë të tjerë në mes të Tiranës rrëzuan shtatoren e Enver Hoxhës.

⁶⁶ Kur'an-i: Surja Inshirah, ajeti 5.

Rrethi i Tropojës ka 16.257 banorë (2009), një sipërfaqe prej 1.043 km² dhe kryeqendër qytetin Bajram Curr. Historikisht, treva njihet me emrin Malësia e Gjakovës dhe siç e thamë është vend i lindjes së shumë patriotëve, hoxhallarëve dhe burrave muslimanë me të cilët mburret Shqipëria dhe Kosova, një ndër ta është edhe Fatmir Hasandoçi, dëshmor, vëlla i yni që falte pesë kohët e namazit dhe ishte hoxhë i formuar me dije të gjërë, i cili luftoi heroikisht dhe ra shëhid në Smolicë të Gjakovës për lirinë e Kosovës, ku për të cilin pak është shkruar.

Allahu xh.sh. na bëftë prej të mirëve. Të shkruash për vendlindjen, fjalët janë të pakta por me aq kemi mundur u munduam të shkuajmë diçka. Allahu xh.sh na shtoftë diturinë, mirësinë dhe dobitë e shumta se vetëm Ai sjellë dëm dhe dobi dhe askush tjetër veç Tij, Amin!

44. Islami dhe prostitucioni

Falënderimi i takon Allahut xh.sh. i Cili zbriti Kur'anin si dallues të së vërtetës nga e kota. Ky libër i qartë i cili tregoi se shumë shoqëri u rrënuan nga prostitucioni dhe imoraliteti dhe dalja jashtë mësimeve të Allahut Fuqiplotë. Allahu xh.sh. na tregon qartë për prostitucionin: **“Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse vërtet ajo është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe”**.⁶⁷

Prostitucioni është shkak për rrënimin e familjes së shëndoshë dhe kjo sjellë pasojë që njerëzimi të asimilohet dhe të humbas dashurinë njerëzore dhe njerëzit të bëhen si kafshë bile më keq se kafsha. Pejgamberi a.s. ka thënë: **“Ai i cili bën zina, ose pin alkol, Allahu ia zhvesh atij imanin (besimin) ashtu si njeriu kur e zhvesh këmbishën e tij nga koka”**.⁶⁸

Sot në emër të modernitetit është shfaqur lakuriqësia dhe prostitucioni bëhet publikisht. Ka thënë Pejgamberi a.s.: **“Do të vjen një kohë që njerëzit do të bëjnë prostitucion publikisht dhe ai i cili ka pak iman në zemër do t'i thotë atij: a ka mundësi të fshihesh pak sepse nuk është etike!”**. Poashtu Pejgamberi a.s. ka thënë: **“Nuk kam lënë sprovë apo fitne më të madhe se fitneja e grave”**.

Çifutët kur panë që nuk mund t'i mposhtin muslimanët përdorën metoda të ndryshme për t'i devijuar përmes: muzikës, femrave lakuriq dhe alkoolit. Sot mediat servirin telenovela dhe seriale ku paraqitet: dhuna familjare, divorci, prostitucioni publik si gjë e zakonshme dhe kanë importuar një fjalë që quhet *“modë e kohës”* dhe ndryshe e quajnë *“normalitet”*. Allahu xh.sh. na ruajt nga këto dredhi fjalësh që kanë të keqen që i vjen pas.

Shumë femra shfrytëzohen dhe trafikohen dhe e humbasin të drejtën e tyre për të pasur një familje dhe një siguri. Ato shfrytëzohen si kafshët dhe manipulohen nga njerëz të ligë të cilët i përdorin ato për fitime parash të pista. Zoti xh.sh. e ka nderuar gruan duke e konsideruar atë zonjë të vërtetë që e respekton burrin dhe familjen dhe kujdeset për rritjen e fëmijëve dhe jo rritjen e kopilëve si dhe shmangien dhe lënjen e tyre në kontinierë dhe kosha plehrash, Allahu na ruajt!

Në Kur'an një sure titullohet *“Nisa-Gratë”* në nder të tyre dhe vlerës fisnike që ato kanë për rritjen dhe ndërtimin e brezave të sigurtë, poashtu një sure tregon për një nënë të ndershme që mban emrin e saj *“Mejrem”* ku flet për nënën e ndershme të hz. Isaut a.s..

Pasojat e prostitucionit janë shumë të mëdha dhe fatale prandaj nuk është e tepërt që të njihemi me disa sëmundje sipas burimeve mjekësore. Më të rrezikshmet janë: sida (AIDS), sifilizi, gonorreja, etj.. Sëmundja e sidës është ushtar i Allahut xh.sh. në tokë, ushtar me pendrek dhe revole që ka ardhur t'i vrasë ata që janë zinaqarë dhe e bëjnë këtë akt imoral të paligjshëm. Pejgamberi a. s. ka thënë: *“Sa herë që kurvëria është shfaqur te*

⁶⁷ Kur'an-i: Surja: Isra, ajeti: 32.

⁶⁸ Transmetojnë: Ahmedî dhe Taberaniu.

një popull, aty janë përhapur sëmundje që nuk ishin të pranishme në kohën e stërgjyshërve të tyre“.

Poashtu ka thënë: *“Një nga shenjat e kijametit do të jetë kur marrëdhëniet imorale seksuale do të mbizotërojnë dhe kur numri i meshkujve të jetë më i vogël se ai i femrave“.*⁶⁹

Sot shtëpitë publike janë bërë si diçka e zakonshme edhe në vendet ku dikur Islami mbizotëronte dhe Sheriati udhëhiqte, kjo si pasojë e dobësimit të muslimanëve dhe përçarjes, andaj nëse duam ta luftojmë këtë dukuri duhet ta luftojmë që nga rrënjët. Rrënjët e kësaj sëmundje vijnë si pasojë e mosedukimit ku dihet se Pejgamberi a.s. ka ardhur të përsosë vlerat e edukimit dhe ka qënë i përsosur në moral. Kur'ani urdhëron dhe na mëson për martesën dhe e ndalon imoralitetin e jashtëligjshëm, saqë ka vënë rregulla ndëshkuese ku thotë: **“Laviren dhe lavirin i rrihni secilin prej tyre me nga njëqind të rënë** (me kamxhik)“.

Ndërsa për sa i përket lavirit i cili është i martuar dhe që ka kryer marrëdhënie seksuale me bashkëshorten e tij, qoftë edhe vetëm një herë në jetën e tij; dënimi i tij në fenë e Allahut është goditja me gurë deri sa të vdes sepse ai në vend se të gjejë prehjen tek bashkshortja e tij ka gjetur prehjen e jashtëligjshme, pra ka thyer kurorën, ka bërë marrëdhënie me një femër që nuk ka martesë me të dhe dënimi është edhe më i madh si shkak edhe i tradhtisë bashkëshortore, kjo vlen për të dy gjinitë qoftë burri apo gruaja në bazë të Sheriatit. Pejgamberi a.s. iu është drejtuar të rinjve: *“O ju të rinj! martohuni herët, nëse nuk keni mundësi materiale atëherë argjëroni derisa të martoheni“.*

Gjërat që e ndalojnë prostitucionin klasifikohen në disa pika:

1. Martesa me kohë dhe herët,
2. Agjërimi dhe punët e mira që e frenojnë të riun apo të rënë nga e keqja,
3. Ulja e shikimit dhe edukimi i hershëm,
4. Turpi dhe ruajtja e nderit,
5. Mbështetja tek Allahu dhe largimi nga haramet,
6. Ndalimi i shikimit, të folurit, apo të ecurit haram.

⁶⁹ Transmeton: Buhariu.

⁷⁰ Kur'an-i: Surja: Nur, ajeti: 2.

45. Islami dhe malet

Lavdërim i bëjnë Allahut xh.sh. Zotit të gjithsisë, i Cili malet e larta dhe kodrat i ka ngritur si shtylla nga të cilat sjellë shembuj për njerëzit që mendojnë. Allahu xh.sh. thotë: **“A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatshme (për jetë), Ndërsa kodrat shtylla?”**⁷¹

Vërtetë malet apo vargmalet fshehin pas tyre shumë mistere sepse dihet që Allahu i ka krijuar ato për të mirën e njerëzimit dhe nuk mund ta quajmë ide apo projekt njerëzor ndërtimin e një peme apo mali që qëndron statik pa u përkulur apo rrëzuar sikur të ishte me hekur dhe çimentim të klasit të parë. Shkenca moderne ka vërtetuar se malet kanë rrënjë të thella që mund të arrijnë nën sipërfaqen e tokës në thellësi disa herë më të madhe se sa pjesa e ngritur mbi sipërfaqe. Malet luajnë një rol shumë të rëndësishëm në stabilizimin e kores së tokës duke penguar lëkundjet e mundshme të saj. Zoti xh.sh. thotë në Kur'an: **“Dhe Ai vuri male të patundura në tokë, në mënyrë që ajo të mos lëkundet me ju”**⁷².

Malet janë stabilizatori kryesor që pengon termetet dhe mbanë tokën në harmoni me koren dhe arkitektoninë e saj. Malet kanë veti të prodhojnë edhe ujin e pastërt dhe kulluar nga trungjet e tyre, si f.v. në vendlindjen time (Tropojë) mali që ka gështenja në mesin e tij ka dalur një burim që me qindra shtëpi furnizohen me ujë të pijshëm, ai nuk është rastësisht aty ashtu siç ne nuk jemi krijuar rastësisht.

Shpesh në male më ka rënë të shoh hoje bletësh, shtëpi të tyre ku gjyshi i merrte i zbuste dhe i vendoste në kutitë prej druri dhe kujdesej për to dhe ato na dhuronin mjaltin si ushqim dhe ilaç.

Sot gjeologjia si shkencë e studimit të tokave dhe llojit të tokës që posedojnë malet ka vërtetuar ajetet kur'anore pjesërisht, por ne u themi atyre gjeologëve ta studiojnë edhe më shumë Kur'anin kur flet për malet sepse ata do të arrijnë rezultate të shkëlqyera zbulimore duke trajtuar Kur'anin me përpjekjen shkencore atëherë ata do të gjejnë realitetin dhe funksionin që ato kanë, pse jo edhe të arrijnë të zbulojnë gjëra që deri tani ende janë prapa me zhvillim në të mirë të njerëzimit.

Libri me titull *“Toka”* është një referencë bazë në shumë universitete të botës. Njëri prej dy bashkautorëve të librit është prof. Frank Press. Ai ka qenë këshilltar shkencor i presidentit amerikan Xhimi Karter (Jimmy Carter) dhe për 12 vite ka mbajtur postin e presidentit të Akademisë Kombëtare të Shkencës, në Washington D.C.. Libri i tij thotë se: *“malet kanë rrënjë nëntokësore të cilat janë të ngulura thellë në tokë. Për këtë arsye malet kanë formën e një kunjë të ngulur në tokë”*. Kur'ani përmend se malet kanë strukturë si "shtylla" dhe se ato janë ngulitur në tokë për ta stabilizuar atë, një koncept i njohur në gjeologji si *“izostasi”*. Allahu xh.sh. thotë: **“Dhe në të (tokë) Ne kemi krijuar**

⁷¹ Kur'an-i: Surja: Nebe, ajetet: 6-7.

⁷² Kur'an-i: Surja: Nahl, ajeti: 15.

bjeshkë të paluhatshme që të mos i lëkundë ata, dhe nëpër to kemi bërë luginë e rrugë, në mënyrë që ata të dinë të orientohen“⁷³.

Malet kanë një veti që ajrin e ndotur apo dioksidin e karbonit ta kthejnë në oksigjen, pra në të mirë të mjedisit. Sot shumë ambientalistë dhe ekologë merren me pylltarizmin dhe me mbjelljen e pemëve dhe drunjëve që pasurojnë ambientin. Allahu xh.sh. na mëson se nga kodrat dhe malet kemi shumë dobi, jo vetëm se ato mbajnë statikën si dhëmbët në gojën e njeriut që e përpunojnë ushqimin, por edhe si shërbyese të ajrit, ambientit që na rrethon dhe si frytdhënëse për ne.

Vlen të përmenden edhe malet shkëmbore të cilat njeriu i shfrytëzon për kromin dhe metalet që ato posedojnë si dhe për disa lloje që shërbejnë për gurë që të ndërtojnë dhe punojnë ndërtesa me bazament të fortë nga guri. Malet simbolizojnë edhe besimin e fortë apo durimin e fortë të një besimtari të forcuar dhe pajisur për në frontin e thirrjes islame. Ato kanë edhe heshtje dhe heshtja tyre flet për krijim e tyre të rrallë arkitektonik që Allahu xh.sh. u ka bërë. Ato shfrytëzohen edhe për barinjte që kopet e tyre të ushqehen dhe që ne nga ato të hajmë mishin dhe pijmë qumshtin, poashtu malet tona kanë dhe çajin e malit shërues dhe mjekues për sëmundjen e gripit.

Por të gjitha këto mirësi që marrim nga malet nuk mund t'i numrojmë dhe duhet ditur se mirësitë e Allahut xh.sh. janë të panumërta. Mirësitë nga Allahu xh.sh. janë edhe malet e larta nga të cilat kemi dobi të shumta andaj ne duhet të jemi falënderues ndaj Tij e jo të bëhemi sikurse që Allahu xh.sh. thotë për ta: **“E, cilën të mirë të Zotit tuaj e mohoni?”**“⁷⁴.

Allahu xh.sh. na bëftë prej adhuruesve dhe falënderuesve të Tij për çdo gjë që na dhuroi, qoftë për malet dhe kodrat qoftë edhe për fizionominë, trupat tanë dhe gjithçka që është e Tij, sepse edhe vetë kthimi jonë është tek Ai, Amin!

Prishtinë,

01.04.2012

⁷³ Kur'an-i: Surja: Enbija, ajeti: 31.

⁷⁴ Kur'an-i: Surja Rrahman, ajeti: 18.

Përfundim

Literatura e konsulltuar

1. KUR'AN-I, përkthim me komentim në gjuhën shqipe “, përktheu dhe komentoi: Sherif ef. Ahmeti, ribotim, Medine 1413 / 1992.
2. Bibla - Diodati i Ri, përkthimi 1991-94, boton: “*Shoqata Shqiptare e Biblës*”, (The Albanian Bible Society), Tiranë 1994.
3. Arbër Berisha, “*Toleranca Osmane dhe Shqiptarët*“, shtypi: “*Grafo-Ing*“, Prishtinë 2012.
4. Sejjid Kutub, “*Islami dhe paqja universale*“, boton: “*Asr*“, Tetovë 2005.
5. Mustafa Milvo, “*Kur'ani përpara Shkencës dhe Civilizimit*“, boton: “*Dituria Islame*“, Prishtinë 2008.
6. Abdusamed Nasuf Bushatliq, “*Endelusi – përkujtim dhe vërejtje*“, boton: “*Klubi studentor*“, Shkup 2007.
7. Osman Nuri Topbash, “*Islami, besimi dhe adhurimi*“, (përktheu: Mit'hat Hoxha), sh.b. “*Erkam*, Stamboll 2004.
8. Alparslan Açıkgenç, “*Dija dhe shkenca në qytetërimin islam*“, boton: “*Dituria*“, Gostivar 2008.
9. Ajni Sinani, “*Të tjerët për Islamin*“, shtypi: “*Mozaiku*“, boton: “*Zëri ynë*“, Prishtinë 2005.
10. Sejjid Muxhteba Musavillari, “*Islami dhe civilizimi perëndimor*“, boton: “*Drita e jetës*“, Gjilan 2008.
11. Dr. Halid Faik el-Ubejdi, “*Kur'ani dhe planeti Tokë*“, sh.b.: “*Dëshmia*“, Prishtinë 2008.
12. Imran N. Husein, “*Jerusalemi në Kur'an*“, boton: “*Zëri ynë*“, Prishtinë 2010.
13. Alija Izetbegović, “*Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*“, boton: “*Logos-A*“, ribotim, Shkup 2009.
14. Xhorxh Sarton, “*Historia e shkencës islam*“, boton: “*ACFOS-Books*“, Tiranë 2009.

Shënime për autorin